



Koha



Che Guevara
dhe vizita
sekrete në
Shqipëri

FAQE 17

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3194 • E enjte 12 tetor 2017 15 DEN

Kush do të dijë t'i bindë të pavendosurit



Shkup, 11 tetor - Partitë politike në ditët e fundit të fushatës parazgjedhore kanë ndezur motorët në terren, duke bërë luftë të drejtpërdrejtë për të siguruar votat për fitore në komunat ku kandidojnë. Tek partitë shqiptare vërehet një ngritje e toneve kritike se kush më kë po bashkëpunon me

partitë maqedonase, ndërsa disa parti kanë filluar të dalin me të dhëna konkrete për keqeverisje nga pushtetarët e deritanishëm. Lufta deri të premtën do të përqendrohet edhe tek të pavendosurit, numri i të cilëve mbetet i lartë duke kaluar 20 përqindëshin bazuar në anketa e fundit të

"Brima Gallup" dhe "Dimitarija Çupovski". Ndërkaq për ti bindur të pavendosurit, ata nuk do ta kenë të lehtë ngaqë motivacioni për të votuar, siç flasin ekspertët, nuk është i lartë siç ishte në zgjedhjet parlamentare shkak i zgjatjes së krizës politike dhe institucionale për dy vite...
Faqe 3

Shifra alarmante në tregun e punës

Magjistrat e papunë



Ndër personat që kërkojnë punë më së shumti janë ata pa arsim - 41.884 persona, 28.043 persona janë me shkollim të mesëm, ndërsa punë kërkojnë edhe 12.054 persona me diplomë universitare. Shkalla papunësisë prej 22.6 për qind tregon se Maqedonia akoma ka shkallë të lartë të papunësisë edhe si rrjedhojë e mos-harmonizimit midis ofertës së sistemit arsimor dhe nevojave të tregut të punës

FAQE 2

S'ka bllokadë të llogarive për rastet sociale



Shkup, 11 tetor - Përmbaruesit e Odës së Përmbaruesve të Maqedonisë (OPM) në mbledhjen e jashtëzakonshme që u mbajt të martën - për kryetar të ri zgjedhën përmbaruesin Zoran Dimov. Sipas OPM-së, nga gjithsej 100 anëtarë - për Dimovin votuan 65 përmbarues, 22 votuan kundër ndërsa 14 përmbarues

nuk ishin prezentë në mbledhje. Mbledhja e jashtëzakonshme u mbajt me kërkesë të një numri të madh të përmbaruesve për shkak të akumulimeve të shumta të pakënaqësive të punës së përmbaruesve, sidomos në pjesën që ka të bëjë me pagesën e dhunshme të borxheve, si dhe në shpërndarjen e

jo të barabartë të lëndëve midis përmbaruesve. Për shkak të pakënaqësisë të përmbaruesve, 64 përmbarues dy muaj më parë nënshkruan peticion për shkarkimin e, tani ish-kryetarit Zoran Petrovski, i cili më pas dha dorëheqje të parakohshme nga funksioni i kryetarit të OPM-së...
FAQE 4

RETRO

Të pathënat për Dritëro Agollin



Pasi mbaroi muajin e vullnetarizmit në aksionin hekurudhor, Dritëroi u regjistrua në Shkollën Unike të Bilishtit, ku pas diplomimit, mund të bëhej mësues. Atëherë ishte 15 vjeç dhe kishte bindje të plotë për të vazhduar të gjitha ciklet shkollore, deri në universitet, meqenëse nga familja nuk...
FAQE 12-13

RAJON

Reagimet e paefektshme rreth Speciales

FAQE 14

GLOBI

Izraeli ndalon ezanin në një fshat palestinez

FAQE 15

GLOBI

Refugjatët të shqetësuar nga dimri



FAQE 15



Ndër personat që kërkojnë punë më së shumti janë ata pa arsim - 41.884 persona, 28.043 persona janë me shkollim të mesëm, ndërsa punë kërkojnë edhe 12.054 persona me diplomë universitare. Shkalla papunësisë prej 22.6 për qind tregon se Maqedonia akoma ka shkallë të lartë të papunësisë edhe si rrjedhojë e mos-harmonizimit midis ofertës së sistemit arsimor dhe nevojave të tregut të punës

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 11 tetor - Në tregun e punës në Maqedoni nuk janë të papunë vetëm personat me arsim fillor, të mesëm apo me fakultet, por edhe ata me arsim të lartë të specializuar në ndonjë lëmi shkencore. Sipas evidencës së Agjencisë së Punësimit, në Maqedoni të papunë janë edhe 38 doktorë të shkencave dhe 863 magjistra. Krahas këtyre kuadrove të arsimuara, gjithsej janë të evidentuar 96.728 të papunë, të cilëve ju ofrohen afër 8000 vende të punës. Ndër personat që kërkojnë punë më së shumti janë ata pa arsim - 41.884 persona, 28.043 persona janë me shkollim të mesëm, ndërsa punë kërkojnë edhe 12.054 persona me diplomë universitare.

Shkalla e papunësisë prej 22.6 për qind udhëzon se Maqedonia akoma ka shkallë të lartë të papunësisë edhe si rrjedhojë e mosharmonizimit

Shifra alarmante në tregun e punës

38 doktorë shkencash dhe 863 magjistra presin punë



midis ofertës së sistemit arsimor dhe nevojave të tregut të punës. "Përzgjedhja e arsimit është e drejtë individuale e çdo individi dhe gjatë sjelljes së vendimit se ku do të vazhdohet shkollimi - çdoherë duhet të merrret parasysh edhe mundësia që të gjendet punë adekuate pas përfundimit të procesit të arsimit formal, gjegjësisht të merrret parasysh nevoja reale për një profil të tillë arsimor në tregun e punës", thonë nga Agjencia e Punësimit. Analizat e

Agjencisë së Punësimit tregojnë se punëdhënësit ballafaqohen me vështirësi të caktuara për të plotësuar vendet e punës, apo nuk mund të gjejnë kuadro me arsim adekuat për shkak të mungesës së përvojës së punës, mospasjes së njohurive dhe shkathtësive për realizimin e detyrave të punës që kërkon në një vend pune. Vlerësohet se ndryshimet e reja tekniko-teknologjike dhe zhvillimi dinamik i tregut të punës, krijojnë vende të punës

për të cilat nevojiten njohuri dhe shkathtësi të reja që jo çdoherë mund të fitohen në procesin e arsimit formal. Andaj, rekomandohet lidhja dhe ndërthurja më e madhe e procesit të arsimit formal dhe joformal me qëllim të kënaqjes së nevojave të tregut të punës. Problem tjetër i tregut të punës në Maqedoni është edhe mungesa e harmonizimit midis kualifikimeve dhe profileve arsimore që ofrohen dhe ato që kërkojnë në tregun e punës. Në Maqedoni

mungojnë studimet afatgjate për nevojën e zanateve në tregun e punës. Anketat e Agjencisë së Punësimit për kërkesat e shkathtësive në tregun e Maqedonisë siguron tregues afatshkurtër të dobishëm për pritjet e punëdhënësve në lidhje me punësimet e reja dhe nevojat për shkathtësitë, me të cilat duhet të disponojnë personat që të jenë konkurrues në tregun e punës.

Sipas përfaqësuesve të sektorit të biznesit, studimet në tregun e punës për nevojën e profesioneve të ndryshme nuk janë të plota dhe u mungon qasja afatgjate e planifikimit. Analiza e nevojës së tregut të punës për zanatlinj në industri apo biznesin e vogël, apo në vendbanimet më të mëdha dhe më të vogla, duhet të bazohet në radhë të parë në investimet kapitale që i planifikon shteti në infrastrukturë si ndërtime të rrugëve, hekurudhës, energjetikës e kështu me radhë. Në këtë drejtim duhet të dihet se si do të rrjedhin investimet që të mund të planifikohet nevoja për profilin e kërkuar në tregun e punës. Gjithashtu, duhet të dihen edhe planet investuese të sektorit privat

vendor dhe të huaj që të mund të planifikohen nevojat e profileve të punëtorëve që mungojnë në shtet vlerësojnë punëdhënësit. Problem tjetër është se në raport me vitin 1991, 24 vite më vonë është trefishuar numri i studentëve, ku me 75 për qind dominojnë maturantët të regjistruar në shkencat shoqërore në raport me 25 për qind të maturantëve të regjistruar në shkencat natyrore. Ekspertët vlerësojnë se papunësia mund të zbutet me anë të përgatitjes të kuadrove që kërkojnë në tregun e punës - në sistemin formal të arsimit të mesëm dhe të lartë e që duhet të reformohet, programeve për fitimin e kualifikimeve dhe shkathtësive në bazë të kërkesë në tregun e punës, nxitjen e mësimi gjatë gjithë jetës e kështu me radhë. Sipas ekonomistëve, një nga zgjidhjet e papunësisë në Maqedoni është rikualifikimi i të papunëve përmes hapjes së shkollave universale për kualifikim profesional në qytetet mbarë vendit e që për shpejt kohë do të mundësojnë rikualifikimin e të papunëve. Në këto shkolla, mësimi do të zhvillohet për 3, 6 apo 12 muaj për kualifikimet që kërkojnë në tregun e punës. Nevojitet të definojnë edhe grupet e prekshme që janë të papunë në mënyrë afatgjate, si dhe ato që rrezikohen të humbin punën në bazë të përkatësisë gjinore, moshës, etnisë dhe përkatësisë fetare, si dhe personat me aftësi të kufizuara që të definojnë masa më efektive për uljen e problemeve që i prekin ato shtojnë njohësit e tregut të punës.

Në kuadër të ndryshimeve që kërkohet të ndodhin në arsim

Të kthehen vizitat e këshilltarëve pedagogjik

"Byroja për Zhvillimin e Arsimit, në të kaluarën ka qenë shumë aktive jo vetëm me hartimin e plan-programe, por edhe në realizimin e tyre përmes monitorimit të punës së mësimdhënësve", pohon profesor Naser Miftari, anëtarë i grupit punues për reforma në shkollat e mesme

Koha Laura PPARANIKU

Shkup, 11 tetor - Reformat në sistemin arsimor nuk mund të pretendohen pa bërë fillimisht shkarkimin e procesit mësimor prej ngarkesave të shumta si në plan programet mësimore, numrin e nxënësve nëpër paralele, ashtu edhe në fondin e orëve që duhet të realizojë një mësimdhënës. Por, paralelisht kësaj, janë edhe

shumë çështje të tjera me shumë rëndësi për frymën dhe filozofin që duhet të ketë arsim në të ardhmen dhe për të cilat Naser Miftari, profesor në Gjimnazin "Zef Lush Marku" në Shkup, konsideron se duhet të trajtohen me mjaft seriozitet në këtë kohë kur Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka ndërmarrë nisim për reforma në përgjithshme arsimore në Maqedoni.

Miftari, i cili është pjesë e grupeve punuese për reforma në arsimin e mesëm, thotë gjithashtu se është koha kur prezencat e nxënësve në shkollë dhe roli i mësimdhënësve të merr një domethënie të re, pra kur nxënësit duhet të jenë pjesë e vendim-marrjes në shkollë dhe kur të qartësohet, siç duhet edhe statusi i profesorëve në raport me gjithçka lidhet me angazhimin e tij. "Nxënësit duhet të jenë më tepër prezent në të gjitha hallkat e procesit mësimor, duke nis nga or-

ganizimi i tyre nëpër bashkësi brenda klasave, shkollës e kështu me radhë. Për këtë mund të merrtet shembull funksionimi i organizatave të nxënësve në vendet fqinje. Shohim, për shembull, se si Kosova ka avancuar tepër në këtë drejtim", shprehet ai, duke shtuar se zëri i nxënësve duhet të dëgjohet shumë më tepër. Sistemi, sipas profesor Miftari, duhet t'ju jep mundësi të gjithë mësimdhënësve për të qenë më të çiltër ndaj shprehjes së përgjegjësisë që ato ndjejnë ndaj nxënësit. Por, çështje që për të mbetet me prioritet të lartë është ajo e këshillimeve pedagogjike. Në takimin e parë të grupeve punuese që u organizua jo shuam kohë më parë, në kuadër të nevojave për reforma në arsimin e mesëm, ai ka kërkuar që këshilltarët pedagogjik t'u kthehen shkollave si në të kaluarën.

"Byroja për Zhvillimin e Arsimit në të kaluarën

ka qenë shumë aktive jo vetëm me hartimin e plan-programe (të cilat gjithashtu duhet të shkarkohen), por edhe në procesin e mënyrave të realizimit të atyre programeve, pra të monitorimit të procesit të mësimdhënies përmes vizitave nëpër shkollë". Me kthimin e vizitave të këshilltarëve pedagogjik, plotëson më tej ai, do të lehtësohet edhe puna e inspektorëve, të cilëve momentalisht u janë deleguar edhe çështje që nuk përkojnë me kompetencat e tyre profesionale, sikurse janë problemet pedagogjike dhe didaktike të mësimdhënies. Madje, inspektorët e arsimit çdo herë në suaza të punëve që u ishin ngarkuar, sipas Miftarit, kanë qenë vënë para presionit që të gjejnë me patjetër gabime diku, të profesorët, shkollat, nxënësit apo prindërit. Shkolla duhet të frymojë lirshëm, të gjithë palët duhet të kenë lirinë e shprehjes së mendimit dhe dhënien e propozimeve se

si të përmirësohet klima pozitive në shkollë dhe cilësia e arsimit.

"Viteve të fundit u ndërprehen vizitat e këshilltarëve, u ngatërruan kompetencat në shkollë dhe gjithë kjo bëri të bie cilësia në arsim", sqaron më tej ai. Reforma, natyrisht duhet të ketë jo vetëm shtrirjen horizontale, por të prek anën vertikale të sistemit.

"Ishte vlerësimi i shumicës së anëtarëve të grupit punues se paralelet nuk duhet të jenë me më shumë se 24 nxënës në klasë. Vetëm në rastet e profileve të veçanta, një paralele mund të ketë deri 28 nxënës në klasë. Mirëpo, për drejtimet gjimnaz dhe pjesën dërmuese të drejtimeve të shkollave të mesme, paralelet duhet të kenë nga 15 deri 24 nxënës në klasë", tregon profesori i Gjimnazit "Zef Lush Marku", në Shkup. Gjatë takimit të parë, që u mbajt në Strugë, ai thotë se është diskutuar edhe çështja e transportit falas të

nxënësve. Vlerëson se duhet të largohet kufizimi i distancës 2.5 kilometra, pasi ka nxënës që jo vetëm jetojnë në distanca më të largëta se kaq me shkollën ku ata mësojnë, por kanë nevojë të lëvizin përtej asaj largësie (2.5 kilometra), për të realizuar punë që lidhen me projektet arsimore ku ata janë të inkuadruar. Krahas arsimit formal, shkollat, sikurse dihet, janë të inkuadruar edhe nëpër projekte të ndryshme arsimore. Në të gjitha këto projekte janë të angazhuar gjithashtu edhe profesorët, mirëpo kjo pjesë e punës nuk u llogaritet në asgjë, as në fondin e orëve të punës dhe as në pagë shtesë. Kjo çështje nuk guxon të anashkalohet. MASH duhet të gjejë mënyrën që ta zgjidhën edhe këtë problem brenda sistemit, ashtu sikurse duhet të jenë vetë mësimdhënësit, në radhë të parë, ata që do të propozojnë format më të pranueshme nga të gjithë.

Ekspertët paralajmërojnë jehonë të vogël tek shqiptarët

Kush do të dijë t'i bindë të pavendosurit

Ekspertët janë të mendimit se karakteristikat individuale të kandidatëve janë pikat kyçe për të bindur të pavendosurit, ndërsa sa i përket jehonës së votuesve - nuk presin të jetë e madhe përqindja siç ishte në zgjedhjet parlamentare

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 11 tetor - Partitë politike në ditët e fundit të fushatës parazgjedhore kanë ndezur motorët në terren, duke bërë luftë të drejtpërdrejtë për të siguruar votat për fitore në komunat ku kandidojnë. Tek partitë shqiptare vërehet një ngritje e toneve kritike se kush më kë po bashkëpunon me partitë maqedonase, ndërsa disa parti kanë filluar të dalin me të dhëna konkrete për keqeverisje nga pushtetarët e deritanishëm. Lufta deri të premtën do të përqendrohet edhe tek të pavendosurit, numri i të cilëve mbetet i lartë duke kaluar 20 përqindëshin bazuar në anketa e fundit të "Brima Gallup" dhe



"Dimitarija Çupovoski". Ndërkaq për ti bindur të pavendosurit, ata nuk do ta kenë të lehtë ngaqë motivacioni për të votuar, siç flasin ekspertët, nuk është i lartë siç ishte në zgjedhjet parlamentare shkaku i zgjatjes së krizës politike dhe institucionale për dy vite me radhë. "Motivimi i qytetarëve për të votuar shihet hapur se do të jetë më i vogël se sa që ishte në zgjedhjet parlamentare", thekson Marko Troshanovski nga Instituti për Demokraci. Siç shton ai, njerëzit më nuk preokupohen të ndryshojnë pushtetin meqë, sipas

Troshanovskit, ai ndryshim veçmë ka ndodhur. Trashanovski mendon se paraqitja personale e kandidatëve për kryetar dhe atyre për këshilltar komunal do jetë vendimtare për të motivuar të pavendosurit që të votojnë. "Dallimi duket që është i vogël mes kandidatëve për kryetar dhe atyre për këshilltar komunal, por në fund do të jetë karakteristika e tyre personale dhe forma e paraqitjes që do të ndikojnë tek të pavendosurit", thekson Marko Trashanovski. Se individualiteti do të këtë ndikim tek të pavendosurit, thotë edhe

eksperti Bekim Kadriu, duke shtuar se edhe Programi zgjedhor tek disa kandidatë do të jetë jo pa impakt tek të pavendosurit. "Zgjedhjet komunale dallojë nga zgjedhjet parlamentare, së pari se komunat janë më afër qytetarëve dhe kanë rëndësi shumë se kush është kandidat për kryetar e që do t'i përgjigjej atyre në aspekt të realizimit të nevojave dhe kërkesave personale. Individualiteti i kandidatëve mund të ketë pak rëndësi tek simpatizuesit e partive, tek të cilat sigla partiake qëndron në rend

të parë kur duan të votojnë, por kur flasim për të pavendosurit - paraqitja individuale, por në masë edhe Programi që premtojnë të realizojnë, e kanë impaktin vendimtar për ti bindur ti votojnë", thekson Kadriu. Ai nuk pret që elektorati shqiptar të jetë i motivuar të dalë në përqindje të madhe në zgjedhje përveç në ato komuna ku deri më tani performansa, siç thotë Bekim Kadriu, ka qenë e nivelit më të ulët.

"Ne, zakonisht për nga dalja nuk e kalkulojmë 50 përqindëshin, ndërsa tek maqedonasit - përqindja është dukshëm më e lartë deri dhe 80. Realisht nuk pres që dhe në këto zgjedhje, te shqiptarët të dalin më shumë se 45 për qind apo dhe 50. Përqindje e lartë mund të ketë tek ato komuna shqiptare ku performansa e udhëheqësve të tanishëm ka qenë e ulët dhe qytetarët mund të ndëshkojnë partinë që ka qeverisur", tha Kadriu. Edhe profesori universitar, Bashkim Selmani, mendon se përqindja e ulët do të jetë karakteristike tek shqiptarët edhe në këto zgjedhje, ndërsa përmend disa shkaqe lidhur me këtë. "Edhe në këto zgjedhje nuk pritet që shqiptarët të dalin të

votojnë në përqindje më të lartë, pasi kemi situatë të njëjtë të ndjeshme si në zgjedhjet e kaluara. Këtu duhet të marrim parasysh përçarjen e trungrut votues shqiptar në tabore jashtë nacionale, një numër i konsiderueshëm jashtë vendit, një numër i të pashpresëve të cilët gjithmonë janë zhgënjyer nga politika aktuale dhe si bashkësi votuese, me këtë gjendje faktike - shqiptaret rrezikojnë të humbin një pjesë të komunave që historikisht u kanë takuar", thekson Selmani. Situata do të qartësohet, mendon ai, në rrethin e dytë zgjedhor edhe atë nga gjindshmëria e koalicionve ndërpartiake. Ndërkaq për të pavendosurit, Selmani thotë se shumica prej tyre janë të zhgënjyer nga qeverisja aktuale komunale dhe nuk kanë shpresë se do të bëjnë më mirë.

"Tek të pavendosurit ndikon zhgënjimi, humbja e shpresave, dhe zemërimi që identifikohet edhe në pjesëmarrjen e tubimeve partiake në numër të vogël si asnjëherë më parë. Por, ndryshe është tek maqedonasit, ku në tubime shohim me mijëra veta, kjo pasi partitë e tyre arrijnë ti motivojnë më shumë", thotë Selmani.

Edhe dy ditë fushatë elektorat

Rriten tensionet në ditët përmblyëse të fushatës

"Pavarësisht se kush nga cila parti vjen, apo se simpatizantë i cilës partitë është, në raste të këtyllë MPB-ja prioritet kryesor do të këtë respektimin e ligjit, i cili duhet të vlejë njësoj për të gjithë. Çdo përpjekje që të fshihet pas policisë se është e 'jona' apo e 'atyre' do të merr përgjigjen e merituar ligjore", ka deklaruar ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski



Shkup, 11 tetor - Maqedonia ka hyrë në javën e fundit të fushatës elektorale, para zgjedhjeve lokale të së dielës më 15 tetor. Për dallim nga pjesa e parë e cila u karakterizua me fushatë kryesisht të qetë dhe pa incidente, pjesa e dytë e fushatës është përcjell me rritje tensionesh. Një kandidat i pavarur për këshilltar është vlarë në Kërçovë, por vrasja thuhet të mos ketë pasur lidhje me politikën. Një tjetër kandidat për kryetar komune është kërcënuar me vdekje, ndërsa një i tretë është rrahur brutalisht nga aktivist të partisë

kundërshtarë. Gjatë kësaj periudhe janë demouluar të paktën dhjetë shtabe partiake. Ministria e Brendshme ka konfirmuar të gjitha këto incidente dhe ka njoftuar se është duke punuar për zbardhjen e plotë të tyre. "Pavarësisht se kush nga cila parti vjen, apo se simpatizantë i cilës partitë është, në raste të këtyllë MPB-ja prioritet kryesor do të këtë respektimin e ligjit, i cili duhet të vlejë njësoj për të gjithë. Çdo përpjekje që të fshihet pas policisë se është e 'jona' apo e 'atyre' do të merr përgjigjen e merituar ligjore", ka deklaruar ministri i

Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. Nga MPB-ja thonë se procesi zgjedhor i dedikohet prezantimit të kandidatëve dhe programeve të tyre para elektoratit, si mënyra e vetme që qytetarët të njoftohen me pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, andaj edhe do të veprojë me të gjitha forcat për respektimin e kësaj vlerë të demokracisë. Parregullsitë në fazën e tyre të fushatës elektorale janë evidentuar edhe nga "MOST", organizata më e madhe joqeveritare për mbikëqyrjen e procesit zgjedhor. "Jemi dëshmitar të demolitit të dhjetë shtabeve

zgjedhore të katër partive më të mëdha politike, si dhe të dëmtimit të materialit zgjedhor në gjashtë komuna të tjera. Për dallim nga pjesa e parë, tani janë regjistruar edhe incidente tjera me pasojë lëndimin e aktivistëve partiake. Gjithashtu kemi regjistruar edhe raste të keqpërdorimit të resurseve shtetërore nga kandidatët për kryetarë të komunave", thuhet në njoftimin e asociacionit qytetar "MOST", e cila i bënë thirrje partive që të përmbahen nga aktet e dhunës dhe të mundësojnë një fushatë elektorale demokratike. (REL)



Pas zgjedhjeve, faqe e re për Maqedoninë

Shkup, 11 tetor - "Maqedonia pas zgjedhjeve ka nisur faqe të re", deklaroi për "Makfax", Piter Fejt, ndërmjetësi në konfliktin e armatosur në vitin 2001. Ai në "Forum in e Sigurisë në Beograd" ka folur për mënyrën e mbajtjes së sigurisë së shteteve të Ballkanit Perëndimor. "Janë mbajtur zgjedhje dhe u zgjedh një koalicion i ri qeverisës, të cilin e përshëndes", tha Fejt duke shtuar se edhe me tej është sfida "me sundimin e së drejtës dhe Prokurorisë Speciale Publike". Përskaaj këtyre sfidave, Fejt tha se "ka shpresë të re për Maqedoninë". I pyetur për dygjuhësinë në Maqedoni, diplomati holandez, Fejt tha se ky ligj është i paraparë me Marrëveshjen e Ohrit që nga viti 2015 dhe zbatimi i të njëjtit do të kontribuonte në kohezionin social të Maqedonisë. "Qëllimi i ligjit të gjuhëve është që të përforcohet kohezioni social në Maqedoni. Ligji i gjuhëve nuk do ta ndajë Maqedoninë", vlerësoi Fejt. Ai debatin e zgjatur për ligjin e gjuhëve e vlerësoi si të gabuar pasi që me të njëjtin dhe paralelisht me gjuhën shqipe do të avancohen edhe gjuhët tjera të entiteteve që do të kenë përbërje prej 20%. "Në fund Maqedonia do të jetë më e fuqishme, nëse të gjitha etnitete dhe grupet do të jenë të barabarta", tha Fejt.



Zoran Dimov zgjidhet kryetar i ri Odës së Përmbauesve të Maqedonisë

S'ka bllokadë të llogarive për rastet sociale

Dimov paralajmëron gjithashtu se kryesia e OPM-së do të kërkojë përfundimin e qytetarëve nga përbarimi, gjegjësisht rasteve sociale të mos u bllokohen llogaritë bankare



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 11 tetor - Përmbauesit e Odës së Përmbauesve të Maqedonisë (OPM) në mbledhjen e jashtëzakonshme që u mbajt të martën - për kryetar të ri zgjedhën përmbauesin Zoran Dimov. Sipas OPM-së, nga gjithsej 100 anëtarë - për Dimovin votuan 65 përmbaues, 22 votuan kundër ndërsa 14 përmbaues nuk ishin prezentë në mbledhje. Mbledhja e jashtëzakonshme u mbajt me kërkesë të një numri të madh të përmbauesve për shkak të akumulimeve të shumta të pakënaqësive të punës së përmbauesve, sidomos në pjesën që ka të bëjë me pagesën e dhunshme të borxhin, si dhe në shpërndarjen e jo të barabartë të lëndëve midis përmbauesve. Për shkak të pakënaqësisë të përmbauesve, 64 përmbaues dy muaj më parë nënshkruan peticion për shkarkimin e, tani ish-kryetarit Zoran Petrovski, i cili më pas dha dorëheqje të parakohshme nga funksioni i kryetarit të

OPM-së. Kryetari i ri, Zoran Dimov, thotë se gjatë mandatit të ardhshëm do të punojnë profesionalisht dhe në programin e ri, i cili u pranua nga përmbauesit, parashihen ndryshime të shumta të Ligjit për përbarim. "Ndryshimet që parashihen në Ligjin për përbarim do të mundësojnë që qytetarët të jenë më të kënaqur me mënyrën se si do të përmbaohen, por edhe përmbauesit do të jenë të barabartë sa i përket shpërndarjes së lëndëve për përbarim e jo si deri tani - kur pjesën më të madhe të lëndëve e kanë marrë një numër i vogël i përmbauesve, të cilët kanë realizuar të hyra vjetore shumë të larta si dhe përfitime enorme personale" deklaroi

Dimov. Dimov paralajmëron gjithashtu se kryesia e OPM-së do të kërkojë përfundimin e qytetarëve nga përbarimi, gjegjësisht rasteve sociale të mos u bllokohen llogaritë bankare. "Do të kërkojmë nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të përgatisin regjistër të saktë për të gjithë kryefamiljarët që janë bartës të ndihmave sociale dhe ai person që është bartës i ndihmave sociale, në të ardhmen nuk do të mund asnjë përmbaues ta bllokojë llogaritë e tij. Të gjithë këta persona nuk do të jenë pjesë e lëndëve për përbarim", deklaroi Dimov. Njëherësh, sipas tij, kryesia e re e OPM do të realizojë takime më të gjitha bankat komerciale në vend që në të ardhmen - të hyrat

e qytetarëve në llogaritë bankare si rroga, bankat të bllokojnë vetëm një të tretën e rrogës e jo rrogën e plotë siç ka qenë deri më tani. "Bankat të cilët do të pranojnë urdhëresa nga përmbauesit për bllokim të rrogës së borxhliut nuk do të mund ta bllokojnë rrogën e plotë, por vetëm një të tretën e rrogës. Nëse borxhliu ka të bllokuar një të tretën e rrogës me urdhër të përmbauesit dhe nëse ky qytetar ka lëndë tjetër te përmbauesi tjetër, përmbauesi nuk do të ketë të drejtë të kërkojë bllokimin e një të tretës së rrogës derisa qytetari nuk e paguan borxhin e mëparshëm", thotë Zoran Dimov, kryetari i ri i Odës së Përmbauesve të Maqedonisë.

Autostrada drejtë Greqisë gati në mars 2018?

Shkup, 11 tetor - Autostrada drejtë Greqisë në aksin Demir Kapi-Smokvicë duhet të lëshohet në përdorim më së voni në fillim të muajit mars të vitit të ardhshëm, kumton Qeveria e Maqedonisë. Në seancën e së martës mbrëma është vendosur të nënshkruhet aneksi me të cilin vazhdon afati për ndërtim deri më 28 shkurt 2018. "Përpos vazhdimit të afatit, aneksi parasheh edhe mjete shtesë për punët ndërtimore që duhet të realizohen deri në përfundimin e autostradës", qëndron në komunikatën e Qeverisë. Nevojiten edhe 850.000 euro për punët ndërtimore. Qeveria thonë se këto mjete janë siguruar nga borxhi aktual që është marrë për realizimin e projektit. Ky aks është i gjatë 28 kilometra, kushton 280 milionë euro, ndërsa ka filluar të ndërtohet në vitin 2012 dhe duhet të lëshohet në përdorim në shtator të vitit 2017.

Rritja ekonomike, Maqedonia e fundit në rajon

Shkup, 11 tetor - Maqedonia këtë vit do të ketë rritje ekonomike prej 2.5 për qind, sipas raportit të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për perspektivën ekonomike botërore. Kosova, siç thuhet në Raportin e FMN-së, do të ketë rritje ekonomike prej 3.5 për qind, ndërsa nga shtetet e rajonit, përveç Maqedonisë, rritjen më të vogël ekonomike do ta ketë Bosnja e Hercegovina me 2.3 për qind, Kroacia me 2.9 dhe Serbia me 3. Mali i Zi, sipas raportit të FMN-së, do të ketë rritje ekonomike prej 3 për qind, Bullgaria 3.6, Hungaria 3.2, Rumania 5.5 dhe Shqipëria 3.7 për qind. Në këtë grup të shteteve, FMN e ka përfshirë edhe Poloninë e cila do të duhet të kishte rritje ekonomike prej 3.8 për qind dhe Turqia me 5.1 për qind. Për vitin e ardhshëm, FMN parasheh që Kosova të ketë rritje të njëjtë ekonomike, bashkë me Turqinë, prej 3.5 për qind. Edhe Shqipëria pritet të ketë rritje të njëjtë ekonomike, prej 3.7 për qind për vitin e ardhshëm, ndërsa Serbia parashihet të ketë rritje prej 3.5 për qind. Rritje më të madhe se Serbia do të ketë, veç Shqipërisë, edhe Rumania me 4.4 për qind.

Barometri Ballkanik publikon Raportin

Rritet numri i atyre që duan të largohen nga vendi

Nëse në vitin 2016, për të braktisur Maqedoninë ishin shprehur të gatshëm 40 për qind e të anketuarve, sivjet - kjo përqindje është për 5 më e madhe se e vitit të kaluar, apo edhe 10 për qind më shumë se sa në 2015, ku 35 për qind e qytetarëve të Maqedonisë ishin shprehur se janë gati ta lëshojnë vendin



Shkup, 11 tetor - Sivjet, 5 për qind më shumë sesa vitin e kaluar, është rritur numri i qytetarëve që duan të braktisin Maqedoninë. Kështu tregon anketa e Barometrit Ballkanik, ndërsa theksohet se tendenca për t'u larguar nga vendi rritet nga viti në vit. Kështu,

nëse në vitin 2016, për të braktisur Maqedoninë ishin shprehur të gatshëm 40 për qind e të anketuarve, sivjet - kjo përqindje është për 5 më e madhe se e vitit të kaluar, apo edhe 10 për qind

më shumë se sa në 2015, ku 35 për qind e qytetarëve të Maqedonisë ishin shprehur se janë gati ta lëshojnë vendin. Ndërkohë, edhe në Shqipëri të dhënat janë shqetësuese. Gjysma e

shqiptarëve kanë marrë në konsideratë që të largohen dhe të punojnë jashtë vendit. Por, sipas anketimit që ka bërë Barometri i Ballkanit, ndërsa në Shqipëri tendenca për të ikur po rritet

nga viti në vit, në Kosovë çuditërisht ka rënie.

Rezultatet e sondazhit treguan se gjatë vitit të kaluar 48 për qind e shqiptarëve dëshironin të iknin nga vendi, ndërsa këtë vit kjo kategori arriti në 50 %, ndërsa në Kosovë përqindja e atyre që do të dëshironin të braktisin vendin ishte 48, sivjet sipas këtij anketimi kjo kategori ka rënë në 37 për qind, transmeton Monitor rezultatet e anketimit të Barometrit të Ballkanit. Shqiptarët bashkë me boshnjakët renditen të parët në rajon me dëshirën e lartë për lënë vendin. Por ndryshe nga Shqipëria, në Bosnje ritmi i dëshirës për të lënë vendin ka rënë në tre vitet e fundit. Në vitin 2015, 58% e boshnjakëve dëshironin të jectonin dhe punonin jashtë,

ndërsa më 2017 duan të largohen 50%. Në Shqipëri në vitin 2015 donin të ikin jashtë vendit 38% e shqiptarëve, ndërsa në vitin 2017, 50 për qind e tyre duan të lënë vendin, ndërsa në Kosovë më 2015 donin të largoheshin 49 për qind e të anketuarve, kurse më 2017-37. Tendenca e shqiptarëve u rrit ndjeshëm pas heqjes së vizave. Udhëtimet në Evropë u bënë të zakonshme për të gjitha shtetst, ndaj në kërkim të një jetë më të mirë tendenca për të emigruar është rritur. Heqja e vizave ka pasur një efekt të ngjashëm edhe në rajon, por jo në të njëjtën masë si në vendin tonë. Shqipëria ka nivelin më të ulët të ardhurave për frymë dhe është ndër vendet më të varfra në rajon.



Sipas rekomandimit të fundit të Qeverisë, Ligji për komunikime elektronike mund të jetë lëndë e vlerësimit të kushtetutshmërisë së tij, por jo edhe neni 175, nen ky që obligon operatorët e telekomunikimit, me harxhimet e tyre të sigurojnë dhe mirëmbajnë interfejsin e duhur dhe të vendosin komunikime elektronike për transmetim deri të organi kompetent për përcjellje, në këtë rast DSK dhe MPB

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 11 tetor - Qeveria e Maqedonisë në mbledhjen e fundit të mbajtur të martën mbrëma e ka miratuar rekomandimin drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë, nga e cila kërkohet ndalim i debatit për shqyrtimin e nenit 175 të Ligjit për komunikime elektronike. Dispozitat e nenit në fjalë, sipas përmblajtjes aktuale të këtij Ligji, Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim i mundëson përgjimin e qytetarëve përmes operatorëve telefonik. Në rekomandimin e Qeverisë, thuhet se ky vendim është marrë në koordinim me sektorët tjerë të qeverisë, respektivisht këtij rekomandimi i ka paraprirë vlerësimi profesional i Ministrisë për Administratë dhe Shoqërisë Informatike, Sekretariatit për çështje juridike dhe Ministrisë së Financave. "Në kuadër të këtij rekomandimi, ne mendojmë se neni 175 i Ligjit për komunikime elektronike aspak nuk ndërhyjnë në procesin e përcjelljes së komunikimeve, pasi sipas amendamentit XIX të Kushtetutës, vetëm në bazë të një vendimi gjyqësor, nën kushte dhe në një procedurë të përcaktuar me Ligj, mund të hiqet dorë nga e drejta e përkrahshëmërisë së komunikimeve. Kështu që, sipas këtij rekomandimi të miratuar nga Qeveria, Ligji për komunikime elektronike mund të jetë lëndë e vlerësimit të kushtetutshmërisë së tij, por jo edhe neni 175 i Ligjit në fjalë", thuhet në njoftimin e Qeverisë.

Përmblajtja kontestuese e nenit 175 nga Ligji për komunikime elektronike, është në fuqi që nga viti 2014, dhe prej atëherë e deri më sot - kjo nor-

Qeveri miraton rekomandim për Ligjin për komunikime elektronike

Përgjimet, ashtu siç kanë qenë në kohën e VMRO-së



më ligjore i obligon operatorët e telekomunikimit, me harxhimet e tyre, të sigurojnë dhe mirëmbajnë pajisjen, interfejsin e duhur dhe të vendosin komunikime elektronike për transmetim deri të organi kompetent për përcjellje. Ligji për komunikime elektronike, në këtë rast neni 175, përbëhet nga 10 paragrafë, të cilët po ashtu gjenden në raportin e vendimit të "Pribes", i cili i rekomandon Qeverisë, realizimin e reformave urgjente në këtë drejtim, megjithatë në vendimin e fundit të Qeverisë, nuk jepet sqarime se pse ky propozim i tyre nuk përputhet me vërejtjet e Komisionit Evropian. "Në rast kur operatorët kanë të vendosur kompresim, ose kriptombrojtje të lëvizjes së komunikimeve, ata janë të obliguar ta largojnë një pengesë të tillë, para se përmblajtjen e komunikimit të përcjellë dhe ta dorëzojnë deri të organi përkatës për përcjellje të komunikimeve. Njëherësh, de-tyrë e operatorëve të telekomunikimeve është dhënia e mundësisë organit përkatës për përcjellje të komunikimeve, përcjelljen e komunikimeve në kohë reale. Informacioni i komunikimit të përcjellë duhet të jetë në dis-

pozicion menjëherë pas përfundimit të komunikimit, ndërkohë përcjellja e komunikimit duhet të realizohet pandërprerë, gjatë gjithë kohës përdoruesi ajo zhvillohet", thuhet mes tjerash në paragrafin 5 dhe 6 të nenit 175 të Ligjit për komunikime elektronike. Propozimin e gjykatëses Vangelina Markudova, e cila njëherësh është gjykatëse-njoftuese për këtë lëndë, në korrik të këtij viti e pranuan shumica e gjykatësve në Gjykatën Kushtetuese, gjegjësisht pro shqyrtimit të këtij iniciative votuan gjykatësit Sadi Murati, Natasha Gaber-Damjanovska, Ismail Dardhishta dhe Gëzime Starova. Përdoruesi "kundër" kësaj iniciative u prononcuan kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Nikolla Ivanovski, dhe gjykatësit Jovan Josifovski, Elena Gosheva dhe Vladimir Stojanoski. Gjykatësit të cilin votuan "për", po ashtu shprehën dyshimet për mënyrën se si është rregulluar Ligji për komunikime elektronike, duke nënvizuar se neni 168 i cili ende nuk është futur në procedurë debati dhe neni 175, i mundësojnë Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Ministrisë për Punë të Brendshme, në mënyrë pakon-

trolluar t'i përcjellin komunikimet e qytetarëve përmes operatorëve telefonik. Ndryshe, Gjykata Kushtetuese vendimin përfundimtar për këtë iniciativë duhej ta miratonte më 27 shtator, megjithatë marrja e vendimit final u prolongua për shkak se nuk kishte kuorum për miratimin e vendimit, sepse më 31 korrik të këtij viti, mandati nëntëvjeçar i gjykatësit Ismail Dardhishta kishte përfunduar, ndërkohë ditë më parë, më 7 tetor - mandati nëntëvjeçar si gjykatës në Gjykatën Kushtetuese i përfundoi edhe gjykatësve Natasha Gaber-Damjanovska dhe Gëzime Starova. Çështja e përcjelljes së bisedave telefonike në Maqedoni është aktuale që nga shkurti i vitit 2015-të, atëherë kur opozita e atëherëshme, tashmë shumicë qeveritare, publikoi skandalin më të madh të përgjimeve në vendin tonë. Nga ajo kohë e deri më sot, rekomandimet dhe vërejtjet nga bashkësia ndërkombëtare për reformimin e sistemit të sigurisë në Maqedoni nuk kanë të ndalur, megjithatë pothuajse pas tre vitesh të kaosit në strukturat e larta të shtetit, kjo sferë ende nuk i është nënshtruar reformave thelbësore.

Kronikë

Policët penguan tentim për vetëvrasje në Ohër

Katër zyrtarë të Sektorit për Punë të Brendshme në Ohër sot kanë penguar një grua që të kryejë vetëvrasje, e cila kishte vendosur të hidhet nga kati i pestë i një ndërtese në bulevardin "Turistička". Siç njoftojnë nga SPB Ohër, katër zyrtarë policorë kanë intervenuar pas paralajmërimeve që kanë marrë nga banorët tjerë për tentimin për vetëvrasje. Aksioni për shpëtim të gruas ka zgjatur gati një orë, me ç'rast së pari është bërë sigurimi i ndërtesës dhe janë ndërmarrë masa për pengimin e gruas gjatë vetëvrasjes. Gruaja e cila ka tentuar të vetëvritet është e moshës 41-vjeçare, e cila është dërguar në Ndhimën e Shpejtë në Ohër.

Sulmohet fizikisht një nxënës në autobusin me numër 65

Një nxënës ka mbetur i lënduar pasi një grup të rinjsh e kanë shtyrë nga autobusi me numër 65 i cili po shkonte drejt fshatit Stajkovc. Rreth orës 19 në Shkup në rrugën "Alija Avdoviq", në autobusin me numër 65 në drejtim prej lagjes Cento në Stajkovci, më saktë tek stationi i autobusit tek Shkolla fillore "25 Maji", një grup prej rreth dhjetëra të rinjve e kanë shtyrë nga autobusi një 17 vjeçar të fshatit Smilkovc, nxënës i vitit të katërt në shkollën e mesme ASUC, si dhe fizikisht e kanë sulmuar duke e goditur me shqelma dhe grushte në trup dhe kokë. Në një moment njëri nga sulmuesit e ka goditur me pajisje të rëndë në kokë, pas çka grupi ka ikur. Me automjetin e ndihmës së shpejtë i riu është dërguar në Spitalin e Qytetit "Shën Naumi i Ohrit", ku i është dhënë ndihma mjekësore. Policia po ndërmerr të gjitha masat për zbardhjen e rastit.

Rrahje në tubimin e VMRO-së në Shutkë

Në tubimin e mbrëmshëm të VMRO-DPMNE-së ka ndodhur një rrahje, informojnë nga MPB-ja. Sipas policisë, në lagjen Shutkë në tubimin parazgjedhor të partisë politike VMRO-DPMNE, M.K (17) duke lëvizur përmes masës së tubuar ka tentuar të hip në mur që të ketë pamje më të mirë, me çka ka shtyrë një person aty afër ku është krijuar zënkë. Ai më pas është sulmuar fizikisht nga disa persona që kanë qenë bashkë me personin me të cilin filloi zënkë. Në spitalin e qytetit i janë konstatuar lëndime trupore, ndërsa merren masa për zbardhjen rastit. (O.Xh)

Memorandum me esnafin e Çarshisë së Vjetër

Shkup, 11 tetor - Memorandum për bashkëpunim me të cilin do të mundësohet revitalizezim dhe modernizim i infrastrukturës së Çarshisë së Vjetër të Shkupit nënshkruan tw mwrkurwn kryeministri, Zoran Zaev dhe kandidati për kryetar të Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov me esnafin e Çarshisë. "Këtu jemi së bashku me të gjithë që ta japim fjalën tonë. Kjo Çarshi do të ringjallet. Kjo çarshi është shtëpi e esnafëve, por edhe shtëpi e çdo familje esnafa e cila e di rëndësinë e saj për Shkupin. Kjo Çarshi nuk është vetëm roje e zanateve të ndryshme dhe të çmuara, nuk e lidh vetëm të kaluarin me të tanishmen. Kjo çarshi është simbol i unifikimit të diversiteteve, të bashkësisë sonë, të së ardhmes tonë të pë-



bashkët. Prandaj janë mjaft të arsyeshme dhe të pranueshme kërkesat e esnafëve për sigurimin e kushteve të infrastrukturës me të cilat edhe ne si ata besojmë se do ta kthejmë jetën në çarshinë për të gjithë,

tha Zaev në deklaratën për media. Kryetari i esnafit të Çarshisë së Vjetër, Bejtulla Morina nënvizoi se kjo është hera e parë esnafi, dyqanxhinjtë të ulen me kryeministrin e shtetit të dakordohen për punë

konkrete dhe projekte të cilat janë interpretuar në dokument të cilat duhet të realizohen me qëllim të zgjidhjes së çështjeve më të rëndësishme për çarshinë dhe esnafin. Si kryesor e theksoi problemin me vendparkingjet. "Ne në dokument i futëm garazhet trekatëshe të cilat do ta zgjidhin këtë problem. Ekzistojnë edhe një sërë të tjera, si ndriçimi, rinovimi e kallërmave. Me ligj duhet të rregullohet edhe çështja për të drejtën e përdorimit të sipërfaqeve publike nga restorantet dhe dyqanet për të cilat do të paguajnë edhe kompensim. Lidhur me instalimin elektrik ai duhet të jetë nëntokësor, ndërsa duhet të ketë edhe kablo optike për internet cilësor me çka do të kemi se çfarë t'u ofrojmë mysafirëve", thotë Morina.

KOMUNA E BUTELIT
KRYETARI I KOMUNËS
Nr. 09-571/11 e datës 10.10.2017
Shkup

Në bazë të nenit 35, ndërsa në lidhje me nenin 51 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 dhe 163/2016), Kryetari i Komunës së Butelit në vijim publikon:

LAJMËRIM

Lajmërohen qytetarët dhe subjektet juridike se Kryetari i Komunës së Butelit ka sjellë Vendim për organizim të

PREZANTIM PUBLIK DHE ANKETË PUBLIKE

Për Projektin arkitektonik-urbanistik për formimin e parcelës ndërtimore PN nr. 4.1 në pjesën nga PK nr. 976/1 me qëllim G3 – Shërbime, në Bllokun 4 nga PUJVB për zonë industriale Vizbeg (përpunim i Bllokut 12), KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup

Hapësira e definuar për përpunimin e Projektit arkitektonik-urbanistik për formimin e parcelës ndërtimore PN nr. 4.1 në pjesën nga PK nr. 976/1 me qëllim G3 – Shërbime, në Bllokun 4 nga PUJVB për zonë industriale Vizbeg (përpunim i Bllokut 12), KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup me pozitën e saj gjendet në territorin e Komunës së Butelit. Sipërfaqja e shtrirjes projektuese është 421m².

Kufiri i përfshirjes projektuese është shfaqur me vijë, e cila i lidhë të gjitha pikat e thyeshme, e prezantuar me koordinatat përmes X dhe Y për secilën pikë të thyeshme, të shënuar me numra rendir prej T1 deri në T11 dhe të njëjtat janë dhënë në pasqyrën tabelore.

X	Y
T1 75333433.84	4654710.07
T2 7533446.20	4654714.81
T3 7533477.77	4654676.66
T4 7533472.10	4654676.58
T5 7533464.76	4654677.97

T6 7533462.36	4654678.99
T7 7533462.09	4654679.96
T8 7533457.97	4654681.21
T9 7533452.94	4654689.99
T10 7533447.57	4654696.37
T11 7533444.92	4654704.24

Kufiri i përfshirjes projektues i përfaqësuar në mënyrë përshkruese duke filluar nga kufiri verilindor me bul. “Nikolla Karev” – A4, kështu duke lëvizur nëpër anën veriperëndimore kufizohet me PK nr. 976/2, vazhdon përmes anës jugperëndimore ku kufizohet me rrugën e porsaplanifikuar shërbyese S13 dhe vazhdon përmes rr. 1 të porsaplanifikuar qasëse deri në ngjitjen me Bul. “Nikolla Karev” – A4 ku edhe përfundon.

Projekti i përpiluar Arkitektonik-urbanistik me shtojcat grafike do të ekspozohet në vend publik në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën e takimeve (Salla e vogël).

Anketa publike do të mbahet prej më 17.10.2017 deri më 24.10.2017 (së paku pesë

ditë pune), çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 15.30 në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën për takime (Salla e vogël).

Në afatin e caktuar subjektet e interesuara juridike dhe fizike mund të parashtrajnë vërejtje në listat anketuese në formë elektronike përmes sistemit informatik e-urbanizam ose në formë me shkrim.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike mund të merren në Komunën e Butelit (sportel).

Lajmërimi për organizim të të anketës publike është publikuar në Shtypin ditor Veçer dhe Koha, në sistemin informatik e-urbanizam dhe në ueb faqen e Komunës së Butelit.

Prezantimi publik në lidhje me Projektin arkitektonik-urbanistik do të mbahet në lokalet e Komunës së Butelit, në Sallën e takimeve (Salla e vogël) më datë 19.10.2017 me fillim në ora 10:00.

KRYETARI I KOMUNËS SË BUTELIT
Petre Latinovski

KOMUNA E BUTELIT
KRYETARI I KOMUNËS
Nr. 09-1121/6 e datës 10.10.2017
Shkup

Në bazë të nenit 35, ndërsa në lidhje me nenin 51 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 dhe 163/2016), Kryetari i Komunës së Butelit në vijim publikon:

LAJMËRIM

Lajmërohen qytetarët dhe subjektet juridike se Kryetari i Komunës së Butelit ka sjellë Vendim për organizim të

PREZANTIM PUBLIK DHE ANKETË PUBLIKE

Për Projektin arkitektonik-urbanistik për formimin e parcelës ndërtimore në PK 1060 me qëllim G2 – Industria e lehtë dhe jondotëse, në Bllokun 5 nga PUJVB për zonë industriale Vizbeg (përpunim i Bllokut 12), KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup

Hapësira e definuar për përpunimin e Projektit arkitektonik-urbanistik për formimin e parcelës ndërtimore në PK 1060 me qëllim G2 – Industria e lehtë dhe jondotëse, në Bllokun 5 nga PUJVB për zonë industriale Vizbeg (përpunim i Bllokut 12), KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup me pozitën e saj gjendet në territorin e Komunës së Butelit.

Shtrira projektuese që është lëndë e këtij dokumentacioni projektues, kapë hapësirë prej 4221 m² (0,42 ha).

Projekti i përpiluar Arkitektonik-urbanistik me shtojcat grafike do të ekspozohet në vend publik në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën e takimeve (Salla e vogël).

Anketa publike do të mbahet prej më 17.10.2017 deri më 24.10.2017 (pesë ditë pune), çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 15.30 në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën për takime (Salla e vogël).

Në afatin e caktuar subjektet e interesuara juridike dhe fizike mund të parashtrajnë vërejtje në listat anketuese në formë elektronike përmes sistemit informatik e-urbanizam ose në formë me shkrim.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike mund të merren në Komunën e Butelit (sportel).

Lajmërimi për organizim të të anketës publike është publikuar në Shtypin ditor Veçer dhe Koha, në sistemin informatik e-urbanizam dhe në ueb faqen e Komunës së Butelit.

Prezantimi publik në lidhje me Projektin arkitektonik-urbanistik për objekt industrial (G2) në PK 1060 nga PUJVB: Zonë industriale Vizbeg (përpunim i Bllokut 12), KK Vizbeg, Komuna e Butelit – Shkup do të mbahet në lokalet e Komunës së Butelit, në Sallën e takimeve (Salla e vogël) më datë 19.10.2017 me fillim në ora 11:00.

KRYETARI I KOMUNËS SË BUTELIT
Petre Latinovski



Punët pengojnë automjetet e rënda

Kaos në bulevardin kryesor



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 11 tetor - Fillimi i rregullimit të rrugës afër kazermës së qytetit të Tetovës ka bërë që bulevardet tjera të jenë në kaos të vërtetë në Tetovë. Kjo, pasi që rruga "Bllagoja Toska" që shfrytëzohet transit nga automjetet e rënda është e mbyllur për qarkullim gati se një javë për shkak të punimeve. Duke shmangur këtë rrugë, automjetet e rënda tashmë shfrytëzojnë bulevardin kryesor në qytetin e Tetovës, "Marshall Tito", që është një nga bulevardet më të ngarkuara në këtë periudhë.

Së këndejmi kamion të mëdhenj tashmë krijojnë kaos të vërtetë në pjesën qendrore të Tetovës, duke mos mundur të lëvizin lirshëm për shkak të numrit të madh të veturave të parkuara dhe

frekuentimit të automjeteve. Kjo edhe për shkak se në rrugën "Strasho Pinxhur" që shpie për te shkolla e muzikës, kamionët e mëdhenj nuk mund të qarkullojnë, sidomos ata që janë me rimorkio. Tetova tashmë një javë është në kaos të vërtetë, pikërisht duke mos pasur rrugë tjetër transite. Projekti është gati një kohë të gjatë, por i njëjti nuk gjen zbatim nga ana e Qeverisë dhe pushtetit lokal. Ekspertët e infrastrukturës theksojnë se zgjidhje më e mirë, do të jetë që të realizohet një pjesë e krahut të qarkores në hyrje të Tetovës prej Shkupit, që do të drejtonte automjetet e rënda deri në fshatin Neproshten të Komunës së Tearcës. Profesor i Vullnet Palloshi, thotë që në vitin 2000 ka përpiluar projekt ideor për ndërtimin e këtij krahut nga Tetova, por i

njëjti nuk është marrë parasysh dhe qëndron në sirtarët e qeverisë.

"Zgjidhja e vetme për atë pjesë të stërngarkuar të komunikacionit në Tetovë, ku për fat të keq kemi edhe viktima, është ndërtimi i qarkores që në hyrje të Tetovës, nga rreth-rrrotullimi të Qendra tregtare "Pallma Mall" e deri në fshatin Neproshten. Në vitin 2000 kur ka qenë drejtor i Agjencionit të rrugëve, kam hartuar një projekt ideor për krahun e qarkores, por i njëjti është në qeveri tash e 17 vite dhe qeveria nuk gjen vullnet ta realizojë. E ka harruar të njëjtin, kurse pasojat janë katastrofale për qytetarët, sepse hyjnë në qytet kamion të rëndë", deklaroi Palloshi. Përderisa autoritetet kompetente nuk janë të interesuar për të realizuar këtë projekt që do të

Përderisa autoritetet kompetente nuk janë të interesuar për të realizuar këtë projekt që do të rregullonte komunikacionin në këtë pjesë të qytetit dhe do të shkarkonte rrugën Tetovë-Jazhincë, automjetet e rënda do të vazhdojnë të qarkullojnë, duke shkaktuar edhe viktima edhe komunikacion të dendur

rregullonte komunikacionin në këtë pjesë të qytetit dhe do të shkarkonte rrugën Tetovë-Jazhincë, automjetet e rënda do të vazhdojnë të qarkullojnë, duke shkaktuar edhe viktima edhe komunikacion të dendur. Sipas tij, nëse do të realizohej ky projekt, atëherë lehtësimet do të ishin shumë të mëdha si për vozitësit, po ashtu edhe për banorët e fshatrave Poroj, Nperoshten dhe Xhepcisht.

"Me këtë projekt, nëse do të fuqizohej dhe realizohej, atëherë krahas që automjetet e rënda nuk do ta shfrytëzonin aspak këtë hyrje, por rreth 30 për qind do të lehtësohej komunikacioni. Nga ana tjetër, edhe banorët e fshatrave Xhepcisht dhe Poroj, por edhe të fshatrave të Komunës së Tearcës, do të shfrytëzonin këtë rrugë për në Shkup, pa hyrë aspak në Tetovë. Por, si duket nuk ka interesim për një gjë të tillë, prandaj edhe ndodhin këto aksidente dhe kaos në trafikun në atë pjesë të Tetovës", tha Palloshi. Tetova tashmë një javë është në kaos të vërtetë, pikërisht duke mos pasur rrugë tjetër transite.

Fillon Skupi Festival 2017



E para në skenë "Shtëpia e Bernarda Albës"

Shkup, 11 tetor - Nën moton "Për frymë të shëndoshë" prej të enjtes e deri 18 tetor fillon Edicioni i 11-të i Festivalit ndërkombëtar i teatrove, "Skupi Festival", në të cilin do të shfaqen shtatë shfaqje nga Shqipëria, Kosova, Izraeli, Serbia, Rusia, Irani dhe Bullgaria.

E para në skenë, me fillim në ora 20, në ambientet e Suli hanit, ngjitet shfaqja "Shtëpia e Bernarda Albës" nga Lorca në regji të Qëndrim Rijanit, ndërkaq në interpretim të Teatrit "Andon Zako Çajupi" nga Korça.

"Shtëpia e Bernarda Albës" - Nga autori Federiko Garcia Lorca është një 'Eksterier Spektakël'. Jemi përpjekur që të gjithë përrallën ta përshtatim me vendin e veprimit, ndërkohë që publiku bëhet bashkëvuajtës me personazhet, ndihmuar kjo edhe nga vetë vendi i veprimit. Si rrallë herë, ai në këtë rast do të ketë mundësinë për të parë një shfaqje në një shtëpi reale gjegjësisht në 'Shtëpinë e Bernardës'.

Në këtë shfaqje paraqiten aktorët: Zamira Kita, Klodjana Keco, Gladia Harizaj, Blerita Belliu, Dasara Xhangolli, Linda Jarani, Ilda Pepi dhe Sotiraq Bratko dhe këngëtarët Laxarela Deti, Niki Petriti.

Pritet që në fundjavë të nënshkruhet marrëveshje mes qeverisë, menaxhmentit të fabrikës dhe sindikatës për rihapjen e kombinatit. Punët janë në pikën zero dhe nuk ka asnjë informatë se kur mund të rifillojë vendosja e filtrave, ndërsa pikërisht mungesa e filtrave ishte shkak kryesor që kjo fabrikë u mbyll nga inspektorati i Ministrisë së Ekologjisë

Tetovë, 11 tetor - Kombinati Jugohrom në Jegunovcë, së shpejti pritet të rifillojë me punë. Punët për vendosjen e filtrave nuk kanë vazhduar që kur në vjeshtë u hodh gurëthemeli. Punët janë në pikën zero dhe nuk ka asnjë informatë se kur mund të rifillojë vendosja e filtrave, ndërsa pikërisht mungesa e filtrave ishte shkak kryesor që kjo fabrikë u mbyll nga inspektorati i Ministrisë së Ekologjisë. Po ashtu gjatë ditës ka reaguar edhe Lëvizja "Nëna dhe fëmija",



e cila proteston kundër nënshkrimit të një marrëveshje me fabrikën Jugohrom, pa instalimin e filtrave ekologjik.

"Lëvizja Nëna dhe Fëmija dhe qytetarët e Tetovës nuk do të lejojnë hapje të fabrikës pa instalimin e filtrave ekologjik që me vite u premtuan dhe asnjëherë nuk u realizuan. Për këtë do të protestojmë, siç kemi protestuar deri më tani,

Ambientalistët paralajmërojnë protesta

Pa filtra, s'lejojmë Jugohromin

premtimeve të kryeministrit Zoran Zaev dhe partive të koalicionit se qeveria e re do të angazhohet rreth ambientit jetësor dhe për një Maqedoni më të pastër, duke siguruar ambient dhe ajër të pastër për gjithë qytetarët e Maqedonisë.

Përkujtojmë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë që prej ditës së mbylljes së Fabrikës Jugohrom, Tetovës, iu kthye çiltërsia e qiellit, ajri i freskët i Malit Sharr, u largua mjegulla e zezë vdekjeprurëse që mbulonte qytetin tonë gjatë këtyre viteve kur Fabrika Jugohrom punonte dhe helmonte qytetarët e Tetovës", thuhet në reagimin e Lëvizjes Nëna dhe Fëmija.

Në ndërkohë, nga Sindikata e Punëtorëve thonë se presin që gjatë fundjavës të nënshkrua-

jnë marrëveshje me qeverinë që të rifillojë me punë ky kombinat. Por, kryesindikalisti i punëtorëve të Jugohromit, nuk jep sqarime se pse punët për vendosjen e filtrave janë ndërprerë. "Nuk kam koment se pse nuk kanë vazhduar punët për vendosjen e filtrave. Mendoj se me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje një herë e për gjithmonë do zgjidhet problemi i të punësuarve të Jugohromit që të kthehen në vendet e tyre të punës dhe kapitulit tjetër do mbyllet një herë e për gjithmonë dyshimi për ndotjen sa i përket Jugohromit. Në këtë marrëveshje parashihet edhe ndërtimi i filtrave në faza" tha Bajram Hamiti, kryetar i Sindikatës së punëtorëve të Jugohromit. Kanë reaguar shoqatat ambientaliste. Arjanit Xhaferi, i cili ka kërkuar

që të bëhet publike marrëveshja, në të kundërtën do të ketë sërish revolt të qytetarëve.

"Jugohromi nuk guxon të hapet pa përmeshur standardet ekologjike. Reagimi qytetar do jetë i ashpër, nuk do lejohet rihapja e Jugohromit pa plotësim të standardeve. Do kërkojmë po ashtu zbardhjen e marrëveshjes në detaje për të parë se për çka do merren vesh ata dhe do kërkojmë edhe monitorim të pavarur duke angazhuar edhe ekspertë tanë. Zëvendësministri i Ekologjisë, Jani Makraduli, tha se rifillimi i Jugohromit është pjesë e angazhimeve të qeverisë që të gjithë kapacitetet industriale në vend të funksionojnë, por me obligime të plotësuara për mbrojtjen e ambientit. Ai madje tha se Qeveria e kaluar VMRO-BDI ka shantazhuar dhe bërë presion ndaj Jugohromit. Pritet që në fundjavë të nënshkruhet marrëveshje mes qeverisë, menaxhmentit të fabrikës dhe sindikatës për rihapjen e kombinatit. (u.h.)



Në përgatitjen për themelimin e Bankës Kombëtare nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës, në muajin tetor 1913, si njësi monetare kishte shpallur Frang-un Ar, që mbështetej në Unionin Monetar Latin, emërtim që synonte hapur orientimin europian të një Shqipërie të pavarur

BAJRAM PEÇI

Si është e mundur që shqiptarët vazhdojnë prej një kohe shumë të gjatë të lexojnë kartëmonedhat e t'i shqiptojnë ndryshe nga sa shkruhet në të tetë pozicionet e të dy faqeve, ku vlera shkruhet dhe jepet në shifra? Në çmimet e tregut, në rroga e pagesa të tjera, në shërbimet publike e private, në qeratat, etj., me gojë shqiptohet 1000 lekë por duhet të kuptosh e të shkruash 100 lekë. Për të shkoqitur këtë histori, duhet të kthehemi 50 vjet pas, në vitin 1964, kohë kur u pre emisioni i ri që zëvendësonte atë të vjetrin. Ky u quajt nga populli "Lekë i ri". Por për të mbërritur këtu vlen të përshtohet shkurtimisht një copë rrugë ku ka ecur një-sia monetare kombëtare.

Historik për emërtimin e kartëmonedhës kombëtare

Në përgatitjen për themelimin e Bankës Kombëtare nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës, në muajin tetor 1913, si njësi monetare kishte shpallur Frang-un Ar, që mbështetej në Unionin Monetar Latin, emërtim që synonte hapur orientimin europian të një Shqipërie të pavarur. Në rrethanat që pasuan fatin e të Përkohshmes, të qeverisë së Vidit dhe të Luftës së I Botërore që pasoi, nuk u themelua dot as banka dhe nuk u përgatit as monedha e kartëmonedha Frang. Ndonëse Frangu nuk qarkulloi, pullat postare të emisionit dhjetor 1913 ishin prodhuar e qarkulluan në frang (1 frang) e divizionalet e saj, qindarin (2, 5, 10, 25 e 50 qindar). Si emërtim gjeti përdorim përsos se në kartëmonedhat lokale gjysmë e një frang të të ash-tuquajturës "Shqipëria vetëqeveritare" dhe "Republika Shqiptare", emetuar në vitin 1917 nga Bashkia e qytetit Korçë.

Emërtimi Frang u pasua në vitin 1920 nga emetimi lokal i Bashkisë së qytetit Shkodër e cila prodhoi e qarkulloi një vlerë prej 50 mijë franga në prerjet 5, 10, 20 e 50 Qindar si dhe Bashkia Vlorë në vitin 1924 me prerjet 1 e 2 franga. Kartëmonedha me emërtimin Frang prente edhe bashkitë e Gjirokastrës, Elbasanit dhe Fierit. Ende pa dalë kartëmonedha kombëtare, ndër të parat letra me vlerë që ka emetuar një qeveri shqiptare, janë ato të huasë së brendshme, në maj të vitit 1920. U prente biletat obligacioni të vlerës 50 franga, gjithsej 2 milion franga ari, të caktuara për

Në shiritin e kohës

Shqiptarët mes "Lekut të Ri" dhe "Lekut të Vjetër"



t'u shlyer së bashku me interesat gjatë tre vjetëve.

Në 16 mars të vitit 1922 Parlamenti i Shqipërisë përgatiti ligjin për emetimin e një serie kartëmonedhash kombëtare në sasinë prej 3 milionë Franga Ari. Po në këtë ditë, në parim u caktua edhe Leku, si zgjedhje e emërtimit të ri që do të kish monedha kombëtare e që do zëvendësonte emërtimin Frang. Madje u caktua që seria të përbëhej nga 1, 2, 5, 10 dhe 25 lekë. Ndonëse ligji nuk hyri në fuqi, pullat e taksës së postës dolën në vitin 1922 me emërtimin Lekë dhe nënndarjen e saj, qindar, çka shënon edhe fillimin e përdorimit të një emri të ri, i cili, kur në vitin 1926 dolën dhe u përdorën monedhat 1/4, 1/2 e 1 lekë, ishte bërë në qytete deri diku familjar.

Mbi ndryshimet që i janë bërë njësisë monetare

Nga viti 1926, që shënon fillimin e historisë së monedhës të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, ka ndodhur disa herë të bëhet ndërrimi i njësisë monetare. Frang-u ar, si një-sia bazë dhe leku si nënndarje, ishin emërtimet e para, që u përdorën deri në fund të vitit 1944. Në vitin 1945, me propozim të Dhimitër Paskos, nëpunës i financës, pasi do nxirreshin nga qarkullimi kartëmonedhat ekzistuese, me një vulë katërkëndëshe, që përmbante shkrimin "Banka e Shtetit Shqiptar" dhe simbolin kombëtar, shqiptarë, u vulosën biletat 20

franga e vitit 1926 dhe 20 e 100 franga të serisë së vitit 1939 e 1940. Këtyre kartëmonedhave ju shtua në majin e vitit 1945 seria 1, 5, 20, 100 e 500 franga, të shtypura në Berlin. Emërtimi lekë nuk është më. Raporti i këmbimit të këtyre frangu u caktua 5 franga të vjetra = me 1 frang të ri. S'kaluan pak muaj nga kjo reformë dhe u vendos që jo frangu por leku do ishte monedha kombëtare. Ndërrimi i njësisë monetare nga franga në lekë u planifikua të bëhej që në vitin 1946. U vendos të bëhej në raportin 1 frangë = me 9 lekë e cila përkonte me interesat e dinarit të ri jugosllav. Dhimitër Pasko është i shtrënguar të japë dorëheqjen nga Ministria e Financave në gusht të vitit 1946, pasi nuk pranoi kursin e këmbimit të caktuar nga shteti shqiptar mes lekut dhe dinarit. Ai e kish parashikuar gjëmën që do i ndodhte ekonomisë së dobët shqiptare nga ky unifikim.

Më 16 maj 1947 atë e arrestuan dhe e dënuan si "Armik i Popullit" me 5 vite heqje lirie. Pasko u lirua nga burgu në maj 1949 me falje, pas prishjes së marrëdhënies të Shqipërisë me Jugosllavinë, kur megalomania pushtetore kish kuptuar se ai kish pasur të drejtë. Gjithsesi askush nuk i kërkoi falje. Pas kësaj, Pasko, i vetmi specialist shqiptar i fuqishës, i vetmi me titullin Doktor për sistemin bankar, nuk punoi më në ekonominë e financave. Emri i tij nuk u dëgjua më. Bota e letrave ku gjendej

tashmë e quanin Mitrush Kuteli.

Leku i "vjetër"

Në muajin korrik të vitit 1947 mbërriti nga Jugosllavia dhe u hodh në qarkullim seria e përbërë nga vlerat 10, 50, 100, 500 e 1000 lekë. Në 11.VII.1947 kartëmonedha frang doli nga qarkullimi dhe nuk u përdor më si emërtim në veprimet e shit-blerjes dhe ato bankare. Enver Hoxha dhe Partia Komuniste e Shqipërisë, në kushtet e vasalitetit e të nënshtrimit, pranoi propozimet e "vëllezërve" jugosllavë për bashkimin doganor dhe unifikimin monetar Lekë-Dinar. Emisioni i vitit 1947, i shtypur në Jugosllavi, mori kursin 100 lekë = 100 dinarë, pasojat e të cilës ishin shkatërrimi i tërë tregut shqiptar. Ekonomia ra në kolaps.

Me dinarin e pushtuar prej inflacionit, me të cilin në Jugosllavi nuk mund të blije asgjë, në Shqipëri mund të blije shumëçka që gjendej. Me kursin 100 dinarë jugosllav = 100 lekë, Shqipëria u plaçkit haptazi. Nga ky ndërrim i njësisë monetare, ajo u zhvesh dhe u zbraz nga mallrat ushqimorë, nga rezerva industriale që kishin mbetur nga lufta, nga konsumet e të tjera produkte, deri (siç mbërrinjë nga kujtimet gojore) te filmat me të cilat ishin mbushur kinematë e vendit, bobinat e të cilave përfunduan në kinematë e Beogradit dhe Zagrebit. Opozita e kohës, sado formale dhe e dobët që ishte, kundërshtoi, çka

i kushtoi asaj jetën.

Pas prishjes së Bashkimit Sovjetik me jugosllavët, PKSJ ndoqi kursin politik sovjetik, edhe vendi ynë u prish me Titon. Shqipëria detyrohet ta ndërrojë kartëmonedhën. U hodh në qarkullim emisioni i ri i vitit 1949, i shtypur në Bashkimin Sovjetik, pa asnjë ndryshim në kurs. Nevoja për kartëmonedha e shtyu Bankën të prodhojë të njëjtin emision në vitin 1957, po në B.S. pa asnjë ndryshim në vlerat 10, 50, 100, 500 dhe 1000 lekë. Pra, kur ne themi sot "Lekë i vjetër", kemi parasysh këtë seri kartëmonedhësh, që vazhdon të ndjekë padashur kursin e saj me dinarin jugosllav.

Është emisioni i Bankës Kombëtare të Shqipërisë i vitit 1957, që pa asnjë ndryshim në pamje dhe kurs, ka zëvendësuar emisionin e mëparshëm, atë të vitit 1949. Ky është leku me të cilin ne vazhdojmë të flasim. E keqja e mbartjes së kësaj mbeturine atavike i ka rrënjët te "Leku i ri", emisioni i vitit 1964, i shtypur në Kinë dhe që filloi të vihej në qarkullim në vitin 1965. Kursi i këmbimit 1 lekë i ri = 10 lekë të vjetër, lehtësoi administratën shtetërore dhe librat e saj të llogarisë, por bëri atë që nuk i gjen shembull tjetër në botë.

Po bëhen tre breza që tjetër lexojnë në kartëmonedhë e ndryshe flasin. Kjo ndodh kudo, në markete, në autobusë, në lotari, në zyrat e financës, në restorant, në kafe, madje ndonjëherë dhe vetë Banka Kombëtare e Ministria e Financave jo pak herë i referohen shifrave të lekut të vjetër. Sikur në 25.6.1965, në ligjin nr. 4021, Banka e Shtetit Shqiptar të mos kish vendosur kursin 1 me 10, ky përdorim alogjik nuk do ekzistonte. Merret me mend se kursi ishte i përcaktuar jo nga banka por nga lart. Banka e Shtetit i kish humbur disa funksione. Ishte bankë emetimi, por vendimin për prerje e emërtim nuk e merrte ajo por qeveria, e cila vendoste për shtimin ose pakësimin e kartëmonedhës në qarkullim; nuk ishte më bankë kreditimi në kuptimin e mirëfilltë, kreditonte ndërmarrje e kooperativa bujqësore, por jo subjekte private; nuk ushtronte më politika monetare. Në një farë mënyre ishte një shtojcë e administratës, një arkë e shtetit. Kaq e vërtetë ishte kjo sa që dhe një sari çelësats e derës së thesarit mbahej në Kryeministri.

Me rendin demokratik, në kushtet e ekonomisë së tregut, Banka e Shtetit Sh-

qiptar u zëvendësua, me ligjin nr. 7559, datë 22 prill 1992, me Bankën e Shqipërisë. Me këtë ligj banka fiton të gjitha funksionet, ku shumë e rëndësishme është se vetëm ajo përcakton politikën e kursit të këmbimit. Ndonëse në vitet 1993, 1994, 1996, 2001, 2007 dhe 2011 banka ka prerë kartëmonedha të reja, ajo asnjëherë nuk është kujtuar që të ndryshojë kursin, si mënyra e vetme për të hequr nga përdorimi termin popullor "Lek i vjetër". E pse duhej t'i hyn-te këtij "telashi" që kërkonte prerje të re emisioni, shoqëruar natyrshëm me koston e përgatitjes e prodhimit?!

Ku mbështetet kursi dhe sa rëndësi kishte për bankën në komunizëm mbulimi i kartëmonedhës

Kur Shqipëria në parim kish vendosur si monedhë kombëtare Frangun Ar, që mbështetej në Unionin Monetar Latin, frangu ose mbulesa e kartëmonedhës duhej të kish peshën 0.2900322 gram ar. Në themel të politikës së Unionit qëndronte inter-pretimi se kartëmonedhat janë një kërkesë-vërtetim për monedhat e arta që ke të depozituara në bankë. Në periudha të ndryshme, sidomos pas Luftës së I Botërore, ky tregues i Unionit pati luhajtje. Frangu u lidh dhe ishte i ndërvarur nga Lira e Italisë, Banka Kombëtare e Shqipërisë ishte kryesisht zotërim italian dhe mbulesa në ar ndodhej në bankat italiane. Si rrjedhim kartëmonedhat shqiptare franga pranoeshin në çdo sportel sepse ishin të garantuara në lingo-ta ari.

Kjo funksionoi deri në prill të vitit 1939, kohë më pas kur franga shqiptare ndoqi veçese fatin e inflacionit të Lirës italiane, e cila thuhej se ishte garante e mbulesës së qarkullimit. Kjo mbulesë realisht s'mund të ndodhte sepse në periudhën 1939-1943 sasia e kartëmonedhës frang në qarkullim u rrit 38 herë në krahasim me vitin 1938. Më pas çdo gjë ndryshoi, mbulesa në ar përfundoi nga Roma në Berlin dhe çdo prerje kartëmonedhe që ka pasuar nuk garantohej në ar. Në këto rrethana kursi i ndërrimit në vitet e pasluftës nuk kishte detyrimin të mbulohej në ar. Kur SHBA-ja, garantuesja e sistemit financiar ndërkombëtar, pezulloi në gusht të vitit 1971 konventueshmërinë e dollarit në ar, autoriteti i kartëmonedhës hyri në një rrugë plot me të panjohura e dyshime.

Si rregull zëvendësimin e kartëmonedhës dhe kursit duhet ta diktojnë shkaqe të rëndësishme ekonomike e financiare. Në rastin tonë më shumë mbizotëron arsyeja politike. Kështu, kartëmonedha e vitit 1947 ndryshoi në vitin 1949 sepse u prishëm me Jugosllavinë, vendi ku ishte shtypur emisioni. Kartëmonedha e vitit 1956 ndryshoi sepse u prishëm me Bashkimin Sovjetik, vendi ku ishte



shtypur emisioni. Kartëmonedha e vitit 1964 u zëvendësua me një rishtypje në Zvicër sepse të parat ishin shtypur në Kinë, me të cilën tashmë ishim prishur. Vetëm në vitin 1992 kartëmonedha ndryshoi e motivuar dhe diktuar nga tronditjet e tregut dhe zhvlerësimi që ndodhi, me shkak përdoruesin e jo atë zyrtar. Për pasojë, kartëmonedha në qarkullim në vitin 1994 ishte 6 herë më e madhe se viti 1990.

Monedha Lekë që u rivendos në vitin 1947, s'pati ndonjë vlerë të deklaruar këmbimi në ar, ndryshe nga leku i vitit 1926, ku 1 Lekë ishte ekuivalent me 0.20 Franga Ar. Në vitin 1964 ishte i përcaktuar 10 lekë 1957 = 1 lekë 1964, thjesht që të kuptohej si vlerësim e forcim i monedhës, por pa e krahasuar me ekuivalentin botëror. Vetëm në vitin 1977 kur u hodh në qarkullim riprodhimi i emisionit të vitit 1964, në dekretin nr. 5529, neni 3 cilëson se, "Banka e Shtetit Shqiptar hedh në qarkullim bileta banke dhe monedha metalike, të cilat garantojnë nga shteti me mallra, me ar, me metale të tjera të çmueshme, me valuta të huaja dhe me aktivitetet të tjera të bankës"(?).

Në ligjin nr. 7759, datë 22 prill 1992 vetëm sa theksohet në nenin 13, se "...kartëmonedhat dhe monedhat e emetuar nga Banka e Shqipërisë garantojnë nga shteti", por pa qartësuar politikën në kursin e këmbimit. Pikërisht, në vitin 1992, (por dhe më pas) me prerjet e reja të emisionit duhej të kish ndryshuar edhe kursi i këmbimit të kartëmonedhës që hiqej me atë që dilte e re. Përkundrazi, Banka nuk ju fut këtyre "telasheve". Këmbimi i të vjetrës me të renë ngeli 1 me 1, duke lënë kështu paradoksalisht përsëri në përdorim anomalinë, "Lekë të vjetra".

A ka zgjidhje kjo punë plot keqkuptime? Natyrisht që po, por nuk duan, mbase dhe nuk dinë! Do mjaftonte një ligj i ri, për të përcaktuar një kurs të ri, le të themi apriori 1 me 2, 1 me 4 apo 1 me 5 ose anasjelltas. Ky veprim, që do kërkojë një shpenzim për prohimin e kartëmonedhës së re, do pak vullnet nga ministrat e financës që shkojnë e vijnë pa iniciativë ligjvënës; do dhe një guvernator që të marrë vesh nga kjo ndodhi e domosdoshme për ndryshim dhe përfundimisht ai të hyjë në histori si njeriu që shkuli një praktikë të keqe. Mbi gjithçka, shpreh bindjen se do një parlament të përgjegjshëm e të ndërgjegjshëm, i bindur se duhet të largojë përfundimisht përmes ligjvënies këtë marrëzi që shoqëron shoqërinë shqiptare pa reshtur.

Regjimi demokratik që kishin vendosur traktatet e paqes në vend ishte, sigurisht, një mashtrim, por lejonte këdo që të bënte përpara. Ahmeti i mjaftoi emri për t'u bërë deputet i rrethit të tij dhe për të hyrë kështu në lojën e pushtetit

Indro Montanelli

Kundërshtari që Musolini kishte shpikur për t'u kundërvënë një suksesi që po kishte Hitleri, ishte në fakt i biri i tij. Mbreti Ahmet Zog, siç thuhej, "nuk lindte." Ai i përkiste një dinastie të bosëve të mafies Mati, që do të ishte pak Kalabria e Shqipërisë dhe emri i tij i vërtetë ishte Ahmet Zogolli. Zogollët, që pas pushtimit turk, ishin të parët që u konvertuan në fenë e Islamit, duke pohuar pushtetin e tyre mbi shtetin, falë mbrojtjes së pashallarëve që gradualisht qeverisën vendin në emër të Sulltanit.

Ata zotëronin disa dele, disa kullota dhe një grup vrasësish, të cilët i përdorin për të mbështetur sundimin e tyre të vogël feudal dhe për të përshtatur sipas dëshirës së tyre, gjakmarrjet dhe luftën guerile, endemike në mesin e atyre barinjve malorë, por nuk rezulton se ndonjë prej Zogollëve kishte pohuar dëshirën për të shtrirë ndikimin e tij mbi atë kanton të papërfillshëm, të banuar nga disa dhjetëra mijëra burra, pothuajse të gjithë analfabetë, të lidhur me mjaft fanatizëm me autonominë e tyre, të cilën turqit e respektuan. Zakonisht ata lindnin, jetonin dhe vdisnin atje, midis deleve dhe minareve, duke bërë gjueti, duke bërë intriga dhe duke administruar një drejtësi arkaike nën pemën e fikut. Ahmeti ishte ndoshta i pari i dinastisë së tij që e zgjeroi horizontin e ambicieve të tij.

Lindur në vitin 1895, ai studioi në Akademinë Ushtarake në Kostandinopojë, por kur Shqipëria kaloi, pas luftërave ballkanike, nën sundimin e Vjenës, ai u transferua në ushtrinë austriake – mjeti që përdorte Perandoria Habsburge për të themeluar elementet e ndryshme kombëtare nga të cilat ishte përbërë – dhe atje ai u bë kolonel. U shkarkua në fund të Luftës së Parë Botërore dhe mbeti pa gradë, pa para dhe pa flamur, ai u kthye në Mat, por nuk u mësua me vegjetimin si paraardhësit e tij.

Regjimi demokratik që kishin vendosur traktatet e paqes në vend ishte, sigurisht, një mashtrim, por lejonte këdo që të bënte përpara. Ahmeti i mjaftoi emri për t'u bërë deputet i rrethit të tij dhe për të hyrë kështu në lojën e pushtetit. Ambicia e tij ishte servirur mirë nga trashëgimia dinake e Zogollëve, me një guxim të shquar dhe një mungesë totale të skrupujve. Para të tridhjetave ishte ministër i Brendshëm, një pozicion të cilin ai e përdorte për të shumëfishuar miqtë, t'i binte në qafë armikut dhe menjëherë më pas të instalohej si President i Këshillit. Kur, në zgjedhjet e ardhshme, ai u



mund nga liberali Fan Noli, nuk pranoi t'i lëshonte atij vendin dhe u përpoq të vendoste diktaturën. Ai nuk pati sukses për shkak të mungesës së forcave brenda dhe mbështetjes nga jashtë, dhe i detyruar të shpëtonte veten, u largua për në Beograd. Tashmë, e dinte se askush nuk mund të sundonte në Shqipëri përveçse si prokonusull i një fuqie të huaj dhe në mesin e atyre që pretendonin për dominim – Italia, Greqia dhe Jugosllavia – ndoshta ai mendonte se kjo e fundit ishte më e besueshme. Kështu duhej të dukej dhe ai me jugosllavët, të cilët hezituan shumë për ta bërë "ushtarin" e tyre. Kur më në fund e vendosën, Nikolla Pashiq – një lloj Gioliti serb (kryeministër italian) dhe njohës i mirë i njerëzve – duke vënë mbi tryezë një numër qesesh plot stërlina floriri, duke i shtyrë drejt tij, e pyeti: "Dhe tani Zog, sa kohë do të duhet për të marrë para nga italianët dhe të kalosh në anën e tyre?" – Ndoshta Zogu nuk e bëri atë që kishte parashikuar Pashiq vetëm për stërlinat. Si mbrojtës, italianët kishin më shumë pikë se jugosllavët të avantazh: Së pari, nuk kishin vazhdimësi territoriale me Shqipërinë, gjë që i jepte më shumë pavarësi kësaj të fundit, pastaj ishin më në gjendje ta ndihmonin nga ana ekonomike dhe në fund, pas ardhjes në pushtet të Musolinit, dhanë dëshmi të një aktivizimi diplomatik shumë më agresiv dhe të vendosur. Megjithatë, pasi kishte përvetësuar stërlinat e Pashiqit, Zogu përvetësoi dhe ato të Musolinit, të cilin pak i interesonte kjo; vetëm të jepte disa garanci të suksessit, dhe nga kjo pikëpamje nuk ishte e gabuar. Me ushqim të dyfishuar, Zogu e rimori shpejt pushtetin dhe u kurorëzua dhe President i Republikës, por kjo nuk i mjaftoi. Tri vjet më vonë, ai mori një kurorë të vërtetë, atë të Mbretit, që Musolini ia dha në shkëmbim të një deklaratë benediktoze të pavdekshme ndaj Italisë, që e shqiptuar

nga një njeri si Zogu, vlen-te aq sa vlente. Musolini u tregua naiv dhe kjo u pa menjëherë. Pasi u bë mbret, Zogu e mori seriozisht mbretërimin, duke marrë qëndrimet e pavarësisë dhe duke treguar shpesh arrogancë, që dikur rrezikuan të provokonin një krizë në marrëdhëniet midis dy vendeve dhe në vitin 1934, Zogu refuzoi të rinovonte traktatet tregtare me Italinë dhe nënshkroi një me Jugosllavinë. Këto veprime u justifikuan pjesërisht nga politika e Romës që e kryente detyrën e saj si "mbrojtëse" shumë keq.

Ndihmat e mëdha më pas përfunduan duke shuar llogaritë private të Zogut dhe të preferuarve të tij, por edhe ato ndërhyrëse dhe paternaliste. Kjo politikë dukej e bërë me qëllim që të fyente ndjenjat e një mbreti si Zogu që pa tradita dinastie, u përpoq të kompensonte me gjeste krenarie kombëtare dhe shkëlqimin e një oborri operetash. I fshehtë dhe dyshues, Zogu e konceptonte politikën si një intrigë pallati, në të cilën, megjithatë, ishte një mjeshtrë. Rrallë shfaqej në publik, kërkonte nga të gjithë, madje edhe nga diplomatët italianë, duke filluar nga kreu i misionit, ministri Jakomoni, të respektonte një ceremoniale të përpiktë, ku fliste pak dhe nuk hapej me askënd. Ndikimi i vetëm që ushtronte ishte ai ndaj familjes dhe në veçanti ndaj motrave, që prej tij kishin marrë gradën e gjeneralëve dhe të veshura me uniformë, luanin në pallatin mbretëror motin e mirë dhe të keq. Ato ishin anti-italiane edhe kishin frikë se Roma do t'i jepte mbretit një grua italiane që do t'i shpronësonte.

Në të vërtetë, ky ishte projekti që Roma kishte, dhe për ta realizuar, dikush i kishte sugjeruar gjithashtu të "sakrifikonin" për Zogun një princeshë të linjës së gjakut mbretëror të Savojës, por nuk ishte gjetur ndonjë aq e gatshme dhe më pas ishte kthyer tek një baroneshë e cila, megjithëse italiane, kishte prejardhje të drejtpërdrejta

Historia e Italisë

Përse Zogu zgjodhi Italinë në vend të Jugosllavisë

dhe mbante emrin e kampionit më prestigjioz të nacionalitetit shqiptar: Skënderbeut, por për Zogun kjo ishte një masë e përkohshme, me krenari e refuzoi atë dhe për të ripohuar pavarësinë e vet, dëshironte të bënte një zgjedhje të tijën. E bëri mbi një fotografi ku ishte një vajzë hungareze, që ia kishte propozuar sekretari i tij. Zogu e refuzoi vajzën, por e mbajti fotografinë dhe e ftoi në Tiranë origjinalen: Ajo ishte Geraldine Apponyi, trashëgimtare e një familjeje të madhe hungareze e rënë nga vakti; nuk kishte asgjë përveç emrit dhe një fytyre të ëmbël, e njëjtë edhe në karakter. Dasma u mbajt më 28 nëntor 1937, në njëzet e pesë vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë (Shënim i përkthyesit: këtu, me shumë gjasa, kemi të bëjmë me një lapsus të vetë autorit, gjë e cila mund të ketë ardhur nga mosthëllimi apo neglizhenca e tij ndaj këtij detaji historik, pasi dihet tashmë se dasma në fjalë u zhvillua në prill 1938) dhe ishte një tjetër burim i fërkimit, këtë herë më të thellë me Italinë. Jo vetëm për shkak se Zogu kishte refuzuar një nuse italiane, por edhe për kundërshtitë e vrazhda që iu bënë, veçanërisht nga motrat gjenerale, të dy përfaqësuesve italianë, të cilët ishin Ciano për qeverinë dhe Duka i Bergamos, i Shtëpisë së Savojës.

Ishte mëse e kuptueshme se: Kriza, për arsye të parëndësishme, ndodhej tashmë në ajër, por ka shumë mundësi që edhe acarimi i Cianos, t'i ketë dhënë një shtysë përshpejtim të saj. Por as Zogu, në mungesë të një ideje, ose për shkak të krenarisë, nuk bëri asgjë për ta parandaluar atë. Ndoshta ai mendonte se Italia nuk mund të bëjë pa të dhe sigurisht, u mbështet dhe nga të motrat për këtë bindje. Geraldina nuk mund t'i ofronte asnjë ndihmë, qoftë edhe me anë të këshillimit. Shumë e re në moshë (ajo ishte njëzet vjet më e re se ai) dhe pa përvojë, ajo e gjeti veten krejtësisht të papërgatitur për të luajtur rolin e veshit të Mbretëreshës. Për më shumë, ajo ngeli menjëherë shtatzënë dhe burri i saj, edhe pse dukej shumë i dashuruar me të, vepronte ende si një mysliman, i cili nuk i jep rëndësi fjalës së gruas. Por, sipas një tjetër hipoteze, ai kurrë nuk kishte pasur ndonjë iluzion në lidhje me stabilitetin e fronit të tij, përkundrazi, Zogu donte t'i jepte fund aventurës së tij në mënyrën më të hijshme, duke e shtyrë pavarësinë deri në sfidën e radhës. Ndoshta po përgatiste kthimin e tij në momentin kur rregullat e lojës europiane

të kishin ndryshuar. Megjithatë, edhe pse i mungonte etika, atij nuk i mungonte karakteri.

Në fakt, u bë më se e qartë kur goditja gjermane në Çekoslovaki i dha Ciano-s një mundësi për të kryer planin e aneksimit të Shqipërisë, plan që "vlonte" prej kohësh. Ministri i Jashtëm kishte marrë urdhra që jugosllavët t'i kishin "duart e lira" për të vepruar në Shqipëri, sipas klauzolatë të fshehta të traktatit të vitit 1937: Musolini kishte marrë në dorë raportet që e tregonin Shqipërinë si një vend "të pasur, të pasur me të vërtetë" dhe parashikonte një ndërhyrje të mundshme gjermane në atë zonë, për aq kohë sa kjo ndërhyrje mbikëqyrej nga italianët. Në këto përshkrime, "sociale" të Cianos, nuk mungonin edhe idetë anti-Zog. "Ky popull, ku kushtet e mjerimit të të cilat jeton, na sjell ndërmend fshatrat e largëta kineze përgjatë Jang-Ce....

"120,000,000 lirë e mje-rueshme, të cilat përbëjnë buxhetin e shtetit, përdoren për blerjen e diamanteve, rrobave, makinave që motrat e Mbretit i reklamojnë me pamaturitë të vazhdueshme". Falë kësaj taktike, Ciano, në maj të vitit '38, arriti të bindte Duçen, të jepte aprovimin e një përgatitje të përgjithshme.

Ndërkohë, delfini i Duçes, i cili ishte jashtëzakonisht i pamatur në zgjedhjen e taktikave të politikës së tij, parashikoi edhe vrasjen e Zogut. Më 27 tetor të vitit 1938, ai vuri në dukje në ditarin e tij: "Aksioni fillon me vrasjen e Mbretit (duket se do jetë detyrë e Këshilltarit Koçi përballë një tarife prej dhjetë milionësh), lëvizjet përgjatë sheshit, udhëzimi i bandave besnike ndaj nesh (pothuajse të gjithë komandantëve, përveç atyre të KMIA), lutje Italisë për ndërhyrje politike dhe ushtarake, nëse është e nevojshme, ofrimi i kurorës së Mbretit dhe aneksimi i mëvonshëm. Jakomoni siguron se çdo gjë mund të bëhet në bazë të rregullave, me një muaj paralajmërim. "Një manovrim i tipit 'Anschluss' me pak fjalë, si aneksimi i Sudeteve. Deri në atë moment, Ciano kishte reaguar me iniciativën e vet. Ekzistonte tashmë një duel mes Cianos dhe Zogut, pra Musolini do e bazonte aprovimin ose pengimin e aneksimit, në përputhje me stadin e ngjarjeve në rend ndërkombehtar. Rënia e Stojadinoviçit, një mik i madh i Cianos, në Jugosllavi, kishte komplikuar akoma edhe më shumë situatën. "Duart e lira", nuk mund të veprojnë si më parë dhe Zogu e dinte mirë këtë. Ideja e vrasjes se Mbretit, ishte venitur. (konika)



Augustin PALOKAJ

Katalonja dhe Kosova nuk janë njësoj...

Katalonja vazhdon të jetë një ndër temat që shqetëson më së shumti jo vetëm Spanjën, por edhe Bashkimin Evropian. Duke u vënë tërësisht në anën e qeverisë në Madrid, madje edhe duke arsyetuar dhunën e policisë ndaj civilëve, BE-ja ka bërë të qartë se nuk mbështet synimet e Katalonjës për t'u bërë shtet i pavarur. Zëvendës-presidenti i parë i Komisionit Evropian, Frans Timmermans, duke folur në një debat në Parlamentin Evropian, ka thënë se "secila qeveri duhet të sigurojë sundimin e ligjit dhe për këtë nganjëherë nevojitet edhe përdorimi proporcional i forcës". Kjo është parë si një mbështetje edhe për veprimet e dhunshme të policisë së Spanjës gjatë ditës së referendumit në Katalonjë. Nga aspekti ligjor Bashkimi Evropian bazohet në ligjet e Spanjës, një vendi anëtar, kur thotë se referendumi është ilegal. Në përgjithësi në BE, që nga viti 2004, ekziston një e ashtuquajtur "doktrina Prodi" (President i Komisionit Evropian në atë kohë), sipas së cilës Komisioni Evropian nuk do të përzihet në çështje të brendshme të shteteve anëtare. Kjo

Bashkimi Evropian vërtet ka insistuar se Kosova është një sui generis, se nuk mund të krahasohet me Katalonjën. Por BE-ja asnjëherë nuk është shprehur se pavarësia e Kosovës është e pranueshme. Kur liderët e sotëm të Serbisë kërkojnë sqarime pse "Kosova bën të jetë e pavarur e Katalonja jo", nuk e bëjnë këtë për shkak se vërtet u intereson përgjigjja. Presidenti Vuçiq, ministri i Jashtëm, Daçiç, dhe të tjerët e dinë më mirë sesa vetë Brukseli pse Kosova është rast i veçantë

është vazhduar edhe nga ana e Komisionit Barroso dhe vazhdon edhe tash në periudhën e Junckerit. Kështu ka qenë edhe në rastin e Katalonjës duke i dhënë mbështetje asaj që thotë qeveria e një vendi anëtar dhe kanë porositur se nëse do të pavarësohej Katalonja me marrëveshje me Madridin, me këtë do të dalë edhe nga BE-ja. Në BE ka pasur pyetje nga ga-

zetarët se pse Katalonja nuk bën të jetë e pavarur e Kosova bën. Këtë pyetje pastaj, në mënyrë agresive dhe me shumë zhurmë, e paraqet Beogradi madje duke paralajmëruar se do të kërkojë edhe me shkrim nga BE-ja sqarime. Bashkimi Evropian vërtet ka insistuar se Kosova është një rast sui generis, se nuk mund të krahasohet me Katalonjën. Por, BE-ja asnjëherë nuk është shprehur se pavarësia e Kosovës është e pranueshme. Kur liderët e sotëm të Serbisë kërkojnë sqarime pse "Kosova bën të jetë e pavarur e Katalonja jo", nuk e bëjnë këtë për shkak se vërtet u intereson përgjigjja. Presidenti Vuçiq, ministri i Jashtëm, Daçiç, dhe të tjerët e dinë më mirë sesa vetë Brukseli pse Kosova është rast i veçantë. Serbia dëshiron tash ta shfrytëzojë shqetësimin e BE-së për Katalonjën për të penguar njohjen e mëtejme të Kosovës, integrimin e saj në strukturat ndërkombëtare dhe të zbusë presionin ndaj Beogradit për të pranuar realitetin e ekzistimit të shtetit të Kosovës. Duhet thënë se Bashkimi Evro-

pian asnjëherë nuk ka thënë se pavarësia e Kosovës është e pranueshme, e drejtë, por as që nuk është. Në fakt, Bashkimi Evropian ka dështuar të ndërtojë një qëndrim unik për Kosovën që nga koha kur Martti Ahtisaari, nobelist dhe ish-president i Finlandës, i emëruar nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së, kishte nxjerrë propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Edhe pse në ekipin e tij rolin kryesor e kishte ekspertët e BE-së, edhe pse propozimi u ishte përshtatur nevojave të BE-së, pranisë së saj në Kosovë, BE-ja në fund nuk qe në gjendje të pranonte dhe të mbështesë atë propozim. Ata edhe pas propozimit të Ahtisaarit dolën me deklaratën se "mbështesin përpjekjet e Ahtisaarit", edhe pse Ahtisaari nuk kishte më fare përpjekje, sepse tashmë kishte nxjerrë propozimin. Kur Kosova shpalli pavarësinë, BE-ja nuk e mbështeti këtë. Kjo u pa edhe në konkluzionet që u miratuan nga BE-ja pas shpalljes së pavarësisë. "Më 17 shkurt të vitit

2008, Asambleja e Kosovës ka miratuar një Rezolutë e cila e shpall Kosovën të jetë e pavarur. Këshilli merr në dijeni se Rezoluta shpreh përkushtimin e Kosovës për parimet e demokracisë dhe barazisë së të gjithë qytetarëve, mbrojtjen e serbëve dhe pakicave të tjera, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare. Këshilli mirëpret vazhdimin e pranisë së bashkësisë ndërkombëtare bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244", thuhet në konkluzionet e miratuara në takimin e ministrave të jashtëm të BE-së, të miratuara në mëngjesin e ditës 18 shkurt, vetëm një ditë pasi ishte shpallur Pavarësia e Kosovës. Pikërisht për të pasur mundësi që BE-ja të reagojë para Këshillit të Sigurimit të OKB-së ishte planifikuar që Kosova të shpallte pavarësinë në një ditë kur nuk punohej, të dielën, dhe të përkohë me një mundësi të takimit të rregullt të ministrave të Jashtëm të BE-së shpejt pas shpalljes së Pavarësisë. Prandaj edhe "Koha Ditore" e para e kishite botuar dy herë ditën se

kur do të shpallej Pavarësia e Kosovës. Pasi në Spanjë më datën 8 mars zhvillohe-shin zgjedhjet, kishte ide që shpallja e pavarësisë të shtyhej për datën 9 mars. Por, kur nga Madridi erdhi sinjali se pa marrë parasysh rezultatin e zgjedhjeve në Spanjë ky shtet nuk do të bjerë dakord për njohje të Kosovës nga BE-ja, atëherë nuk pati arsye të shtyhej shpallja e pavarësisë. Duhet thënë se ministri i atëhershëm i Jashtëm i Spanjës, Moratinos, kishte shkelur edhe një pajtim mes shteteve të BE-së që askush të mos bënte prononcime publike rreth shpalljes së pavarësisë së Kosovës derisa të mos bëhej publik qëndrimi i përba-shkët i BE-së për këtë. Ai erdhi shumë herë në ndërtesën e Këshillit dhe u tha gazetarëve se shpallja e Pavarësisë së Kosovës është shkelje drastike e së drejtës ndërkombëtare dhe Spanja nuk pajtohet me një gjë të tillë. Madje këtë e krahasoi edhe me ndërhyrjen ushtarake në Irak që për këtë ministër socialist të Spanjës ishte ilegale. Prej atëherë sa herë që Spanja pyetej për pavarësinë e Kosovës ajo shprehej kundër, dhe sa herë që shprehej kundër bëhej më vështirë që t'i ndërrohej mendja. Nganjëherë thuhet se ajo pret që numri i njohjeve të kalojë shifrën magjike prej 100 dhe pastaj Spanja "mund të lëvizë". Të tjerët thoshin se Spanja do të lëvizë pas mendimit të GJND-së. Por gjithmonë



Luljeta MINXHOZI

Si e kam njohur Gramoz Pashkon

Unë e kam njohur në vitin 1983 kur kam filluar të jem asistente në Fakultetin e Ekonomisë dhe bëja seminarin e lëndës së Historisë së Mendimit Ekonomik që jepte si lektor Pashko dhe njëkohësisht isha anëtare e departamentit të ekonomisë politike të kapitalizmit. Unë bëja seminarin e ekonomisë politike të kapitalizmit, që ishte e fokusuar në tre librat e volumit të parë të kapitalit të Marksit, dhe ky ishte fillimi i një jete të re për mua. Dukej si një privilegj shumë i madh për atë që emërohej pedagog në fakultet në atë kohë edhe pse duhet të ishte një student ekselent, vetëm 10-a. Por në fakt jeta ishte shumë e vështirë sepse universitetit ishte një strukturë shumë e ngurtë. Kush ishte profesor, kush ishte drejtues departamentesh, katedra quheshin në atë kohë,

Nuk e kisha menduar ndonjëherë që do të bëja një refleksion për Gramoz Pashkon. Gramozi është një figurë e shumëfishtë, me shumë pamje të tij, nga të cilat unë njoh vetëm një, pamjen e tij akademike. Ai ka qenë Gramoz Pashko, pedagogu atipik por edhe kolegu atipik për kohën

ishin shumë të largët për asistentet dhe qëndrimi ndaj të rinjve ishte shumë diskriminues. Ju keni ardhur me vetëm 10-a, por ju duhet të bëni dhe 8 provime të tjera që ta plotësoni këtë standardin për të qenë profesor, mësues, lektor, pastaj fillonte një rrugë e gjatë, shumë e gjatë, që ti të bëje atë doktoraturën e asaj kohe, që quhej kandidat i shkencave, kështu që shkalla e diskriminimit ndaj të rinjve ishte shumë e lartë. Falënderimin e parë të

njohjes sime me Gramoz Pashkon do t'ia jap faktit që më ndihmoi të jem 30 vite më pas një pedagoge shumë e mirë. Ai ishte një liberal në shpirt dhe mënyrën e të qenit të tij kundër atij sistemi të ngurtë e shprehu me mbështetjen e pakufizuar që u dha të rinjve. Na mësoi si të bënim mësim, na mësoi si të kërkonim. Shumë në Tiranë asaj kohe e njihnin Gramozin me shprehjen "një magazinë pa inventar", por në fakt nuk ishte as pak ashtu. Ai kishte një privilegj të kishte një akses të pakufizuar të të gjitha burimet shkencore që hynin në Shqipëri në atë kohë. Si pasojë e këtij akses kishte ca skeda të çuditshme të bardha, nuk e di ku i gjente, dhe mbante shënime pafund në ato skeda. I skedonte dhe na i shpërndante sipas interesit që kishte secili nga ne, dhe na jepte të gjithëve t'i lexonim. Dhe kjo ishte e vetmja mënyrë që ne mund të kontaktonim të renë në atë kohë, kjo ishte, duket sot absurde,

por nuk kishte asnjë kon-takt tjetër me të renë, ose nëpërmjet atyre skedave të Gramozit ne gjenim se ku do të kërkonim. Gramozi na mësoi si të jepnim mësim. Kur mbas dy vitesh mua m'u dha e drejta që të bëja leksione, më caktuan në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Gramozi bënte mësim në Degën e Merceologjisë që ishte pjesë e fakultetit Ekonomik, por zhvillonte mësim në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Ato hollat e leksioneve ishin shumë të mëdha dhe unë isha aq e vogël me trup sa nuk arrija t'i shikoja deri në fund. Gramozi më mësoi: "ti do ecësh, të shkosh në mes të studenteve dhe t'u flasësh". Por kjo ishte një risi në formën e mësimdhënies, atëherë edhe të kritikoni për këtë, nuk mund t'u afroshesh studentëve. Ti do rrije në një katedër prej dërrase dhe që atje do t'u flisje. Për mua ishte e pamundur qëndrimi në katedër dhe thashë më mirë po bëj kështu. Por ishte aq e vështirë, duhet

të mbaje mend gjithë leksionet, duhet të ishte shumë interaktive me studentët, gjë që e pata të vështirë në fillim. Me thane se ky nuk është leksioni standard, por këmbëngula unë nuk kam zë, nuk e dominoj sallën me zë kështu që më lejoni të jap mësim sipas kësaj metode. Pra, Pashko më mësoi të jem një pedagoge shumë e mirë, t'i shoh studentët në sy, sepse atje e kupton nëse studenti të do apo nuk të do. Dhe ajo që është më e rëndësishmja në kontributin e Gramoz Pashkos, të cilin ai natyrisht e shpërnda dhe në pjesën tjetër të shoqërisë, ishte përpjekja e tij për të qenë edhe kërkuesi atipik. Ai kërkonte të studioje jo atë që i duhej sistemit, por atë që e shtynte kurioziteti i tij shkencor. Pra, nuk ishte konformist edhe këtë e dëshmon kushdo që e ka njohur. Nuk kishte atë mënyrën tipike të veshjes që ne kishim në atë kohë, ngurtësinë në sjellje, në gjestikulacion, ai e kishte

shumë të shfrenuar këtë pjesë dhe ishte pjesë e karakterit të tij, pjesë, e cila u shfaq edhe më shumë kur ai hyri në politikë. Gramozi kërkonte atje ku ishte e pamundura, në ato skema të ngurta që të lejonte kërkimi për ekonominë në ato kohë. Gramozi ka bërë doktoraturën e parë dhe ndoshta është e vetmja në ekonomi, në atë periudhë përpara viteve '90. Doktoratura ishte në dy stade, kandidat i shkencave, atë që bënin të gjithë akademikët, kush do të qëndronte lektor, por ishte dhe një stad tjetër, kërkimi i thelluar me shkallë shumë të lartë të individualitetit dhe originalitetit në studim, dhe kjo shkallë provohej ose garantohej nga disa komisione që ishin në nivel nacional dhe Gramozi e bëri në atë kohë. Bota njihje stanjacion dhe rritje ekonomike, por nuk njihje stagllacion, i cili për 15 vjet bllokoi gjithë vendet e zhvilluara nga '75 deri afër '85. Dhe pikërisht këtë fenomen kaq të ri, ekono-

nga Madridi vinte porosia se pa pajtimin e Beogradit Madridi nuk mund ta njohë pavarësinë e Kosovës. Së paku këtu ishte Spanja pak më e avancuar se Qiproja, sepse kjo e fundit thoshte se nuk do ta njohë Kosovën shtet qoftë edhe nëse këtë e bën vetë Beogradi.

Dhe gjasat që këto dy vende të lëvizin u shuan kur nisi dialogu mes "Beogradit dhe Prishtinës" i "lehtësuar nga BE-ja". Robert Cooper dhe ekipi i tij, me bekimin e baroneshës Ashton, punonte me filozofinë dhe qasjen se ndasitë brenda BE-së rreth statusit të Kosovës janë avantazh për ta, sepse kjo e bën këtë ekip të jetë lehtësuesi më i mirë i mundshëm. Disa herë na është thënë, gjithmonë jozyrtarisht, se atyre kjo situatë iu ndihmon shumë, sepse shqiptarëve u thonë se Kosova është e pavarur, nuk ka kthim, sepse është e njohur në atë kohë nga 22 prej 27 vendeve anëtare. Ndërsa serbëve u thoshin se "BE-ja vepron me unanimitet dhe përdorin ka shtete që nuk e njohin Kosovën, BE-ja është neutrale ndaj statusit". "Po ta njihnin të gjitha shtetet e BE-së Kosovën si shtet të pavarur, atëherë Beogradi mund të mos na e njohë rolin e lehtësuesit objektiv, prandaj ne jemi më të duhur për këtë rol sesa Rusia apo SHBA-ja", thoshin diplomatët nga zyra e baroneshës Ashton. Kjo qasje e BE-së vazhdon. Sa i përket njohjes së Pavarësisë së Kosovës, konkluzione e BE-së thoshin: "Këshilli merr në dijeni se shtetet anëtare do të vendosin në përputhje me praktikën nacionale dhe të drejtën ndërkombëtare për raportet e tyre me Kosovën".

Ende nuk kam hasur në asnjë deklaratë të vetme zyrtare të dikujt në emër të BE-së që të pajtohet me pavarësinë e Kosovës. E kosovarëve shpesh u thuhet se "BE-ja nuk njeh shtete, sepse kjo është në kompetencat e vendeve anëtare". Por kjo nuk është krejtësisht e vërtetë, sepse në rastin e Malit të Zi me konkluzione të ministrave ishte shprehur qartë se me Malin e Zi vendet e BE-së do të lidhin raporte

mia shqiptare nuk njihje as inflacion, asgjë, sepse paraja ishte e përcaktuar, tregje financiare nuk kishte, bankat ishin vetëm shtetërore, vetëm këmbenin ose kryenin disa shërbime të shpejta, pra ky ishte një koncept komplet i ri, i panjohur më parë. Aty guxoi dhe bëri këtë doktoraturë që ishte shumë e rrallë për kohën. Ai me atë dha një shembull, një sinjal, që kështu duhet të bëni nëse doni të bëni kërkim duhet të bëni një kërkim të vërtetë. Mos bëni atë kërkimin e zakonshëm që të gjithë ne bënim në atë kohë, temat na i caktonte dekanati, thonin këtë temë do bëni në doktoraturë dhe ne vazhdonim e bënim. Ai na mësoi se si të kërkoni dhe në përgjithësi të gjithë ne bëjmë tema që i diskutuam gjatë me të. Dhe na ndihmoi në vitin 1995, pra për e kujtuam, e falënderuam kur të gjitha doktoraturat u rishikuan, të gjitha doktoraturat e para viteve '90 u rishikuan nga një komision shtetëror. Një pjesë e madhe e kolegëve tanë nuk patën fatin ta rikonfirmimin doktoraturën, unë isha nga ato që e rikonfirmova dhe edhe një herë i thashë, faleminderit Gramoz për atë ndihmë që na dhe.

Ai donte të bënte një gjë të vlefshme që të rronte gjatë, dhe kjo gjë e vlefshme të gjithë ne që kemi punuar me të, që kemi qenë nxënës të tij në një farë mënyre, asistentë të rinj, e kemi bartur këtë histori. Nëse do të bësh një gjë të mirë, bëje me themel, mos e bëj për të kaluar kohën. Ky është mesazhi që unë mora nga Gramozi në atë kohë. Gramozi ishte i pari ekonomist që, jo vetëm që bëri doktoraturë në atë kohë, por që guxoi dhe iu bashkua një projekti evropian të drejtuar nga një grup studiuesish suedeze për të bërë një analizë të thelluar të të gjitha vendeve të bllokut komunist. Unë mbaj mend që tema e madhe ka qenë "Political Econ-

omy of Reforms", sepse reformat kishin filluar në ish-Bashkimin Sovjetik, kishin filluar pjesërisht në Hungari dhe pritej të ndodhte procesi i reformimit, pra cila ishte filozofia mbi të cilën vendet ishin gati ta bënin këtë reformë. Ekonomisti që iu bashkua këtij projekti nga Shqipëria ishte pikërisht Gramozi, jo se s'kishte të tjerë, mund të kishte dhe ekonomistë të tjerë në xhiro, por ai pati qëndroi në fakultet dhe e pa Fakultetin e Ekonomisë si vendin ku ai mund të kontribuonte, mund të shpërndante atë shpirtin e vetë liberal, qoftë te studentët, qoftë te pedagogët e rinj dhe më pas në një rreth më të gjerë se sa fakulteti Ekonomik. Unë besoj që të gjithë ata që kanë punuar me Gramozin e kanë këtë përshtypje. Ishte shumë tip i çuditshëm, thashë atipik, unë po i them këto në mënyrë të rregullt por ai nuk i bënte këto në mënyrë të pëlqyeshme për sistemin. Për shembull ai thoshte: "ejani sonte për darkë", gjente një sebp dhe na thërriste. Unë jam shumë skematike për vete, mendohej ta kem jetën në kontroll dhe një pjesë e suksesit tim në akademi, duke bërë mësim, e kam marrë pikërisht nga ajo mendja e hapur dhe kontakti që Gramozi vendoste me çdo njeri. Profesorëve tanë nuk mund t'u flisje në ato kohë, tani unë e kuptoj që ata nuk kishin asnjë dije të vlefshme, më vjen keq për ta, por ishin aq larg nga ne sa ne nuk guxonim t'i pyesim asnjë gjë, mesa duket kjo barriera i mbante ata në piedestalin e tyre edhe me padije. Ndërkohë që po t'ju flasësh të rinjve, kupton që ata kanë shumë më tepër dije, dhe ti bëhesh kurioz, kuriozitetin e kanë më të madh të rinjtë se të moshuarit. Kështu që duke qenë në kontakt me ta, ti mëson, e merr atë kuriozitetin dhe e përdor. Kjo ishte ajo që unë mësova nga Gramozi. (mapo)

si me një shtet të pavarur, dhe se për këtë vendimi ishte miratuar në nivel të BE-së. Nuk thuhej se "merrej në dijeni" ndonjë paragraf për demokracinë apo të drejtat e pakicave, por se është vendosur që raportet me Malin e Zi të jenë si me një shtet të pavarur. Ja çfarë thuhej në konkluzionet e BE-së pas shpalljes së pavarësisë së Malit të Zi nga ana e Kuvendit në Podgoricë: "Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtare për këtë kanë vendosur që të zhvillojnë tash e tutje raportet me Republikën e Malit të Zi si me një shtet sovran dhe të pavarur, duke marrë tërësisht në konsideratë rezultatet e referendumit dhe aktet e pastajme të Parlamentit", thuhej në deklaratën e Këshillit të Jashtëm të BE-së dhe më tutje shtohet se "shtetet anëtare do të ndërmarrin masat e duhura për implementimin e këtij vendimi në përputhje me të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare".

Sa u përket dallimeve mes Katalonjës dhe Kosovës, ato janë të shumta dhe të qarta. BE-ja pa dyshim do t'i përgjigjet Serbisë pse Kosova është një rast i veçantë, i cili nuk mund të krahasohet me asnjë rast tjetër. Për këtë përmendet situata që solli deri tek shpërbërja e ish-Jugosllavisë, shkelja e të drejtave të njeriut në Kosovë, pastriimi etnik, ndërhyrja ushtarake, vendosja e administratës ndërkombëtare, rezolutat e OKB-së dhe deklaratat e Grupit të Kontaktit, propozimi i një të dërguari ndërkombëtar, e shumë të tjera. Por as në atë përgjigje BE-ja nuk do të mund të shprehet se Kosova mund të jetë shtet i pavarur. Mungesa e një përgjigjeje të tillë do të vazhdojë t'i bëjë dëm Kosovës, të komplikojë rrugëtimin e Kosovës në procesin e integrimi në BE dhe do të inkurajojë Serbinë që të jetë destruktive në raport me Kosovën. Një sjellje e tillë agresive e Serbisë dëshmon se nuk janë të bazuara pritjet se Serbia është duke u bërë gati të përballet me realitetin se Kosova është shtet i pavarur. (koha.net)

Kriza në Spanjë është mundësi për Europën



Yanis VAROUFAKIS

Për të rigjallëruar projektin e sëmure evropian, konflikti i shëmtuar mes qeverisë rajonale të Katalonjës dhe shtetit spanjoll mund të jetë pikërisht ajo që doktori ka sugjeruar. Një krizë e madhe kushtetuese në një vend të rëndësishëm të Bashkimit Evropian krijon një mundësi të artë për të rikonfiguruar qeverisjen demokratike të institucioneve rajonale, kombëtare dhe europiane, duke çuar në një BE mbrojtëse, në këtë mënyrë dhe të qëndrueshme. Reagimi zyrtar i BE-së ndaj dhunës së policisë të hasur në referendumin e Katalonjës për pavarësi rezultoi braktisje e detyrës. Të deklarosh, siç bëri presidenti i Komisionit Evropian, se ky është një problem i brendshëm spanjoll ku BE-ja nuk ka asgjë për të thënë është hipokrizi e madhe. Sigurisht, hipokrizia ka qenë prej kohësh në qendër të sjelljes së BE-së. Zyrtarët e saj nuk kanë pasur brejtje ndërgjegje për përfshirjen në çështjet e brendshme të një vendi anëtar – të themi për të kërkuar heqjen e politikanëve të zgjedhur që kanë refuzuar të zbatojnë shkurtimin e pensioneve të shtetasve më të varfër apo për të shitur asetet publike me çmime qesharake (diçka që e kam përjetuar personalisht). Por kur qeveritë hungareze dhe polake braktisën parimet thelbësore të BE-së, mos-ndërhyrja u bë papritur e shenjtë.

Çështja katalane ka rrënjë të thella historike, siç më gjerësisht ka dhe nacionalizmi. Por a do të kishte shpërthyer ashtu siç bëri së fundmi nëse Europa nuk do të kishte keqpërdorur krizën e eurozonës që nga 2010, duke imponuar stanjacion thuajse-permanent në Spanjë dhe në pjesën tjetër të periferisë evropiane ndërsa lejoi ksenofobinë dhe panikun moral kur refugjatët filluan të kalonin në kufijtë e jashtëm të Europës? Një shembull ilustron lidhjen. Kryeqyteti elegant i Katalonjës, Barcelona, është një qytet i pasur që drejton një buxhet me teprica. Megjithatë shumë prej qytetarëve të tij u përballën së fundmi me dëbime nga bankat spanjolle që janë nxjerrë nga falimenti me taksat e tyre.

Bashkimi Evropian duhet të rishikojë traktatet e veta, për t'i hapur mundësinë demokracisë lokale të jetë më e fuqishme dhe të sheshojë pakënaqësinë dhe humbjen e shpresës, që përbëjnë arsyen kryesore të nacionalizmit dhe ksenofobisë

Rezultati ishte formimi i një lëvizje civile që nga qershori 2015 ia doli të zgjedhë Ada Colau si kryebashkiake të Barcelonës. Mes angazhimeve të Colau te njerëzit në Barcelonë ishte një ulje taksash lokale për bizneset e vogla dhe familjet, ndihmë për të varfrit dhe ndërtim për strehimin e 15,000 refugjatëve – një pjesë e madhe nga numri total që Spanja duhet të merrte nga shtetet si Greqia dhe Italia. E gjitha kjo mund të arrihet pa ndikuar te bilancet e qytetit, thjesht duke pakësuar tepricat e buxhetit bashkiak. Mjerisht, Colau shpejt kuptoi se kishte përpara pengesa të pakapërcyeshme. Qeveria qendrore spanjolle, duke cituar obligimet ndaj direktivave të BE për kursimin, kishte vënë në zbatim legjislacionin që ndalonte çdo bashki nga pakësimi i tepricës. Njëkohësisht, qeveria qendrore ndaloi hyrjen e 15.000 refugjatëve për të cilët Colau ndërtoi objekte strehimi të shkëlqyera.

Edhe sot e kësaj dite, prevalon buxheti me tepricë, ulja e taksave nuk është zbatuar dhe strehat sociale për refugjatët mbeten të zbrazëta. Rruga nga kjo gjendje e mjeruar e punëve, drejt ringjalljes së separatizmit katalan nuk mund të ishte më e qartë. Në çdo krizë sistematike, kombinimi i kursimit për shumicën, socializmi për bankierët dhe mbyjtja e demokracisë vendore krijon mungesë shprese dhe pakënaqësi – që janë oksigjeni i nacionalizmit. Katalanasit progresivë, anti-nacionalistë, si Colau, e gjejnë veten mes dy zjarreve: establishmentit autoritar të shtetit, që përdor direktivat e BE-së si mbulim për sjelljen e vet dhe një rilindje të izolimit radikal, nativizmit atavistik. Të dyja reflektojnë dështimin për të përmbushur premtimin e një begatije të përbashkët, pan-evropiane. Katalunja ofron një shembull të shkëlqyer studimi të rebusit të gjerë të Europës. Zgjedhja mes një shteti spanjoll autoritar dhe një nacionalizmi "ta bëjmë Katalonjën madhështore sërish" është e barabartë me zgjedhjen mes Jeroen Dijsselbloem, presidentit të

Eurogrupit të ministrave të financës së eurozonës dhe Marine Le Pen, liderës franceze të Frontit Kombëtar: kursim ose disintegracion. Detyra e evropianëve progresivë është t'i refuzojnë të dy: establishmentin e thellë në nivel BE-je dhe nacionalizmin që rrënon solidaritetin dhe mirëkuptimin në shtete anëtare si Spanja. Alternativa është të Europianizohet zgjidhja e një problemi të shkaktuar kryesisht nga kriza sistematike e Europës. Në vend të pengimit të qeverisjes demokratike lokale dhe rajonale, BE-ja duhet ta nxisë atë. Traktatet e BE-së mund të ndryshohen për t'i dhënë më tepër hapësirë qeverive rajonale dhe këshilleve të qyteteve, si Katalonjës dhe Barcelonës, për autonomi fiskale dhe madje për paratë e tyre fiskale. Ata mundet gjithashtu të lejohen të zbatojnë politikat e veta për refugjatët dhe migracionin.

Nëse ka ende kërkesë për shtetësi dhe separatizëm nga shteti ndërkombëtarisht i njohur që ata i përkasin, BE-ja mund të krijojë një kod për shkëputje. Për shembull, BE-ja mund të përcaktojë se do të sanksionojë një referendum pavarësie, nëse qeveria rajonale që e kërkon atë ka fituar tashmë një palë zgjedhje me një platformë të tillë me shumicë absolute votuesish. Për më tepër, referendumi duhet të mbahet të paktën një vit pas zgjedhjeve, për të lejuar një debat të saktë rreth tij. Sa për shtetin e ri, duhet të mbajë të paktën të njëjtin nivel transfertash fiskale si më parë. Veneto i pasur mund të shkëputet nga Italia, për shembull për sa kohë mbante transferta fiskale me Jugun. Për më tepër, shteti i ri duhet të ndalohet nga ngritja e kufijve të ri dhe të garantojë se banorët e vet do të kenë të drejtën e shtetësisë së trefishit (të shtetit të ri, të shtetit të vjetër dhe evropiane). Kriza në Katalonjë është një dëshmi e fortë nga historia që Europa ka nevojë të zbatojë një lloj të ri sovraniteti, që forcon qytetet dhe rajonet, që shkrin partikularizmin kombëtar dhe ruan normat demokratike. Përfituesit e drejtpërdrejtë do të ishin katalanasit, njerëzit e Irlandës Veriore dhe mbase skocezët (të cilët në këtë mënyrë do të mund të dilnin nga dhëmbët e Brexitit). Por përfituesi afatgjatë i këtij lloji të ri të sovraniteti do të ishte Europa si e tërë. Imagjinimi i një demokracie pan-evropiane është kusht i domosdoshëm për të imagjinuar një Europë që ia vlen të shpëtohet. (reporter.al)



Pasi mbaroi muajin e vullnetarizmit në aksionin hekurudhor, Dritëroi u regjistrua në Shkollën Unike të Bilishtit, ku pas diplomimit, mund të bëhej mësues. Atëherë ishte 15 vjeç dhe kishte bindje të plotë për të vazhduar të gjitha ciklet shkollore, deri në universitet, meqenëse nga familja nuk kishte asnjë pengesë

Ilir BUSHI

Pas luftës, Dritëroi u bë një eksponent aktiv i lëvizjeve progresiste, rinore në Shqipëri. Kështu, ai mori pjesë në hekurudhën Durrës-Peqin, që filloi punimet në vitin 1945, ku punoi për një muaj si vullnetar. Pas Çlirimit, në vendin tonë u krijua një atmosferë entuziaste, që përfshinte rrëmujën ndërtimore të veprave industriale dhe infrastrukturës rrugore. Njerëzit ishin të mbushur me shpresa dhe kurrë se po lindte një jetë e re, pa agallarë e shfrytëzues. Ata e lëshuan veten në spiralet e itinerarit të ri, ku mendonin se do shihnin parajsën. Në atë kohë, një banor i Menkulasit, që ishte me Dritëroin në hekurudhë, hodhi publikisht lugën e drurit në pus dhe nuk pranoi as lugë alumini, ngaqë shpresonte, qysh në vitin e parë, të shihte lugët e floririt.

Por një funksionar, kur e pa se prishmëria e fshatarit ishte emergjente, e qetësoi atë duke i thënë: “Mos u mërzit, se sapo jemi çliruar, prandaj në fillim do bëjmë rrugët, pastaj lugët”. Vetë funksionari që ia tha këto fjalë kishte një xhakatë doku, të arnuar në tri-katër vende dhe kur hapi gojën u dallua se shumë dhëmbë i mungonin. Pra, sekretarët e partisë, që trumbetonin lugët e floririt ishin po aq të drobitur sa edhe të tjerët që dëgjonin, me përjashtim të faktit se ata merrnin rrogën për të bërë propagandë, një rrogë që afrohej me rrogën e shkrimtarit.

Ata gënjenin atëherë njëllor siç bëjnë sot deputetët e Kuvendit nëpër fushata elektorale, duke premtuar parajsën. Traseja Durrës-Peqin ishte linja e



parë hekurudhore me skartament standard nga Durrësi në Peqin, pa llogaritur linjat minerare dhe ushtarake me skartament të ngushtë, të ndërtuara ndërmjet viteve 1917 dhe 1930 nga austro-hungarezët dhe italianët. Siç e thamë, hekurudha filloi në vitin 1945 dhe përfundoi në nëntor të vitit 1947. Por, Dritëroi atje u aktivizua në periudhën e parë, duke ndenjur një muaj si vullnetar. Ndërkaq, ai vazhonte shkruante dhe duke respektuar talentin e vet, i nxirrte vjershat e tij në gazetë e murit. Vëllai i tij, Tajar Agolli, sqaron se: “Në atë kohë Dritëroi inspirohej ose frymëzohej nga veset e shëmtuara njerëzore, që ishin vjedhjet dhe mashtrimet e ndodhura në fshat. Kjo duket te theksi që ai vinte te vargjet e tij, duke dashur të godiste veset e këqija me vargje të hijshme, të cilat pëlqeshin shumë prej banorëve të zonës”. Nga kjo gjë ata çuditësin, por edhe kënaqeshin për dy arsye kryesore: E para, sepse godisnin individët që shkelnin rregullat dhe e dyta, kishte të bënte me faktin se në gjirin e tyre po lindte një poet i ri, që mund ta bënte krahinën e Devollit të njohur e të dëgjuar në të gjithë Shqipërinë.

Në shkollën e Bilishtit

Pasi mbaroi muajin e vullnetarizmit në aksionin hekurudhor, Dritëroi u regjistrua në Shkollën Unike të Bilishtit, ku pas diplomimit, mund të bëhej mësues. Atëherë ishte 15 vjeç dhe kishte bindje të plotë për të vazhduar të gjitha ciklet shkollore, deri në universitet, meqenëse nga familja nuk kishte asnjë pengesë. Bilishti ishte zona kryesore, ose kryeqendra e Devollit, që ka shumë fshatra të tjera përreth. Kjo quhej “Shkolla Unike”, trevjeçare, që nxirrte mësues. Ajo ishte parajmnaz dhe aty mund të hyje pasi të mbaroje pesë klasat e fillores. E kishte programin më të gjerë se 9-vjeçarja e sotme, se edhe po të mos mbaroje shkollën e mesme, quhej si një “arsim plotësues”. Lidhur me këtë periudhë, Dritëroi thotë: “Atje ne algjebrenë e bënim siç e bën gjimnazi tani, po ashtu letërsinë, gramatikën në gjuhë, por kishim edhe gjuhën franceze, që e mësonim në tre vjet. Bënim gjuhën franceze, se nuk kishim pedagogë rusë, ishte vazhdimi i shkollës franceze dhe profesorët tanë të asaj shkolle ishin të kësaj edukate, të liceut francez.

Kështu që ishim më të përgatitur se tani, sepse është e zgjatur koha e mësimi”.

Aty mund të regjistroheshesh pasi bëje shkollën fillore. Ajo ndryshonte pak me tetëvjeçaren që kemi sot, pasi atje mësimet ishin thuajse si gjimnazet. Madje, e quanin ‘paralice’. Mësimet ishin më të vështira, ndërsa për të fjetur shërbente konvikti me pagesë. Por gjatë ditëve të shkollës Dritëroi qëndroi në një shtëpi me qira në Bilisht së bashku me një shok tjetër, që quhej Sulo Kadia. Dritëroi i vlerëson të gjithë mësuesit e shkollës, por në mënyrë të veçantë ai listoi për mësuesin e letërsisë, e cila e kishte shumëfishuar dëshirën dhe pasionin e tij për botën letrare. Ajo quhej Virgjini dhe ishte 14 vjet më e madhe se Dritëroi, i cili sapo kishte mbushur 15 vjeç, por kureshtja për botën e kishte mbushur plot memorien e tij prej fëmije. Pikërisht në lëndën e saj të letërsisë, Dritëroi shkëlqeu, sidomos me hartimet që bënte. Një ditë, kur në Bilisht binte dëborë, mësuesja i kish caktuar si temë të hartimit që të përshkruanin atë ditë dimri me dëborë. Mësuesja Virginia e kishte zakon të përzgjidhte e të lexonte hartimet më të mira para nxënësve të tjerë. Dhe kur





ajo shpërndau hartimet, kish zgjedhur hartimin e Dritëroit dhe të një shoqes së klasës së tij, si më të mirët. Midis të tjerave, Dritëroi kish shkruar: “I nxjerrim nga ahuri lopët, qetë, kalin, dhentë. Në govatat e pusit pinë ujë. Pastaj i nxjerrim nga porta e madhe për të shëtitur pak, pasi iu ziejnë gjunjët. Duke ndenjur në ahur, gjithnjë me gjunjët e mpirë, qetë nuk do të mund të lërojnë tokën në pranverë”.

Siç kujton shkrimtari, mësuesja e tij, Virginia ndenji 2 vjet në Shkollën Unike dhe pastaj u zhvendos në Institutin e Parë Pedagogjik. Por në ato dy vjet, prej saj ai mori mësimet të vyera. Kur ishte në klasën e 7 të kësaj shkolle, pikërisht në muajin shtator të vitit 1947, ai botoi vjershën e parë që titullohej “Vullnetari”. Këtë vjershë e kishte shkruar gjatë pushimeve verore, kur punoi si vullnetar në hekurudhën Durrës-Peqin. Para se ta çonte për botim në Tiranë, Dritëroi ia tregoi poezinë e tij mësueses së letërsisë, Virgjinisë, pasi kishte një besim shumë të madh jo vetëm tek aftësia e saj, por edhe te mirësia që reflektonte me rekomandimet që jepte. Por, ajo nuk bënte kompromis me vlerat letrare dhe kur diçka

nuk i pëlqente, e thoshte menjëherë se ku çalonte vargu, ose ku i kishte vlarë veshin ndonjë rimë. Vjershat e Dritëroit i kishte qejf, megjithëse ndonjërin prej tyre e kishte penguar për ta dërguar në redaksitë e Tiranës. “Kjo nuk bën, – i thoshte ajo haptazi dhe vazhdonte – por, ti ke një penë të shkëlqyer dhe do të bëhesh poet”. Ndërsa, kur i dha poezinë, “Vullnetari”, ajo ia lexoi me kujdes dhe në fund të leximit tundi kokën e bindur se poezia ishte shkruar bukur.

–Po, kjo poezi mund të botohet – i tha ajo Dritëroit, i cili u mrekullua nga pohimi i saj dhe e futi menjëherë në një zarf, duke e dërguar në gazetën “Rinia” të asaj kohe. Gjithçka u krye në mënyrë të përsheptuar, sepse emergjenca e pasionit të nxënësit të saj priste të merrte krahë për të fluturuar. Dy-tri ditë pas dërgimit të zarfit në redaksi, Dritëroi pothuajse nuk flinte fare. Ai e kishte mendjen se çfarë po ndodhte në atë moment me poezinë e tij, atje larg, në Tiranë, ku redaktorët mblidheshin për të caktuar materialet që do botoheshin.

“Ah, sikur të dalë këtë të shtunë”, – thoshte Dritëroi, me vete, por të tjerëve nuk u shprehte asgjë. Sepse dashuria e tij për letërsinë



Dritëro Agollin



tij për të ndjekur ëndrrën e shkollimit drejt gjimnazit të Gjirokastrës. Atij i kishte dalë bursa. Siç e thamë edhe më lart, Dritëroi kish kryer arsimin shtatëvjeçar, apo siç quhej atëherë, “arsimi unik”, që kish marrë në Bilisht dhe kjo mjaftonte që ai të bëhej mësues, por ste-ka e pikësnyimeve të tij ishte ngritur shumë lart, duke kërkuar të gjitha stadet e shkollimit të mundshëm të asaj kohe.

Arsyeja e përzgjedhjes së Gjirokastrës kishte të bënte thjesht me perceptimin e tij për tradicionin kulturor të këtij qyteti, ku përmendeshin emra të njohur intelektualësh. Natyrisht, mendimi i parë për të zgjedhur Gjirokastrën kishte të bënte me kushtet e konvikteve të fjetjes. Sepse në qytete të tjera, duke përfshirë edhe Korçën, nuk kishte konvikte, apo kushte stimuluese për vendqëndrimet e studentëve, të cilët përfundonin nëpër shtëpitë private me qira, që kush-tonin shumë. Ndërsa, Gjirokastra e kishte këtë fat, ngaqë atje kishte një konvikt, ku thuajse të gjithë konviktorët ishin djem. Me sa duket, mentaliteti i kohës nuk i lejonte prindërit që të dërgonin vajzat e tyre larg shtëpisë, në qytete të tjera, ku ishin jashtë kontrollit dhe tutelës familjare. Vendndodhjen e gjimnazeve që kishin konvikte, Dritëroi e kish mësuar më parë, gjatë kohës kur kish vendosur të vazhdonte Shkollën Unike, duke pikësnyuar një qytet të madh si Korça, por duke përfunduar në një qytezë si Bilishti. Në atë kohë, gjimnaze të arsimit të përgjithshëm kishin vetëm disa qytete si Tirana, Shkodra, Korça, Elbasani dhe Gjirokastra. Në Korçë nuk kishte konvikte, prandaj Dritëroi zgjodhi gjimnazin tjetër më të afërt, që ishte në Gjirokastrë.

Shoku i tij ngushtë i gjimnazit, Gaqo Veshi, tregon: “Ishte mesi i gushtit të vitit 1948, kur u njohëm për herë të parë me Dritëronë në ambientet e Agjencisë së Udhëtarëve në Korçë. Na kishte dalë bursa për të vazhduar shkollën e mesme ‘Asim Zeneli’ në Gjirokastrë dhe duke pritur për të shkruar në Gjirokastrë, mësova se kisha të bëja me një poet të ri, që shkruante vjersha e që disa prej tyre i kishte botuar në shtypin e kohës, si në gazetën ‘Rinia’ apo ‘Letrari i ri’.

Në atë vit, rrugën Korçë-Gjirokastrë e bënte një herë

në javë një kamion i zbuluar dhe ishte e zorshme të merrje biletë, prandaj ne të dy çdo mëngjes zinin ‘kamaren’ e agjencisë, por në vend të merrnim biletë, merrnim njoftimin: ‘Biletat u mbaruan’. Si u endëm ditë të tëra, duke u shkëputur për t’i bërë telegram shkollës: ‘Shkak komunikacioni, vonohemi. Dritëro Agolli, Gaqo Veshi’”. Por, pasi pritën disa ditë, më në fund ata u nisën drejt Gjirokastrës. Gjimnazi i Gjirokastrës i përmbushte më së miri të gjitha pritshmëritë e tij, si në famën e traditës, kushtet e akomodimit dhe në nivelin e profesorit, ku kishte emra të mëdhenj. Nëse do të zgjidhte diçka më shumë, për fatin e tij padyshim do të kish qenë prezenca e vajzave në konvikte, ku mosha rinore kish futur në prizë elektrodën e zemrave.

Historia e ngritjes së gjimnazit “Asim Zeneli” nis më 23 nëntor të vitit 1923, kur Këshilli Bashkiak i asaj kohe mbështeti kërkesën e popullit të Gjirokastrës dhe rrethinave të saj për hapjen e tij. Sipas historikut të atyre viteve, themelet e këtij gjimnazi u piketuan dhe u ngritën nga franko-zvicëranët qysh në vitin 1922. Në fillim ideja ishte për ngritjen e një liceu dhe ai u quajt Liceu Francez i Gjirokastrës, por më vonë u kthye në gjimnaz, duke marrë emrin e heroit të popullit, Asim Zeneli, që ishte vvarë në betejën e Mezhgoranit, pranë Gjirokastrës. Në fillim liceu nisi nga puna duke kombinuar kulturat e botës nëpërmjet mësuesve, që kishin studiuar në vende të ndryshme si Francë, Zvicër, Gjermani, etj. Liceu nuk pati jetë të gjatë, por shumë shpejt u krijua Liceu-Gjimnaz dhe më vonë Gjimnazi “Asim Zeneli”.

Gjimnazi ndodhej në lagjen “Varosh” dhe ai kishte një konvikt me rreth 200 vende, ku duhej të vinin nxënës me biografi të pastër, sepse për shkaqe biogرافية ishin përjashtuar shumë konviktorë dhe 3 prej tyre u burgosën me akuzat qesharake. Meqenëse po flasim për letërsinë dhe meqenëse nga ky gjimnaz dolën dy figurat kryesore të saj, atëherë këtu mund të vëmë re fenomenin dhe mund të shtrojmë pyetjen: çfarë disidence kërkonim ne nga shkrimtarët, në një vend që i përjashtonte dhe i burgoste gjimnazistët pa bërë asnjë faj, por vetëm për çështje biografie?

ishte e fshehtë, si një margaritar, që nuk mund të shpërdorohej duke ua treguar të tjerëve. Sikur ta kishin ditur këtë gjë, redaktorët e vunë menjëherë në grupin e materialeve që do të botoheshin të shtunën, pra pas tri ditësh. Dhe ashtu ndodhi. Poezia u botua dhe u pëlqye. Ajo bënte fjalë për hekurudhën e parë të vendit, që do të fillonte të lidhte nëpërmjet shinave, qytetet e Shqipërisë dhe zemrat e njerëzve. Në këtë mënyrë, shtrimi i hekurudhës, sipas poezisë, ishte një rrugë drejt qytetërimit.

Dritëroi u gëzua pa masë kur pa emrin e tij në gazetë. Gjer atëherë, atij i qe dukur gazeta si një portë, ku mund të hynin vetëm poetët e mëdhenj, shqiptarë, që kishin dhënë prova të hershme të talentit të tyre. Ndërsa, për vete kish menduar se kjo gjë do të ndodhte patjetër, por pak më vonë, kur vargjet e tij të kristalizoheshin qartazi nëpërmjet përvojës e talentit. Dalja në gazetë ishte një lloj licence, që kërkonin të rinjtë për t’u siguruar në bazamentet e talentit të tyre. Por gjithçka ndodhi shumë shpejt, sa hap e mbyll sytë. Ai tanimë ishte bërë papritur një poet i publikuar, që kishte dalë në gazetë. Tani gjithkush mund ta lexonte emrin e tij në të gjithë re-

publikën. Babai i Dritëroit, Rexhepi, gjithashtu u emocionua shumë nga botimi i poezisë së parë dhe kur pa emrin e djalit të tij, e grisi faqen e gazetës dhe e vuri në kutinë e duhanit, që t’ua tregonte shokëve e bashkëshatarëve, duke i thënë: “Ja ç’ka shkruar djali im”. Ndërsa, Virginia e mori dhe e recitoi vjershën para nxënësve, duke thënë: “Ja, do të dalin nga kjo shkollë edhe poetë”.

Emocioni i parë e nxiti Dritëronë të shkruante me më shumë intensitet e pasion, për të zbuluar projeksione të ndryshme të jetës sociale për njerëzit tanë. Më vonë botoi në gazetë edhe vjersha të tjera: për jetën, për partizanët, për ndërtimin e vendit etj., etj. Botimi i parë e inkurajoi Agollin, i cili i rriti kërkesat ndaj vetes duke pikësnyuar jo vetëm tematikën, por edhe vlerat letrare të vargut të tij. Për këtë eveniment, pra për aksionet e rinisë në hekurudhë, Dritëroi shkroi edhe disa poezi që i botoi në gazetën “Letrari i ri” dhe “Rinia”. Në faqen e dytë të saj ishte botuar një vjershë me emrin e tij. Ajo fillonte me vargjet: “Ky gjoksi i sulmuesit sa bukur qëndisur,/ Me trikatër ‘S’ bukur stolisur./ Këto ‘S’-të e tij me ngjyrë të verdhë/ Na tregojnë punën,

djersën që ka derdhë”. Në gazetën “Letrari i Ri”, më 16 gusht 1948 u botua një poezi, ku midis të tjerave shkruhej:

Prej Tirane, gjer në det,
mina, kazma po buçet

Shket vagoni, plot me dhe,
se ndërtohet jetë e re

Jetë e re e lumturisë, me aksionin e rinisë

Dhe të rinjtë, me sytë si zjarr,
që u shkëlqejnë porsia

ar

Po sulmojnë me furi, me guxim e trimëri”, etj.

Kjo poezi u vendos më vonë në një ekspozitë të hapur në Bibliotekën Kombe-tare me rastin e 85-vjetorit të lindjes së poetit. Ekspozita e celur përmbante relike të gazetave, “Letrari i ri” e “Rinia” të vitit 1948, materiale të tjera, që nga vël-limet e para poetike “Në rrugë dola”, e deri te dorëshkrimet e fundit, të shkruara me dorën e dridhur, për shkak të rëndimit të gjendjes shëndetësore të shkrimtarit. Aty u ekspozua edhe makina e shkrimit dhe fotografitë e çasteve më kulmore të jetës së Dritëro Agollit.

Dritëroi e nxjerrin nga rreshti për këpucët e vjetra

Vëllai i Dritëroit, Tajari, tregon: “Përpara se Dritëroi të shkante tek ‘Asim Zeneli’

në Gjirokastrë, u bë festa e punëtorëve në 1 Maj të vitit 1947. Gjatë asaj dite u bënë parakalime, por Dritëroin e nxorën nga rreshti, sepse kishte veshur një pallto grash dhe një palë këpucë të vjetra. Pas kësaj ngjarje bëri një poezi që titullohej “Opinga dhe këpuca”, të cilën e nxori te gazeta e qendrës kulturore. Për këtë e vlerësuan të gjithë. Kjo gjë ndikoi që ai të fillonte shkollën pedagogjike në Gjirokastrë”. Ngjarja në fjalë ishte sa e hidhur, aq edhe groteske, por ky episod mund të bëhej shkak që Dritëroi të humbiste të drejtën e shkollimit për atë vit, ose të shihej me një sy diskriminues nga instancat përkatëse. Ajo që ndodhi ishte e thjeshtë dhe e zakonshme. Njerëzit në atë kohë ishin të veshur me rroba të sajua, ashtu siç ndodhte në të gjitha familjet shqiptare. Sepse kushtet ekonomike ishin të vështira dhe shqiptarët përpiqeshin të përshtateshin me përditshmërinë e tyre. Në atë kohë, blerja e një xhakete ishte një luks jo vetëm për adoleshentët, por edhe për të rriturit.

Sidoqoftë, puna u sqarua shumë shpejt dhe gjithçka u rregullua vetëm me një poezi. Pas kësaj, Dritëroi bëri gati valixhen e



Reagimet e paefektshme rreth Speciales

Pendimi i kreut të shtetit të Kosovës për themelimin e Gjykatës Speciale për krimet luftës në Kosovë, nuk mund të prodhojë asnjë efekt në raport me vet gjykatën por as ndonjë reagim të opinionit karshi kësaj gjykate, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike dhe të aspekteve juridike në Kosovë



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ditën e hënë, gjatë prezantimit të një raportit për perceptimin publik rreth Gjykatës Speciale, të organizuar nga disa organizata joqeveritare në Prishtinë, e ka cilësuar themelimin e Gjykatës speciale, “proces të padrejtë historik ndaj Kosovës”. Ai ka theksuar se ka pranuar ta udhëheqë këtë proces, si kompromis, me premtimet nga faktorëve ndërkombëtarë, për liberalizim të vizave, për formimin e ushtrisë, pranimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, si dhe rritjen e numrit të

njohjeve nga vendet e ndryshme. Politologu Ramush Tahiri, duke folur për Radion Evropa e Lirë, ka theksuar se reagimi i presidentit Thaçi, vjen si pasojë e zhgënjimit me faktorët e caktuar ndërkombëtarë, që nuk realizuan kompromiset, për të cilat opinionin vendor nuk ka pasur informacione në kohë reale. Por, siç thotë Tahiri, pendimi i kreut të shtetit lidhur me çështjen e Gjykatës Speciale, nuk do të mund të ketë asnjë ndikim në punën e kësaj të fundit.

“Kjo gjykatë nuk mund të abrogohet, sepse nuk pritet që Kuvendi të rishqyrtojë dhe të marrë vendim tjetër, megjithëse kishte disa përpjekje në të kaluarën, para disa muajve në Kuvendin e Kosovës. Kjo është thjeshtë një lloj, ndoshta, shfaqjesimi - që kjo gjykatë po punon - i Hashim Thaçit, tash në funksionin e presidentit. Por, nuk mendoj që do të ketë ndonjë ndikim praktik, përveç që do të ketë ndikim në marrëdhëniet e Kosovës ose të vet presi-

dentit me faktorin ndërkombëtar”, thotë Tahiri. Por, eksperti i çështjeve juridike - kushtetuese, Mazllum Baraliu, profesor në Universitetin e Prishtinës, thotë për Radion Evropa e Lirë se është krejtësisht e parëndësishme nëse janë penduar ose jo drejtuesit e institucioneve të Kosovës lidhur me Gjykatën Speciale. Sipas tij, presidenti Thaçi, i cili në kohën e nisjes së procesit për themelimin e Gjykatës Speciale ishte në pozitën e kryeministrit, është dashur t'i

bëjë publike kompromiset. “Është pendim ose jo, kjo është jorelevante. Si zakonisht, eksponentët e institucioneve tona, kanë qenë vazhdimisht në funksion të kërkesave të bashkësisë ndërkombëtare. Ndërkaq, kjo që tash ai (Thaçi) po thotë se ka pasur një kompromis, për këtë kompromis nuk kemi ditur. Është dashur që atëherë, ata dhe ky vet, të këmbëngulin që kur bëhen marrëveshje të tilla, kompromisi të ketë mekanizma garantimi, që ato të realizohen dhe jo që Kosova vazhdimisht të humbë”. Por, a mund të krijojnë efekte në opinionin publik deklaratat e presidentit Thaçi, lidhur me Gjykatën Speciale? Politologu Tahiri shpreh mendimin se kjo deklaratë mund ta nxisë opinionin, por mendimi dhe reagimi eventual i opinionit nuk mund të ndikojë në punën e Gjykatës Speciale. “Reagime të opinionit do të ketë, sepse askush, duke përfshirë edhe vet presidentin, nuk janë të amnistuar nga hetimi i kësaj gjykate dhe nga procesi i drejtë dhe i ndershëm që do të

mundësohet, varësisht prej dispozitave ligjore që janë paraparë me këtë ligj. Mirëpo, kjo punë nuk ndihmon, sepse opinionin dhe ndikimin e opinionit në proceset gjyqësore është i pavarur prej punës së vet gjykatës”. Profesor Baraliu nuk pret reagim nga opinionin, për shkak se sipas tij, reagimi i Presidentit është i vonuar. “Ndoshta është reagim i vonuar edhe i vet Presidentit, për shkak se atëherë është dashur të veprojë dhe të mos lejojë kompromise të tilla që të mos realizohen edhe në dobi të Kosovës, që të përfitojë diçka edhe Kosova dhe jo vetëm të humbë, siç është rasti me Gjykatën Speciale, e cila me të vërtetë është e padrejtë”. Presidenti Thaçi, megjithatë ka deklaruar se Gjykata Speciale “do të jetë vetëm një pikë drejtësi”, siç ka thënë ai, “në detin e padrejtësive që kanë ndodhur në Kosovë”. Ai ka ngritur pikëpyetjen se “a do ta nxjerrë të vërtetën dhe a do të sjellë pajtim ndëretnik”, Gjykata Speciale, e cila pritet që në një të ardhme shumë të afërt të procedojë me rastet e para.

Shqipëria t’u jep shtetësinë kosovarëve që të lëvizin lirshëm

Gjatë konferencës së përbashkët për media të presidentit Thaçi dhe homologut të tij nga Shqipëria, Ilir Meta, Thaçi ka thënë se ka kërkuar nga Meta që Shqipëria t’u jap shtetësinë kosovarëve si pasojë e bllokadës që BE-ja po ia bën kosovarëve për të lëvizur lirshëm.

“Kam kërkuar nga presidenti Meta që kosovarëve, sidomos studentëve dhe biznesmenëve, t’u mundësohet që të kenë nënshtetësi të Shqipërisë në mënyrë që të lëvizin lirshëm.

Këtë e mundëson edhe



Kushtetuta e Kosovës edhe Thaçi. Kjo është edhe një ajo e Shqipërisë”, ka thënë deklaratë radikale e presi-

dentit Thaçi pas atyre të dy ditëve më parë kundër bashkësisë ndërkombëtare, që vijnë si pasojë e izolimit të Kosovës nga Bashkimi Evropian.

Ndryshe, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka mbërritur për një vizitë dyditore në Prishtinë. Ai është pritur me ceremoni shtetërore nga presidenti i vendit, Hashim Thaçi. Thaçi e Meta kanë zhvilluar një takim pa praninë e mediave. Presidenti shqiptar gjatë ditës është pritur edhe nga kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj.

Në burgjet e mbipopulluara të Kosovës ka radikalizëm dhe dhunë

Burgjet në Kosovë janë të mbipopulluara dhe po përballen me radikalizëm e dhunë, ka deklaruar Përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova. Këto komente, ajo i ka bërë në Prishtinë gjatë prezantimit të një projekti të Bashkimit Evropian që si qëllim ka përmirësimin e kushteve në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe ngritjen e standardeve në gjyqësor. Ky projekt është prezantuar nga ministri i Punëve të Jashtme të Finlandës, Timo Soini. Nataliya



Apostolova, tha se ky projekt ka vlerën rreth 2 milionë euro dhe do të financohet nga BE-ja. “Burgjet përballen me radikalizëm, mbi popullim e

me dhunë. Integritet sociale të shkelësve të ligjeve janë të domosdoshme”, ka thënë Apostolova. Përdorimi i ministri i Jashtëm finlandez, Timo

Soini tha se projekti në mbështetje të sistemit të drejtësisë në Kosovë udhëhiqet nga Finlanda. Qëllimi i këtij projekti, ka nënvizuar ai, është të mbështesë Kosovën në përmirësimin e standardeve në fushën e gjyqësorit duke forcuar kuadrin institucional të sistemit të burgjeve. Ministri Soini po qëndron në vizitë dyditore në Kosovë. Në agjendën e tij janë takimet me presidentin Hashim Thaçi, kryeministrin Ramush Haradinaj dhe përfaqësuesit tjerë të institucioneve të Kosovës.



Konsullatë e përbashkët Shqipëri-Kosovë në Milano

Konsullata e Shqipërisë në Milano është vendosur në godinën e re, ku do të ofrojë shërbime edhe për shqiptarët e Kosovës. Njoftimi është bërë nga Kryeministri Edi Rama përmes një postimi në Facebook. Shefi i qeverisë shqiptare thotë se shërbime të përbashkëta konsullore do të ofrohen së shpejti edhe në shtete të tjera. “U ngritën sot edhe flamujt në godinën e re të Konsullatës Shqiptare të Milanos. Në vijim do të çelim të tjera stacione dinjitoze e të përbashkëta për shërbimet konsullore për shqiptarët nëpër botë”, shkruan Rama.



Refugjatët në ishullin grek të shqetësuar nga ardhja e dimrit

Një numër i madh i refugjatëve të cilët qëndrojnë në çadrat verore që i kanë ndërtuar në zonën e pyllëzuar rreth kampit në ishullin Samos të Greqisë, kanë filluar të shqetësohen nga ftohja e motit, raporton Anadolu Agency (AA). Afërsisht 400 refugjatë në qendrën Vathi të ishullit përpigjen të mbijetojnë në zonën e pyllëzuar, pa ujë dhe energji elektrike dhe për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm të kampit. Refugjatët në rajonin ku moti është ftohur me afërsimin e muajve të dimrit, kanë filluar të ndjejnë edhe problemin e ngrohjes. Në ishullin ku ndodhet vetëm një kamp me kapacitet prej 700 personash, numri i refugjatëve arrin në 2.000. Shqetësim të madh paraqet situata e refugjatëve që duhet të jetojnë në çadra me fëmijë të vegjël dhe me anëtarë të familjes me aftësi të kufizuara në tenda verore jashtë kampit. Refugjati 47 vjeçar Ahmed Halil i cili është larguar nga Siria tha se për shkak të ftohtit vajza e tij 1 vjeçare nga 5 fëmijët e tij ka rrezik të sëmurët. "Na dhanë një çadër ku qëndrojmë 7 pjesëtarë të familjes. Natën është freskët dhe për t'u ngrohur kemi vetëm një batanije. Ndonjëherë vajza ime 1 vjeçare nuk mund të fle nga i ftohti", tha Halil duke shpjeguar se në kamp kanë mbërritur para katër ditësh dhe se janë befasuar nga ato me çfarë janë përballur. Halil tregon edhe një shqetësim tjetër në lidhje me sigurinë e fëmijëve ku ai vë në dukje se çdo natë në kamp ndodh një grindje ndërsa policia është e pamjaftueshme në kuptimin e sigurisë.



thotë se detyrohen të qëndrojnë me orë të tëra në radhë para dhomës së mjekut.

"Ndonjëherë para mjekut formohet një radhë prej 100 personash, sepse ka vetëm një mjek. Natën nuk ka njeri. Një shok i yni i cili ka plagosur këmbën në luftë arriti tek mjeku vetëm pas tre muajsh", tha Ibrahim. Sipas tij, lokacioni ku qëndrojnë refugjatët është një vend në kodër. "Reshjet e dendura të shiut mund të shkaktojnë përmbytje këtu. Ajo që na kanë dhënë për t'u mbrojtur është vetëm një mushamë e thjeshtë", thotë Ibrahim duke bërë të ditur se janë të shqetësuar nga dimri.

"FOSHNIJA DISA MUJESH QËNDROJNË NË ÇADRA PA NGROHJE"

Zëdhënësi për shtyp i Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) në Greqi, Boris Cheshirkov, në një deklaratë për gazetarin e AA-së tha se situata e refugjatëve në ishujt e Greqisë kryesisht në Samos ka marrë edhe njëherë një kahe shqetësuese. "Më shumë se 300 refugjatë, përfshirë edhe ato në kushte të pambrojtura, qëndrojnë jashtë kampit në tenda që nuk janë rezistente ndaj nxehtësisë, të ftohtit, dhe në mungesë të kushteve të higjienës", tha

Cheshirkov duke informuar se kampi me kapacitet prej 700 personash është i mbi-populluar dhe se janë strehuar më shumë se 2 mijë persona. Ai thotë se temperaturat e motit sa vijjnë e ulen dhe reshjet po afrohen. "I kemi bërë thirrje qeverisë për sigurimin e mundësive të përshtatshme me kushtet dimërore dhe sigurimin e nevojshëm të ndihmave. Që prej disa javësh familje me foshnja, me persona me probleme mendore dhe me aftësi të kufizuara qëndrojnë në kushte të papërshtatshme për dimrin. Kjo është e paprueshme", tha Cheshirkov. Sipas tij, këto probleme duhet të zgjidhen shumë shpejtë. "Jemi pranë nivelit 10 ndaj një çështjeje që ka nevojë për ndërhyrje emergjente nëse do ta vlerësonim në masën nga 1 deri në 10", tha ai.

"NEVOJAT MË THEMELORE NUK MUND TË PËRMBUSHEN"

Bogdan Andrei, anëtar i organizatës "Vullnetarët e Samos"-it (Samos Volunteers) të cilët ofrojnë shërbim arsimor për refugjatët në ishull tha se "Ndodhemi në një situatë ku nuk mund të përmbushen edhe nevojat më themelore për refugjatët". "E ndjeni tensionin kur ecni në kamp. Refugjatët janë të zemëruar dhe në prag të shpërthimit", tha Andrei duke bërë të di-

Afërsisht 400 refugjatë në qendrën Vathi të ishullit përpigjen të mbijetojnë në zonën e pyllëzuar, pa ujë dhe energji elektrike dhe për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm të kampit

tur se refugjatët mund të shpëtojnë sado pak nga presioni i kampit falë qendrës së tyre "Alpha". Ai u shpreh se nevoja më e rëndësishme e të rinjve dhe fëmijëve në kamp është siguria. "Kryesisht fëmijët e pashoqëruar janë të pambrojtur. Ndodhin shumë ngjarje të dhunshme dhe ato ndikohen ose përfshihen në këto. Është kusht transferimi i tyre sa më parë në një vend tjetër", tha Andrei.

Ndër të tjera duke vënë theksin se nuk përmbushen as nevojat e strehimit për fëmijët, Andrei thekson se "Kur të fillojnë shirat çadrat do të përmbyten dhe shumë fëmijë nuk do të mund të kenë ku të strehohen apo të flenë. Gjithashtu edhe uji ndërpritet çdo ditë në kamp. Po përballemi me një problem të madh të higjienës".

"RRITJE E RETORIKAVE KUNDËR REFUGJATËVE NË ISHULL"

Zoe Kokalou, përgjegjësjë për media i institucionit të organizatës civile Arsis e cila ofron strehim për refugjatët jashtë kampit ka tërhequr vëmendjen për atmosferën kundër refugjatëve në ishull. Ajo shpjegoi se banorët në një rajon të ishullit i kanë kundërshtuar kur kanë shkuar për marrë një shtëpi me qera. "Një grup me ideologji të së djathtës ekstreme fillimisht kreu sulme verbale ndaj vullnetarëve tanë. Ndërsa më pas fatkeqësisht ngjarja mori përmasa më të mëdha dhe ndodhi një sulm fizik ndaj vullnetarëve tanë", tha Kokalou. Duke tërhequr vëmendjen në retorikat e urtjes kundër refugjatëve, Kokalou tha se "Pas sulmit kemi patur një mbështetje të madhe. Por, sërish kemi shqetësim nga pikëpamja e sigurisë tonë".



India mund t'i lejojë gratë të shkojnë në haxh të pashoqëruara nga meshkujt

Gratë hindu mbi moshën 45 vjeçare dhe që udhëtojnë në grup prej 4 personash mund të shkojnë në pelegrinazhin e haxhit islamik pa shoqëruar meshkuj nga viti i ardhshëm, nëse qeveria e Indisë miraton reformat e propozuara. Gratë që i plotësojnë këto kritere nuk do të kenë më nevojë të shoqërohen nga një 'mahram', apo mashkull familjar, siç janë bashkëshorti, vëllai apo i biri, ka rekomanduar një panel i emëruar nga Qeveria dhe kjo është hera e parë që shteti rishikon politikën e haxhit. "Rregulli i 'mahramit' ishte aty që nga fillimi për gratë - në rast se përballen me ndonjë vështirësi gjatë udhëtimit, të kenë dikë që mund të kujdeset për to", ka thënë Maqsood Ahmed Khan nga Komiteti i Haxhit të Indisë, organ qeveritar që organizon pelegrinazhet. "Kjo (largimi i kujdestarit mashkull) është rekomandim i rëndësishëm", ka thënë shefi ekzekutiv për Reutersin. Thuajse gjysma e rreth 170.000 pelegrinëve që shkuan në festën vjetore fetare në Arabinë Saudite nga India ishin gra, thonë zyrtarët. Organizata për mbrojtjen e të drejtave të grave kanë mirëpritur një propozim të tillë, por kritikuan kriterin e moshës.

"Vampirët" dëbojnë misionin e OKB nga Malau



Kombet e Bashkuara kanë tërhequr punonjësit nga dy rajone në Malauin Jugor, ku një panik masiv vampirësh ka nxitur dhunë mes bandave që u ka marrë jetën pesë personave. Malau është një nga vendet më të varfra të botës, ku besimi në magji e supersticione të tjera është i zakonshëm në zonat rurale. Në një raport mbi situatën, Departamenti për Sigurinë në Kombet e Bashkuara tha se rajonet mulanje dhe falombe janë prekur nga historitë pa fund për thithje gjaku dhe ekzistencën e të vampirëve. Zyrtarët thanë se një pjesë e stafit është zhvendosur, ndërsa të tjerë mbeten në zonat e operacioneve të tyre, por nuk është specifikuar se sa punonjës janë prekur. Bandat që akuzojnë njerëzit për vampirizëm kanë nisur kërkimet për individë të caktuar dhe bllokojnë rrugët e raportohet se pesë persona janë vrarë në zonë muajin e shkuar. Paniku, sidoqoftë, mendohet se ka ardhur nga Mozambiku fqinj, por shkaqet mbeten të panjohura. Në 2002, Malau pa një valë dhune të lidhur me vampirët. Sulmet mbi njerëzit albinë për shkak të supersticionit, po bëhen sipas Amnesty International një krizë të të drejtave të njeriut. Presidenti vendas, Peter Mutharika thotë se raportet janë shqetësuese dhe të frikshme.

Izraeli ka ndaluar thirrjen e ezanit me altoparantë në xhami në një fshat të Bregut Perëndimor me arsyetimin se "ka shqetësuar kolonët hebrej"

Izraeli ndalon ezanin në një fshat palestinez



Izraeli ka ndaluar thirrjen e ezanit me altoparantë në xhami në një fshat të Bregut Perëndimor me arsyetimin se "ka shqetësuar kolonët hebrej". Koordinator i Komiteteve të Rezistencës Popullore në jug të He-

bronit, Ratib el-Xhebur, për AA tha se forcat izraelite kanë kryer bastisje në fshatin Et-Tuvani në

rajonin Musafir Jata në jug të Hebronit, duke bërë me dije se është ndaluar të thirret ezani me altopar-

lantë nga xhamia e fshatit. Xhebur tha se ushtarët izraelitë janë kërcënuar me një bastisje të dytë në rast se nuk respektohet ndalesa. Ai shtoi se fshati Et-Tuvani shpesh përballet me provokime të ushtarëve izraelitë dhe kolonëve, për shkak se ndodhet afër vendbanimit kolon hebre Ma'on. Rajoni Musafir Jata bën pjesë në zonën C. Në kuadër të "Marrëveshjes së Dytë të

Oslos" të nënshkruar në vitin 1995 mes të Palestinës dhe qeverisë izraelite, Bregu Perëndimor ishte ndarë në zonat A, B dhe C. Zona A, e cila përfshin 18 për qind të territorit, i ishte alokuar Palestinës në aspektin administrativ dhe atë të sigurisë, zona B, që përfshinte 21 për qind, në aspektin administrativ i ishte alokuar Palestinës kurse në atë të sigurisë

Izraelit, kurse zona C, që përfshin 61 për qind të Bregut Perëndimor, i ishte alokuar Izraelit edhe në aspektin administrativ, edhe atë të sigurisë. Qeveria izraelite e bën pothuajse të pamundshme që palestinezët të bëjnë ndërtime në zonën C. Në Jerusalemin Lindor të okupuar nga Izraeli gjenden rreth 200 mijë kolonë hebrej, kurse në Bregun Perëndimor 400 mijë sosh. Komiteti ndërkombëtar i trajton si ilegale vendbanimet kolone hebreje që gjenden në territoret e okupuara nga Izraeli.



Lufta aktuale valutore nuk është një rrugëdalje nga kriza pas asnjëri. Është ekuivalent me një reaktion bërthamor të pakontrolluar e të pandalshëm që do ta bëjë botën gjithnjë e më shumë jomikpritëse për kë dëshiron të prodhojë, kursejë duke krijuar pasuri e punë

Termi "luftë valutore" është përdorur për herë të parë në 2010 nga Guido Mantega, Ministri i Financave të Brazilit që ka akuzuar Shtetet e Bashkuara se e zhvlerësojnë dollarin nëpërmjet një politike monetare ekspansioniste dhe eksportojnë inflacion në vendet emergjente

Lufta valutore është vazhdimi i proteksionizmit me mjete të tjera. Vendi që ul koeficientin e këmbimit, çmimin e valutës së tij në raport me të tjerat, fiton një avantazh konkurrues të përkohshëm sepse redukton sa hap e mbyll sytë çmimet e prodhimeve të tij dhe ngre atë të vendeve importuese. Është sikur këtyre të fundit t'u vendoset një taksë doganore transversale dhe jodiskriminuese. Karakteristika e një luftime valutore, si në proteksionizmin e vjetër, është zhvlerësimi kompetitiv është bërë një teknikë për të siguruar të ardhurën e vendeve importuese dhe shkarkuar mbi shpatullat e tyre shërbimin e borxheve në rritje. Veç kësaj, pasi me zhvlerësimin shkaktohet inflacioni, zhduket deflacioni dhe reduktohet vlera e borxhit të brendshëm.

Në realitetin e kësaj luftime të ftohtë, nuk është gjë tjetër përveçse një mjet për të shmangur zbatimin e masave jopopullore të rreptësisë financiare, si për shembull shkurtimet e shpenzimeve publike. Dinamika e luftës valutore dhe pasojat e saj mund të kuptohen vetëm duke zbritur në shkaktuesit fillestar të tyre: deficitin këmbëngulës të bilancit tregtar amerikan.

Trilemë

Gjatë periudhës së Bretton woods (1944 deri në 1971) të bazuar mbi gold exchange standard (valuta të konvertueshme në dollarë dhe dollarë të konvertueshëm në ar), zhvlerësimet qenë sporadike pasi bota gëzonte një zhvillim ekonomik të caktuar dhe sistemi i arit, megjithëse i manipuluar, e kufizonte inflacionin monetar që i paraprin zhvlerësimit. Kur në vitin 1971 Shtetet e Bashkuara e shpallën dollarin jo të konvertueshëm duke imponuar dollar standard, filloi era e deficitit të dyfishtë amerikan, atij të bilancit dhe atij tregtar. Deri në atë kohë Shtetet e Bashkuara kishin qenë kreditori dhe eksportuesi më i madh, por situata u përmbyl. Pasi ekonomia botërore zgjerohet dhe pagesat ndërkombëtare kryeshin me dollarë, i të cilëve Amerika ishte emetuesi i vetëm, mënyra e vetme me të cilën pjesa tjetër e botës mund t'i siguronte ato ishte eksportimi drejt saj, duke ruajtur një suficit tregtar ndaj saj. Nga ana tjetër, për të bërë të

Pse ekziston lufta valutore



disponueshëm dollarët, domethënë për të garantuar likuiditetin ndërkombëtar, Shtetet e Bashkuara duhej të eksportonin dollarë drejt pjesës tjetër të botës dhe kjo ishte e mundur me një deficit tregtar permanent. Privilegji i emetimit të valutës globale u mundësoi Shteteve të Bashkuara që të financonin hendekun tregtar thjesht duke prerë valutën, krejt kundër nga pjesa tjetër e botës që, për të importuar, duhej të eksportonte. Që kështu që Shtetet e Bashkuara u bënë importuesi dhe debitori më i madh, ndërsa pjesa tjetër e botës eksportuesi dhe kreditori neto, duke akumuluar një tepri rezervash në dollarë.

Qysh nga fillimet e viteve '60 ekonomisti belg Robert Triffin kishte paralajmëruar kontradiktat implicite në përdorimin e një valute unike rezervë duke formuluar trilemën e famshme. Sipas Triffin, për një vend të pajisur me valutë rezervë ishte e pamundur të plotësoheshin njëkohësisht tri objektiva: sigurimi i likuiditetit botëror, pasja e deficitit tregtar permanent dhe ruajtja e stabilitetit valutor. Në terma më teknikë, trilema është e pamundurë për të kombinuar bashkë një politikë monetare të pavarur, një lëvizje të lirë të kapitaleve dhe një këmbim të qëndrueshëm. Mund të zgjidhen vetëm dy opsione, duke përfshirë të tretën, e papajtueshme me të tjerat. Në fakt, Shtetet e Bashkuara kanë adoptuar dy të parat, duke hequr dorë nga a e treta, stabiliteti i dollarit. Por trilema vlen për të gjithë.

Për shembull, fiksimi i barazisë së koeficientit të këmbimit, që është (PEG), që është instrument politikë monetare, nuk është i pajtueshëm me lirinë e lëvizjes së kapitaleve. Është rasti i Kinës, që për të ruajtur barazinë me dollarin duhet të imponojë në brendësi të saj një kontroll të kapitaleve. Nëse nuk do të bënte flukse dhe deflukse financiare, do të destabilizonte barazinë. Për pasojë, mund të ketë qarkullim të lirë kapitalesh dhe politikë monetare autonome bashkë, ama duke hequr dorë nga kontrolli i këmbimit, i cili duhet të

fluktuojë lirisht. Është rasti i stërlinës angleze. Së fundi, nëse vendoset për qarkullimin e lirë të kapitaleve dhe këmbimin e qëndrueshëm, duhet hequr dorë nga një politikë monetare autonome. Është edhe rasti i vendeve të eurozonës, por është bërë edhe rasti i Zvicrës. Pasi nga 2008 në 2011 franga zvicerane ishte rivlerësuar ndjeshëm ndaj euros, duke vënë në rrezik kompetitivitetin zviceran, Swiss National Bank i është dashur që të impenjohet në shitjen e frangave kundër eurove për të penguar rivlerësimin e frangës. Me fjalë të tjera, është sikur Zvicra të kishte adoptuar euron, duke hequr dorë, në konformitet me trilemën, nga një politikë monetare e pavarur.

Deficiti konstant tregtar amerikan që detyron pjesën tjetër të votës që të akumulojë rezerva në dollarë e tërheq për poshtë platformën valutore botërore. Pjesa tjetër e botës duhet të përshtatet me zbritjen, duke i zhvlerësuar valutat (ose duke penguar vlerësimin) nëpërmjet zgjerimit të bazës monetare. Shkalla e zhvlerësimit të një valute ndaj një tjetre varet nga shpejtësia e krijimit monetar në vendet respektive, si trilema të implikojë një këmbim fluktuant, ashtu edhe një barazi fikse. Për shembull, për të zhvlerësuar sterlinën, është e mjaftueshme që Banka e Anglisë të rrisë ofertën dhe të lërë të fluktuojë këmbimin, që duke u zhvlerësuar nda valutave të tjera, do të mundësojë që të shiten më shumë produkte angleze. Anasjelltas, për t'i bërë produkte zvicerane më shumë joshëse sesa ato europiane është e nevojshme që të fiksohet këmbimi me euron dhe të rritet qarkullimi i frangave me qëllim që më pak euro të blejnë më shumë franga.

Kur Kina rrit eksportin drejt Shteteve të Bashkuara, dollarët që merr do ta rivlerësonin juanin, duke e destabilizuar barazinë me dollarin sikur Banka Qendrore Kineze të mos ndërhynte, duke prodhuar juanë për të bërë blerje të dollarëve. Përmbledhtazi, kur një vend hap rubinetin e valutës së vet, pjesa tjetër e

botës duhet të bëjë të njëjtën gjë, por kjo nënkupton edhe të rritet inflacioni botëror, duke krijuar fluska financiare dhe dizekuilibra tregtarë (global imbalances). Por ka edhe tjetër. Pjesa më e madhe e rezervave në dollarë nuk mbesin të vdekura në arkat e vendeve eksportuese, por kthehen në Shtetet e Bashkuara për t'u investuar sidomos në bono thesari. Prandaj pjesa tjetër e botës duhet ta financojë borxhin e tyre. Sikur të mos ndodhte kjo, dollari do të binte pikatë dhe rezervat e bankave qendrore do të zëroheshin me humbje të jashtëzakonshme. Paradoksalisht, ndërsa të gjithë janë të interesuar statuskuoja ndaj dollarit, nxitojnë që ta zhvlerësojnë. Trilema me të cilën çdo vend konfirmohet krijon në sistemin monetar një rreth vicioz dhe një paqëndrueshmëri eksplozive që e bën çdo investim sporadik dhe të ardhmen gjithnjë e më të paqartë.

Fitimtarë dhe të mundur

Ajo që ka kaluar pa u vënë re është shpronësimi i madh i resurseve që u shkaktuan vendeve eksportuese një valutë jo e qëndrueshme rezervë. Për një kohë të gjatë, pjesa tjetër e botës nuk e ka kuptuar faktin që suficiti që akumulohet ishte proporcional me humbjet që pësonte, pasi arsyet e saj të këmbimit përkeqësoheshin në favor të dollarit. Jo vetëm financonte borxhin amerikan, por ulte vlerën e kreditit të saj ndaj Shteteve të Bashkuara. Japonia ka qenë viktima më e goditur nga ky fenomen. Bartëse e rezervave më të mëdha në dollarë për pothuajse një 30 vjeçar, domethënë midis viteve 1974 e 2000, ka injoruar që mbi 2/3 e vlerës së tyre të shkonte kot prej reduktimit korrespondues të vlerës së dollarit. Fatkeqësisht, Tokio ndoqi qorrazi kurën e mjekëve keynesianë amerikanë të Thesarit dhe të Federal Reserve, që e bindën pacientin se rezervat valutore nuk qenë të nevojshme për të paguar borxhet, nga momenti që mund të bëhej duke ju drejtuar deficitit të bilancit!!! Borxhi i madh që Japonia ka akumuluar gjatë kësaj periudhe dhe shkatërrimi i saj shpjegohen vetëm në këtë mënyrë. Sot vendimi për të zhvlerësuar jenin që sjell një stimul (1.2 trilion në bono) baras me dyfishin e atij amerikan, për një ekonomi që vlen sa 1/3 është ekuivalent me vrasjen e pacientit. Dora dorës që jeni do të zhvlerësohet, investitorët do ta heqin qafe borxhin japonez për të bërë atë të Shteteve të Bashkuara dhe të Europës duke ua forcuar valutat, duke intensifikuar me këtë luftën valu-

tore. Në fakt, me një papunësi në nivele rekord, sigurisht që eurozona nuk do të qëndrojë duarkryq, pasi një euro e fortë do t'i thante të ardhurat nga eksportet, burimi i vetëm i zhvillimit i mbetur.

Sot bartësi më i madh i rezervave në dollarë (3 trilion) është Kina dhe e di mirë sesa i paqëndrueshëm është pozicioni i saj. Por pasi është bërë platforma produktive amerikane dhe një nyje industriale që prodhon mbi 20% të prodhimit botëror, ka krijuar premisat për ta k a n d u a r juan/renminbin si valutë rezervë të konvertueshme. Duke parashikuar krizën valutore, po i diversifikon rezervat e saj, sidomos në ar, i të cilit është bërë edhe prodhuesi më i madh botëror dhe përdorimi i të cilit inkurajohet në vend. Në fund, mund të jetë pikërisht metali i verdhë fituesi i vetëm i kësaj lufte absurde.

Është domethënëse fakti që rezervat botërore të dollarit nga një pik prej 71.5 përqindësh në 2001 kanë zbritur në 62 për qind në 2012. Kjo do të thotë se po bota po shkon drejt një sistemi rezervash të shumëfishta në konkurrencë midis tyre. Dollari kanadez dhe australian janë klasifikuar tashmë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar si valuta rezervë. Por cili do qoftë rendi i ri botëror monetar, do të jetë Kina ajo që do të diktojë kushtet. Marrëveshjet e fundit e shkëmbimeve tregtare të saj me Arabinë Saudite dhe vendet e tjera arabe për disa miliarda juan dhe fakti që midis vendeve të BRICS-it transaksionet nuk bëhen më në dollarë, janë simptomatikë të dekadencës së kartëmonedhës së gjelbër që mund të katandiset në valutë të thjesht lokale. Me pasojën që, nëse Londra ka qenë kryeqyteti financiar i shekullit të XIX-të dhe New York i shekullit të XX-të, Shanghai mund të bëhet ai i shekullit të XXI-të. Por një evolucion i tillë, nëse do të ndodhë, do të duhet kalojë një turbulencë të paparë ndonjëherë në historinë botërore. Lufta aktuale valutore nuk është një rrugëdalje nga kriza pas asnjëri. Është ekuivalent me një reaktion bërthamor të pakontrolluar e të pandalshëm që do ta bëjë botën gjithnjë e më shumë jomikpritëse për kë dëshiron të prodhojë, kursejë duke krijuar pasuri e punë. Në fund sistemi monetar do të shpërthejë sepse pa valuta të qëndrueshme dhe të besueshme ekonomia botërore nuk mund të funksionojë. Gjithsesi, pjesa më e madhe e qeverive vazhdon ta injorojë realitetin. Ama nuk mund t'i injorojë pasojat. (Geopoliticius)



Jeta dhe vepra e tij është madhështore. Vetëm midis viteve 1959 – 1999 bibliografia esenciale mbi Çe Guevarën numëron mbi 400 vepra të botuara në çdo pjesë të botës dhe të përkthyer në dhjetëra gjuhë. Ndërsa unë, si një nga dhjetëra biografët e tij, e klasifikoj Çe Guevarën si “hero të mitologjisë revolucionare” apo si “personifikimi i njeriut të pakorruptueshëm”

Jovan Jano

Edhe pse jam marrë shumë me Çe Guevarën, edhe pse kam shkruar katër libra për të (të parin me bashkautor gazetarin e njohur Dhimitër Shtëmbari), përsëri nuk ndjej të ngopur. Sa herë që ulem të lexoj apo të shkruaj, sytë shkojnë pa dashje në portretin e tij më të dukshëm të bibliotekës sime, dhe dora më shkon në librat e shkruar për të në të gjitha gjuhët e botës, që unë, për fat dhe për “derri-llëkun” tim manjak, i kam me shumicë. Atë që do të thosha në këtë rast, ishte se, nëse do të që një Panteon botëror i rezervuar për njerëzit që kanë lënë gjurmë të thella në luftën për liri e drejtësi sociale, hiri i Çe Guevarës do të që vendosur pikërisht atje, sepse rrallë herë, ndoshta kurrë, një figurë, një emër, janë bërë kaq universale, madje me shpejtësi e me një forcë pasioni marramendës.

Sensi heroik i jetës së Çe Guevarës dhe vënia e saj në dispozicion të njerëzimit më ka frymëzuar që kur isha në shkollën pedagogjike “Petro Nini Luarasi” në Korçë, në vitin 1967, vit kur Çe Guevara u vra në Valle Grande të Bolivisë dhe unë me disa shokë të mi të shkollës dëgjonim radiot e huaja, që jepnin lajmin e vrasjes. Nuk e kuptoj pse në ato vite në Shqipëri propaganda heshti rreth kësaj figure tepër interesante! Ernesto Çe Guevara rritet dhe lartësohet gjithmonë e më shumë në të gjithë botën, duke prezantuar shpresën, shembullin dhe stimulimin në luftën për një shoqëri më të mirë. Të majtët e vërtetë duhet të ndjehen krenarë që shekulli i 20-të fiksoi në historinë e vet një njeri të atillë si Ernesto Çe Guevara.

Jeta dhe vepra e tij është madhështore. Vetëm midis viteve 1959 – 1999 bibliografia esenciale mbi Çe Guevarën numëron mbi 400 vepra të botuara në çdo pjesë të botës dhe të përkthyer në dhjetëra gjuhë. Ndërsa unë, si një nga dhjetëra biografët e tij, e klasifikoj Çe Guevarën si “hero të mitologjisë revolucionare” apo si “personifikimi i njeriut të pakorruptueshëm”.

Si njeri me ide transformuese ngulte këmbë mbi nevojën e fitores shkencore mbi bazën e analizave të fakteve his-

50-vjetori i vrasjes së Çe Guevarës

Vizita sekrete në Shqipëri, apo...



torike, politike, sociale e ekonomike. Si njeri, karakterizohej nga një shpirt i gjerë dhe gjithnjë sillej me etikë. Këmbëngulte për dhënien e shembullit personal, duke e konsideruar këtë si një akt të madh për të tërhequr pas vetes të gjithë të tjerët. Tek ky shembull ai shikonte masën e guximit e të trimërisë për të përballuar dhe shpartalluar armiqtë. Sigurisht, Çe Guevara nuk pati abuzuar kurrë me çka bënte dhe me çka arrinte. Gjithçka e jepte në popull si diçka të natyrshe. Duke mos u shtënë se ishte ai, pa kryheshin veprime revolucionare në dobi të popullit. Megjithatë, në sytë dhe mendjen e shumë njerëzve, ai dukej “një i shenjtë”.

Udhëheqësi legjendar i gueriljeve latino – amerikane nuk kish dashur kurrë të paraqitej si mbartës i komunizmit romantik apo iredal. Ai nuk do të kishte dashur kurrë që figura e tij të mund të shndërrohej qoftë edhe në një ikonë të bukur, me të cilën të mund të zbaviteshin shtypësit, për të cilët ushqente një mëri të jashtëzakonshme. Ai do të kishte dashur të mbeshte, sikur dhe mbeti, thjeshtë një njeri, që iu kushtua vetëm Revolucionit.

Ernesto “Che” Guevara

Djaloshi i pashëm argjentinas, që luftoi kundër padrejtësisë në Guatemalë, Kubë, Kongo, Bolivi etj, i dha shumë energji, shkëlqim e dritë revolucionit, sido që ky i fundit ka çmimin e rëndë të vuajtjeve e të kurajos së jashtëzakonshme. Filozofia e dashurisë për njerëzit e mjeruar e detyroi Çe Guevarën për të luftuar në këto vende, kur dihet që në vitet 60-të

sundonin juntat ushtarake diktatoriale si ajo e Çombes dhe Mobutus, në Kongo; e Barrietos, në Bolivi; e Kastillo Armes, në Guatemalë etj.

Është e famshme për rininë progresiste në botë, kënga revolucionare shumë e dashur dhe shumë popullore e Karlos Pueblos, “Komandanti Çe Guevara”. Të paharruar dhe të famshëm Çe Guevarën e bënë këngët dhe vidioklipet e këngëtares kubaneze, Nathalie Cardonas. Në Itali u vunë në garë 14 autorë këngësh dhe muzikantë të shquar me temën “Çe Guevara”. Për të kanë kënduar Domenico Modugno me këngën “C’era un ragazzo dalla barba nera”; Serxhio Enrigo me këngën “Anch’io ti ricordero”; Loredana Berte me këngën “Il Komandante Çe Guevara” dhe mjaft këngëtarë të tjerë si Xhovanoti, Roberto Massari, Gianni Toti. Po ashtu për të kanë folur publikisht, i kanë kënduar dhe kompozuar këngë mjaft të bukura Xhon Lenon dhe Bob Marley, e kam përkthyer në gjuhën dhe për mjeshtërinë artistike një vjershë e vetme e Çe Guevarës, e titulluar “Plaka Marie”, të cilën e kam përkthyer në gjuhën shqipe nga italishtja. Aty ai me mjeshtëri artistike denoncon padrejtësinë, gënjeshtrenë, hipokrizinë dhe mjerimin. Sot industria e konsumit përfiton shumë nga emri i tij. Figura e personazhit latino-amerikan është shpesh objekt i tezave të provimit në universitetet më të mira në botë. Idealet, që mbronte, kauza e drejtë në favor të të shtypurve dhe vrasja e pabesë, e shndërruan atë në mit, në krye engjëll. Prandaj po-

etët, kompozitorët, kantautorët nga e gjithë bota e kujtojnë me admirim dhe i thurin himne.

Për të shkruar mbi Çe Guevarën kam lexuar mjaft libra në gjuhën ruse, italiane si psh, librin “Kompanjero”, të ish ministrit të Jashtëm të Meksikës, Jorge.G. Kastaneda, të botuar nga Mondadori; libri: “Çe Guevara – Historia dhe Miti”; libri: “Guerilja e Çe-së”, e shkruar nga francezi Regis Debre; “Memorie” të Andrej Gromiko; “Çe Guevara – l’uomo, l’eroe, il mito”, shkruar nga Angelo La Bella; “Çe Guevara – Ditari i Bolivisë” (italisht) e shumë libra e revista të tjera të shkruara në gjuhë të huaja. Po ashtu më kanë ndihmuar shumë kujtimet e personaliteteve të spikatura shqiptare, që e kanë takuar personalisht Çe Guevarën.

Rinia, që po e sheh fare qartë se cili është rëndi i ri botëror, “thërrasin” Çe Guevarën. Prandaj edhe industria spekulon me portretin e tij emblematik që dominon e stamposur në bluza sportive dhe në flamujt e luftës për liri e drejtësi shoqërore, në krahët muskulozë të Tajsonit, të Diego Maradonës, të futbollistit Veron apo në imazhin luftarak të videoklipeve të Madonës apo Nathalie Kardonas, në manifestime politike, në parulla, në reklama, në distiktiva...

Djaloshi i bukur argjentinas, që luftoi kundër padrejtësisë në Guatemalë, në Kubë, në Kongo, në Tanzani, në Bolivi etj, i dha shumë energji e dritë revolucionit, sido që ky i fundit ka çmimin e rëndë të vuajtjeve e të kurajës së jashtëzakonshme. Ernesto Guevara nuk mbeti figurë në ikonë, por ishte vetë ikona, tek e cila vijnë e do

të shkojnë miliona njerëz për t’u çmallur, sepse ai dha gjithçka, për një qel- lim të shenjtë. Personalisht, e pëlqej tej mase Ernesto Guevarën sepse me gjestin e tij dhe me veprimtarinë shumë të sinqertë në favor të kauzës së një shoqërie të së ardhmes, sakrifikoi gjithçka. E pëlqej edhe për faktin se është i veçantë në drejtim të vënies së interesit të shoqërisë mbi atë personal. Sjellja e tij si udhëheqës politik është e pakrahasueshme me egoizmin dhe sjelljen e politikanëve të sotëm, qofshin këta edhe në botë. Guevara dhe politikanët e sotëm janë produkt të shoqërive të ndryshme në faza historike të ndryshme. Mjafton të kujtoj që Guevara rridhte nga një familje e pasur dhe për hir të të varfërve e sakrifikoi pasurinë personale.

Unë gjykoj se përderisa në këtë botë ka varfëri dhe padrejtësi shoqërore, idetë e Çe Guevarës do të jenë prezent. Ndryshe s’ka si shpjgohet që për gjenerata të tjera kjo figurë mbetet e dashur. Dhe mbetet e tillë sepse shohin tek Ernesto Guevara njeriun idealist, që për të mirën e një populli, më saktë të të gjithë popujve, shkriu gjithçka, që kishte më të shtrenjtë, pra, jetën.

Takimi sekret me Mehmet Shehun

Marrëdhëniet diplomatike me vendin e bukur të Karaibeve gjatë viteve ‘60 bënë që midis Shqipërisë dhe Kubës të kishte kontakte për probleme të ndryshme politike, ekonomike, kulturore etj. Në këtë kuadër shumë personalitete të jetës politike dhe kulturore të vendit tonë kanë patur rastin të takohen dhe të këmbëjnë opinione me Çe Guevarën. Të tillë personalitete kanë qenë: Mehmet Shehu, Josif dhe Evelina Pogaçe, Zeqi Agolli, Bilbil Klosi, Kiço Ngjela, Mihal- laq Gjiniqasi, Qemal Myrseli, Labo Abazi, Tiri Çollaku etj. Madje, Pertef Hasanmataj ka takuar edhe të atin e Çe-së, Guevara Lynch.

Gjatë këtyre viteve Çe Guevarën ka bërë edhe një vizitë në Shqipëri, e cila, për arsye të politikës së kohës, është mbajtur sekret. Ai që e ka zbardhur më vonë këtë vizitë dhe sidomos takimin Çe Guevarës me ish-kryeministrin shqiptar të asaj kohe, Mehmet Shehun, ka qenë diplomati Zeqi Agolli.

Jam i pari, që duke i ruajtur anonimatim mbi dhjetë vjet, i kam marrë atij kujtimet mbi Çe Guevarën. Më pas ai është prononcuar edhe me gazetarë të tjerë.

Ja ç’më ka thënë mua Zeqi Agolli për takimin: “Ishte fillimi i vitit 1960. Detyrën e kisha marrë tepër të përcaktuar: ta çoja në takim me kryeministrin shqiptar, Mehmet Shehu. Me aq sa mund të nuhasja unë në atë kohë, por edhe me gjithçka ngjau më vonë, vizita e Çe Guevarës ishte tepër konspirative. Ishte një vizitë, që kryhej, sa për mirësjellje, nga që nuk mund të refuzohej nga pala shqiptare. Ishte një vizite, siç mund ta gjykoj tani, për t’i dhënë mikut kuban një përvojë shqiptare, ndoshta për t’i korrigjuar ndonjë ide rreth mënyrës se si piqen e shpërthejnë natyrshëm revolucionet popullore. Aq konspirativ u mbajt ky takim, sa edhe sot e kësaj dite edhe personalitetet më në zë të ish Partisë Punës e të Shtetit nuk dinë gjë!

Në këtë takim ishim të pranishëm vetëm katër vetë. Mehmet Shehu i tregoi mikut nga perla e Karaibeve, historinë e lavdishme të luftës antifashiste nacional – çlirimtare, rolin udhëheqës të Partisë Komuniste, kontributin e jashtëzakonshëm të Frontit Antifashist Nacional – Çlirimtar në bashkimin e popullit dhe mobilizimin e tij për luftë të armatosur kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve të vendit. Më pas Kryeministri shqiptar u ndal tek roli përcaktues i udhëheqjes së Partisë përmes shembullit konkret të masës së saj.

Në ekspozitë e tij Çe Guevara paraqiti një pasqyrë të shkurtër të asaj, që kishte çuar në përmbysjen e diktatorit Batista dhe në fitoren e revolucionit. Ndërkohë ai shfaqti disa nga pikëpamjet që kishte, lidhur me ndezjen e revolucionit dhe hedhjen e popujve në flaket e luftës për liri dhe drejtësi shoqërore. Çe Guevara, me sa kuptohej, rëndësi i kushtonte, gjatë ekspozitës, rolit përcaktues të revolucionarëve të vendosur dhe profesionistë, me ideale të mëdha, duke parë tek këta të fundit tonë kanë patur rastin të takohen dhe të këmbëjnë opinione me Çe Guevarën. Të tillë personalitete kanë qenë: Mehmet Shehu, Josif dhe Evelina Pogaçe, Zeqi Agolli, Bilbil Klosi, Kiço Ngjela, Mihal- laq Gjiniqasi, Qemal Myrseli, Labo Abazi, Tiri Çollaku etj. Madje, Pertef Hasanmataj ka takuar edhe të atin e Çe-së, Guevara Lynch.

Gjatë këtyre viteve Çe Guevarën ka bërë edhe një vizitë në Shqipëri, e cila, për arsye të politikës së kohës, është mbajtur sekret. Ai që e ka zbardhur më vonë këtë vizitë dhe sidomos takimin Çe Guevarës me ish-kryeministrin shqiptar të asaj kohe, Mehmet Shehun, ka qenë diplomati Zeqi Agolli.

Në fund, Kryeministri shqiptar kishte përgatitur një dhuratë – surprizë. Çe Guevara e mori automatikun e dhuruar, u ul në gjunjë, e puthi armën dhe qetë – qetë, u ngrit në këmbë. Gjithçka u krye me një solemnitet tepër të veçantë.



Recension

Nobelisti Ishiguro dhe jeta si tjetërsim

Romani "Mos më lër të shkoj" (botimet "Pegi", Tiranë 2006), i autorit të sivjetmë nobelist Kazuo Ishiguro, me origjinë japoneze dhe me banim në Londër, është vepër që pasi t'i dilet në fund, ndjen nevojë të fuqishme për ta rilexuar nga e para

Ali ALIU



Dy janë ngasësit vendimtarë: e para, për arsye se, kur arrin në fund rrëfimit, të bëhet më i qartë fillimi, përkatësisht, je fare i sigurt se do ta përjetosh ndryshe atë dhe, për bukurinë e rrallë të rrëfimit. Gjithsesi, fjala është për vepër, përkatësisht fenomen, që nuk i ndodh shpesh lexuesit. Ngjashëm me këtë rast – pata shënuar në margjina, më kujtohet edhe përshtypja pas leximit të romanit "Verbëri" të nobelistit portugez Saramago. Edhe njëri, edhe tjetri kanë ndërjet, gjenialisht, shqetësime universale për mbarë hapësirën dhe kohën njerëzore. Edhe rrëfimi i romanit "Verbëri", edhe ai i romanit "Mos më lër të shkoj", në fakt rrezatojnë si një metaforë planetare, si një ndjenjë pasigurie e përbashkët e botës, për të nesërmen sidomos, për rrezikun që bart babëzia dhe dehja në krahët e shpijkeve moderne... Përballë kësaj përditshmërie galopante, Saramago në veprën e vet gjeniale do të shohë: bota me sy në ballë e megjithatë e verbër që e verbër, dhe Ishiguro, e ndjen se po kjo botë mbetet e ndarë mes atyre që dhurojnë (të mira dhe ëndrra) dhe atyre që gëzojnë dhurata. Në romanin e të parit, njerëzit e verbër kur ndërjegjësohen – nëse ndërjegjësohen ndonjëherë, ndjenja më e fuqishme – mbase e vetmja e para e tyre, është nevoja për të prekur nga afër praninë e tjetrit, mbështetjen e tij, tjetërsimi nga i cili thellohet së bashku me pushtimin shkencor të së panjohurës, së gjithësisë... Rrëfimi i romanit "Mos më lër të shkoj" i shkrimtarit Kazuo Ishiguro mund të përfshihet edhe brenda një të vetme fjali: njerëzit, në sajë të shkencës

çudibërëse, do të kultivojnë njerëz të tjerë për t'ua marrë organet e trupit të tyre të shëndoshë në zëvendësim për të sëmurat... Këta pra janë "dhuruesit fatlumë" që i dhurojnë veshka, zemra, mëlçi botës normale, për të qenë sa më pabrenga dhe e lumtur ajo... E pret vërtet njerëzimin një e nesërme e tillë? Do të mbjellë në epruveta njerëz që nuk dinë nga vijnë, ku janë, pse janë, njerëz që do dinë aq sa kemi vendosur në të dinë? Një e nesërme ku do të ketë vetëm dhurues dhe përfitues të dhuratave?... Sikur të mos ndjeheshin, ashtu në ajër shenjat drejt një bote të tillë, e që mund t'i kapë intuita e shkrimtarit vizionar, mbase as nuk do të artikulohej storie e tillë romanore, përkatësisht nuk do të pëlqehet e përthithej nga lexuesi, që duke mos e pasur të qartë praninë e kësaj prirjeje përreth, të një si mosbesim e frikë të mjegullit, i qartësohet ajo paradjenjë... Arti përgjithësisht, që nga fillimet, qëndron mbi themelet e vetë-identifikimit të lexuesit... Rrëfimi romanor i Ishiguro-s shtrihet dhe pushton si një aromë a muzikë, që është e s'është e pranishme. Ai ka një butësi, qetësi të brendshme dhe lirizëm narrativ të papërsëritshëm. Duke të futur në ambientin e një bote të kapshme dhe të pakapshme njëherësh, përkatësisht në një botë skajshmërisht të tjetërsuar, në shkallë përbindshmërie, zëri më poetik që kam lexuar, nuk ankohet, nuk tregon me gisht dhe nuk akuzon askënd drejtpërdrejt, – as edhe si ironi s'e bën këtë: thjesht vetëm e rrëfen, e shpalos botën tonë dhe atë të atyre, dhuruesve, përmes gojës së njërës nga ata – Ketit të

moshës tridhjetëvjeçare – kufiri i të cilëve është dyzetëvjetshji, të cilin nuk e arrijnë dot shumica, duke mos e përballuar dot dhurimin e tretë, e sidomos më tej. Shumica përfundojnë pas dhuratës së dytë... Keti, personazh dhe narratori, në këtë roman rrëfen vitet e kaluara në një qendër-rezervat, një si biçim shkollë e konvikt, – historinë kryesisht të gjeneratës së vet, e ku nën kujdesin e pedagogëve, duke u rritur, e zbulojnë, shkallë-shkallë botën e vet, përkatësisht misionin për të cilin janë sjellë në këtë botë – atë të dhuruesve... Krijuesi, laboratori i tij, mendja krijuese e botës sonë të përcudnuar, ndërsa nuk ka mundur t'i sajtojë, t'i ngjizë ata pa ëndrra, pa aftësinë për të ëndërruar. Kjo dhunti u lind që me hapat e parë. Krijt çfarë do të mbërrijnë është përfundimi nëpër spitale të specializuara ku shtrohen dhe presin radhën për të dhuruar deri në shuarje. Ëndrrat e dhuruesve e bëjnë në shkallë të magjishme poetik rrëfimin romanor: ata, dhuruesit e imagjinojnë veten misionarë të rëndësishëm në punët e botës sonë, si krijues të mëdhenj drejt përsosmërisë së kësaj bote, të këtij njeriu, por njëherësh të pikëlluar tragjikisht – i nënshtrohen bindshëm misionit të paracaktuar, të prerë nga kjo botë... Disa nga ata, si puna e Ketit, me grupin e vet më të ngushtë, ëndrrat dhe kërshërinë i kanë më të përsosura, më de-përtuese, më qiellore se realiteti... Metafora romanore e Ishiguro-s kështu sikur e ka brenda edhe këtë vizion: mendja jonë, një ditë, mbase do të synojë vetëm përsosjen e botës, jo zhbërjen. Në mesin e pedagogëve të këtyre

nxënësve dhurues, lexuesi do vërejë ndonjë që vuan bashkë me ta, përkatësisht që përpigjet, gjatë bisedave, t'i ndërjegjësojë për fatin e vet, t'i orientojë drejt zotërimit të mundësive, të ëndrrave, të vizioneve të veta, përkatësisht drejt marrjes së fatit të botës, drejt përsosmërisë së saj, meqë ata, nxënësit dhurues, po shfaqnin shenja superioriteti ndaj kultivuesve të tyre: "... Është tjetër gjë të krijosh nxënës si ju, për dhurime. Por një gjeneratë me fëmijë, të krijuar për të zënë vend në shoqëri? Fëmijë që demonstrojnë dukshëm se janë më superiorë se ne të gjithë? Oh, jo. Kjo i trembi njerëzit. Ata u tmerruan nga kjo gjë", u sqaruan nxënësve-dhurues, të dëshpëruar deri në pikëllim të plotë, ku vetëdijesohen për misionin e vet, njëri nga pedagogët. Të shkojë njerëzimi drejt thellimit të tjetërsimit, do të kthehet vallë shkenca në minë që i shpërthen në dorë botës? Ka vërtet shenja të kësaj prirjeje? Shkrimtarë si Ishiguro japin alarm. Po kush e dëgjon këtë zë romanor? Njëri nga dhuruesit, në fund, kërkon të dijë dhe i drejtohet kujdestares: "Ju, pra, zonjë, po na thoni që gjithë gjërat që bëjnë, leksionet, të gjitha ishin për këto arsye që sapo na i përmendët? Nuk ka asgjë më shumë se kaq"? Dhe sqarimin e saj: "Ju duhet ta pranoni që disa herë kështu shkojnë gjërat në këtë botë. Opinione e njerëzve, ndjenjat e tyre, shkojnë njëherë në një drejtim... e pastaj në tjetrin. Ndodhi që ju u rritët në një pikë të caktuar të procesit". Në ç'drejtim shkon ajo në fillim të këtij shekulli? Ky është shqetësimi i parë i madh, që rrezaton nga rrëfimi i romanit "Mos më lër të shkoj". (gsh)

Përkujtohen në Rumani shkrimtarët shqiptarë

Më datën 3 tetor në sallën 'Perpessicius' të Muzeut Kombëtar të letërsisë rumune, në Bukuresht, u organizua një simpoziум me rastin e 70-vjetorit të vdekjes të poetit dhe patriotit Aleksandër Stavre Drenova (Asdreni) (1947-2017)



In Memoriam Asdreni-70 de ani de la moartea poetului albanez

In program: • Rada Străvoană, președintele ALAR, Curator de discursuri • Marius Dobrescu, scriitor: Asdreni - viața și opera poetului albanez • Luan Topciu, scriitor: Asdreni, în contextul literaturii albanese din România • Ermir Nika, scriitor: Albanian: Creative Art Asdreni, poem (text original) • Muzica muzicilor-artisti albanesi: Interpretarea Filarmoniei Naționale (text) și Daniel Bortolanu (chitară) • Secretariat și difuzare pe marginea celor prezentate

Muzeul Național al Literaturii Române (Strada Nicolae Ceaușescu 1), 3 noiembrie 2017 ORA 16:00

Përkujtimi dhe nderimi ndaj figurave të shquara të Rilindjes Kombëtare dhe në veçanti të përfaqësuesve më të spikatur të letërsisë shqipe, përbën tashmë një traditë të vyer në jetën kulturore të komunitetit të shqiptarëve të Rumanisë. Kjo plejadë e papërsëritshme e përbërë nga intelektualë e a(r)tdhetarë të mirënjohur, të cilët, jetuan e punuan për Shqipërinë, duke zgjeruar dhe forcuar lidhjet e saj me vendet evropiane, si Naum Veqilharxhi, Mitrush Kuteli, Gjergj Bubani, Lasgush Poradeci, Aleksandër Stavre Drenova etj., kanë qenë dhe mbeten promotorë të pasurimit dhe modernizimit të kulturës së shkuar shqipe dhe integritetit të saj, në kapërcyell të dy shekujve dhe epokave të rëndësishme historike për vendin tonë. Vlerësimi i vazhdueshëm për këto personalitete epokale të letërsisë dhe mendimit shqiptar mbetet në epiqendrën e veprimtarisë së Shoqatës "Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë". Në këtë frymë që mbizotëron prej vitesh në këtë vend, më datën 3 tetor në sallën 'Perpessicius' të Muzeut Kombëtar të letërsisë rumune, në Bukuresht, u organizua një simpoziум me rastin e 70-vjetorit të vdekjes të poetit dhe patriotit Aleksandër Stavre Drenova (Asdreni) (1947-2017). Veprimtaria u organizua nga shoqata "Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë" dhe Muzeu Kombëtar i Letërsisë Rumune. Aktiviteti u përshëndet nga kryetari i ALAR, dr. Radu Cosmin Savulescu, i cili theksoi përpos të tjerash se, viti 2017 është viti i plot përvjetorëve të personaliteteve të shquar, që aktivitetin e tyre e kanë të lidhur me Rumaninë. "Mbushen 70 vjet nga vdekja e Asdrenit, 30-vjetori i ndarjes nga jeta të Lasgush Poradecit, 50-vjetori i ndarjes nga jeta të Mitrush Kutelit si dhe 220-vjetori i lindjes së Naum Veqilharxhit. Ky simpoziум shkencor i sotëm është një gjest homazhi për të gjithë këto personalitete, që kanë kontribuar për zhvillimin e kulturës kombëtare shqiptare, për emancipimin e popullit shqiptar, për zhvillimin e letërsisë shqipe, por edhe për forcimin e urave të miqësisë midis popullit shqiptar dhe atij rumun. Në kumtesën e tij, shkrimtari dhe albanologu i shquar, Marius Dobrescu, foli për jetën e poetit, shortin e tij tragjik, për veprën poetike me theks të fortë patriotik, por edhe për poezinë meditative dhe atë të natyrës.

"Asdreni ka zënë vend në historinë e letërsisë shqipe, por edhe të historisë së Shqipërisë, sepse është ai që ka shkruar tekstin e Himnit Kombëtar Shqiptar, me muzikën e kompozitorit rumun, Ciprian Porumbescu. Përpos argumenteve shkencore, Dobrescu solli edhe një fakt më pak të njohur për publikun: "Në vitet 1970, Ceausescu i kërkoi Shqipërisë që të heqë dorë nga himni i saj të kompozuar nga Porumbescu, duke dashur ta përdorë atë si himnin e Rumanisë, por shqiptarët e refuzuan. Himni i Shqipërisë përdoret pa ndërprerje prej 105 vjetësh!". Studiuesi dhe kritiku letrar, dr. Luan Topciu, në kumtesën e tij foli për vendin e Asdrenit në letrat shqipe dhe për marrëdhëniet e poezisë së Asdrenit me poezinë rumune. Sipas dr. Luan Topciu, me Asdrenin fillon periudha moderne e poezisë shqiptare dhe gjen vazhdimin e saj në vjershat e Lasgush Poradecit. Asdreni mund të konsiderohet si një udhëçelës drejt letërsisë moderne dhe si një hallkë e rëndësishme në evolucionin e etapave të domosdoshme të zhvillimit të letërsisë. Gjithashtu, si njohës i dy letërsive, ai trajtoi edhe problemin e ndikimit të mundshme të poetit nga poezia rumune, në tematikë, në fjalorin poetik, në përdorimin e skemave të reja kuptimore të fjalëve, në teknikat poetike, në frymën e saj etj. I ftuar nga Tirana, shkrimtari dhe studiuesi dr. Ermir Nika, në kumtesën e tij theksoi rolin e krijimtarisë letrare të Asdrenit si urë lidhëse mes dy kulturash, shqiptare dhe rumune. Ai vë theksin në lidhjet e brendshme të letërsisë shqipe me folklorin e jugut të Shqipërisë, me poezinë e Naim Frashërit dhe veçanërisht me atë të Çajupit. Në trajtesën e tij dr. Ermir Nika theksoi edhe pasurimin në pikëpamje të formës, të vargëzimit, të metrikës, të formave të shprehjes, cilësi që do të ndihmonin në modernizimin e poezisë shqipe. Në fund të simpoziумit, për të pranishmit u luajtën pjesë me kitarë klasike nga Daniel Bertesteanu dhe u kënduan disa pjesë të mirënjohura nga muzika lirike shqiptare nga Florentina Barbu, të cilët morën vlerësimin dhe duartrokitjet e publikut pjesëmarrës.



UEFA ka zyrtarizuar formatin përfundimtar të Ligës së Kombeve, me Shqipërinë që do të jetë e pozicionuar në Divizionin C. Mbyllja e kualifikueseve, Konfederata Evropiane e Futbollit konfirmoi pozicionimin e skuadrave për turneun më të ri që do të startojë në vitin 2018

Liga e Kombeve

Shqipëria në Divizionin C, Maqedonia në Divizionin D

Në bazë të koeficientit, Shqipëria e sheh veten në Divizionin C, aty ku në shortin e 24 Janarit të ardhshëm në Luzanë do të jetë në vazon e dytë. Kjo bën që të evitohen sfidat e nxehta me Greqinë dhe Serbinë, ndërsa evitohet edhe përballja me Norvegjinë. Sa i takon skuadrave që cilësohen koka-serie, rivalët e mundshëm në vazon e parë janë Hungaria, Rumania, Skocia dhe Sllovenia. Nga rivalët më të dobët në letër, kuqezinjët mund të përballen me Malin e Zi, Izraelin, Bullgarinë dhe Finlandën në vazon e tretë, ndërsa në vazon e katërt pozicionohen Qipro, Estoni dhe Lituania.

Në bazë të shortit, ekipet do të ndahen në një grup me tre skuadra dhe tre grupe me nga katër. Katër fituesit e grupeve do të fitojnë të drejtën të ngjiten në Divizionin B në edicionin e vitit 2020, ndërsa katër ekipet e vendeve të fundit zbrisin në Divizionin D.

Skema e turneut të ri parashikon gjithashtu që në rast se katër skuadrat fituese të grupeve nuk arrijnë të sigurojnë një vend në Evropianin 2020 nëpërmjet kualifikueseve, ato do të luajnë shansin në ndeshjet "play-off" ku në lojë është një "biletë" drejt evenimentit.



LIGA E KOMBEVE

DIVIZIONI A

Vazo 1
Gjermani
Portugali
Belgjikë
Spanjë
Vazo 2
Francë
Angli
Zvicër
Itali
Vazo 3
Poloni

DIVIZIONI B

Vazo 1
Austri
Uells
Rusi
Sllovakia
Vazo 2
Suedi
Ukrainë

DIVIZIONI C

Vazo 1
Hungari
Rumani

DIVIZIONI D

Vazo 1
Azerbajxhan
MAQEDONI
Bjellorusi
Gjeorgji
Vazo 2
Armeni
Letoni

DIVIZIONI E

Vazo 1
Islandë
Kroaci
Holandë

DIVIZIONI F

Vazo 1
Rep. Irlandës
Bosnje
Hercegovinë
Vazo 3
Irlandë e Veriut
Danimarkë
Republika Çeke
Turqi

DIVIZIONI G

Vazo 1
Skoci
Slloveni
Vazo 2
Greqi
Serbi
SHQIPËRI
Norvegji
Vazo 3
Mali i Zi
Izrael
Bullgari
Finlandë
Vazo 4

DIVIZIONI H

Vazo 1
Qipro
Estoni
Lituani

DIVIZIONI I

Vazo 1
Ishujt Faroe
Luksemburg
Vazo 3
Kazakistan
Moldavi
Lihtenshtejn
Malta
Vazo 4
Andorrë
KOSOVA
San Marino
Gjibraltar

vazon e dytë përkrah Francës, Anglisë dhe Zvicrës, ndërsa befasia e momenteve të fundit ishte ngjitja e Holandës, që i rrëmbeu vendin Uellsit në vazon e tretë të divizionit elitari. Spektakli do të jetë i garantuar me përballje të mëdha në katër grupe me nga tre skuadra, ndërsa fitueset e secilit grup do të luajnë për të fituar trofeun e Ligës së Kombeve me finalen që do të zhvillohet në Qershor të vitit 2019.

Mjaft interesant do të jetë edhe Divizioni B, në të cilin luajnë skuadra meshesh si Austria, Uells, Suedia apo Ukraina, Bosnja, Danimarka e Turqia. Edhe në Divizionet A dhe B, fitueset e grupeve që nuk do të arrijnë të sigurojnë kualifikimin në Euro 2020 do të kenë shansin të sigurojnë një vend në fazën finale të turneut.

Sipas kalendarit të UEFA-s, ndeshjet e javës së parë në grupe luhen nga data 6 deri më 8 Shtator 2018, ndërsa sfidat do të mbyllën në harkun e tre muajve, me ndeshjet e javës së gjashtë që do të luhen nga data 18 deri më 20 Nëntor 2018. Grupet

me nga tre skuadra do të luajnë vetëm 4 nga gjashtë datat e përcaktuara. Sa i takon Kosovës, ecuria larg prishmëri ka bërë që përfaqësuesja më e re në botë në kualifikueset e Botërorit, ku morën vetëm një pikë, është shoqëruar me pozicionimin

në vazon e fundit të Divizionit D. Kosova lë mbrapa vetëm San Marinson dhe Gjibraltarin, ndërsa kundërshtarët më të rrezikshëm me të cilët mund të përballen do të jenë Azerbajxhani, Maqedonia, Bjellorusia dhe Gjeorgjia në vazon e parë dhe

Armeni e Letonia në vazon e dytë. Derisa ekipet më të mëdha evropiane, në Divizionin A të Ligës së Kombeve, 12 skuadra janë ndarë në tre vazo, ku Gjermania, Portugalia, Belgjika dhe Spanja janë koka-serie. Italia pozicionohet në



Aliji stërvitet me Bazelin deri në gjetjen e klubit të ri

Ish-mbrojtësi i kombëtares shqiptare, Naser Aliji, është në pritje të një skuadre të re, pas ndarjes me klubin gjerman të Kaizerlautern, që garon në Bundesliga 2. Dhe, deri sa të marrë vendimin për të ardhmen e tij, ai ka vendosur të stërvitet me skuadrën e Bazelit, kampionit të Zvicrës, e cila ia ka hapur dyert futbollistit të dikurshëm të vet. Një gjest për t'u përshëndetur nga drejtuesit e gjigantit zviceran, që i ka dalë në ndihmë 23-vjeçarit. Aliji ka dy javë që është duke u ushtruar te Bazeli në mënyrë që të mbajë formën e tij për të qenë i gatshëm për ekipin me të cilin do të vazhdojë karrierën. Ka mjaft spekulime rreth skuadrës së tij të re, por ende nuk ka asgjë zyrtare. Karriera e tij ka nisur te Baden, pastaj Arau, Bazel, Vaduz dhe së fundmi Kaizerlautern, me të cilin e prishi marrëveshjen. Nga viti 2015 është pjesë e kombëtares shqiptare, me të cilën luajti në "Euro 2016".

Shumë kandidat për postin e seleksionuesit të Kosovës

Asgjë nuk dihet deri në vendimin final të Federatës së Futbollit të Kosovës, e cila fshehurazi e në heshtje po kontakton me trajnerë! Kush do të jetë pasardhës i përzgjedhësit Albert Bunjaki, i cili u largua me ndeshjen e fundit me Islandën, ku pësuan me rezultat 2:0. Ka zëra që thonë se Bylbyl Sokoli do të emërohet përzgjedhës i ri i kombëtares së Kosovës, sepse nuk do ta ketë koston sikurse një trajner nga jashtë. Lakohen



edhe disa emra si ai i ish futbollistit dhe përzgjedhësit të Sllovenisë, Sreçko Katanec, por ky mund të jetë shumë i shtrenjtë. Gjasat janë edhe Fatih Ter-

im, i cili mundet të sakrifikojë për hir të Kosovës edhe me një çmim më të lirë. Të gjitha janë spekulimet deri me tash në opinion. Por a do të jetë në kombinim edhe Ardian Kozniku e Besnik Hasi? Askush nuk e di, një dihet se FFK ka një xhoker, por cili do të jetë së shpejti do të dalë nga zari! Nëse emërohet Sokoli, ai po rikthehet pas 20 vjetësh në postin e përzgjedhësit.

Milevski: Kërkoj falje, përgjegjës për humbjen jam unë




Shkup, 11 tetor - Seleksionuesi I përfaqësueses së

Maqedonisë deri 21-vjeç, Bllagoja Milevski, pas disfatës së turpshme nga Gjibraltari, ka theksuar se përgjegjësia për rezultatin e ndeshjes kundër Gjibraltarit është e tij. Ai i ka kërkuar falje opinionit sportdashës pas disfatës së papritur për KE në Itali. "S'ka arsytim, është një disfatë e turpshme dhe përgjegjësia e marr unë. Thjeshtë më vjen keq dhe i

kërkoj falje opinionit sportdashës dhe tifozëve, deri te Federata e cila na i siguroi kërkesat që i kërkuam për punë. Me kombëtaren kam përjetuar momentet më të bukura të karrierës sime dhe pas kësaj disfate, edhe ato më të vështirat. Do të përsëris, nuk kërkoj arsytim, as në mungesën e Elif Elmas, e as për rastet të cilat nuk i shfrytëzuam.

Thjeshtë me ose pa Elmas, ne duhej të gjejmë mënyrë të fitojmë kundërshtarin. Unë jam ai i cili e bën formacionin dhe përgjegjësia është e imja. Shpresoj se do të vazhdojmë të jemi përgjegjës si në duelet me Malin e Zi dhe Armeninë dhe nuk do të nënçmojmë, por as veten", deklaroi Bllagoja Milevski për faqen zyrtare të FFM-së. (B.K.)



Në fakt 22-vjeçari nga Kanberra u mund 7-5 në taj-brej, nga tenisti nga Shtetet e Bashkuara, në një set ku Kyrgios u paralajmërua pasi flaku me forcë jashtë fushe dy topa, në shenjë proteste për shkak të një vendimi të gjyqtarëve të vijës, që shkoi kundër tij

Kyrgios tërhiqet nga Mastersi i Shangait

Nik Kyrgios humbet setin e parë në taj-brej dhe lë përgjysmë ndeshjen, duke u tërhequr përfundimisht nga Mastersi i Shangait. Tenisti problematik australian u fishkëllye nga publiku, pas kërcënimeve të vazhdueshme se do të tërhiqet nga takimi me Stiv Xhonson nëse do të humbte lojën përcaktuese të setit hapës në taj-brej. Në fakt 22-vjeçari nga Kanberra u mund 7-5 në taj-brej, nga tenisti nga Shtetet e Bashkuara, në një set ku Kyrgios u paralajmërua pasi flaku me forcë jashtë fushe dy topa, në shenjë proteste për shkak të një vendimi të gjyqtarëve të vijës, që shkoi kundër tij. Më herët tenisti me origjinë greke u penalizua me heqjen e një pike, për shkak të përdorimit të një fjalori të turpshëm, për më tepër me zë të lartë, në një takim të vlefshëm për turin e parë të turneut të parafundit Masters të sezonit, ku Kyrgios mbante numrin 13 të këtij aktiviteti.

Numri 21 i botës në klasifikimin e përgjithshëm ATP u dëgjua qartë të kërcënojë se do ta linte përgjysmë takimin nëse do të humbte taj-brej- un dhe në fakt menjëherë pasi



Stiv Xhonson e mbylli pikën me as, duke shfrytëzuar më së miri të parën mundësi për setin, tenisti australian shtrëngoi dorën me 27-vjeçarin kalifornian duke u tërhequr përfundimisht. Gjyqtari kryesor Fergus Murfi e pyeti Kyrgiosin nëse kishte nevojë për ndonjë pushim për t'u mjekuar, por 22-vjeçari la fushën mes vërshëllimave dhe zhurmës së krijuar nga spektatorët. Ky incident u regjistrua vetëm dy ditë pasi tenisti nga Kanberra toleroi hapur në finalen e turneut të Pekinit, ndeshje ku Rafael Nadal përfitoi duke fituar 6-2, 6-1 pas nervozizmit të thek-

suar të tenistit australian në lidhje me vendimin e gabuar të gjyqtarëve, për një pikë që në fakt do t'i jepte menjëherë avantazhin e një gejm me brejk, që në start, ndaj numrit 1 të botës.

Edhe vitin e kaluar në Shanghai Kyrgios u gjobit me plot 25.000 dollarë, për shkak të polemikave të vazhdueshme me gjyqtarin kryesor si dhe një spektator, në takimin me gjermanin Misha Zverev, dënim që përfshinte gjithashtu edhe mungesën e impenjimit, gjë që më pas u shoqërua edhe me një pezullim shembullor prej plot tetë javësh nga të gjitha aktivitetet ATP. Mbetet për t'u parë vendimi që do të marrin drejtuesit më të lartë të botës së tenisit kundrejt tij, sidomos Nick Kyrgios pas tërheqjes nga dueli me amerikanin Stiv Xhonson u justifikua, duke shpjeguar se ishte i shtrënguar për të lënë ndeshjen përgjysmë pasi kishte pasur probleme në stomak dhe kishte ndjerë gjithashtu dhimbje në shpatull që gjatë fazës përgatitore rutinë, që tenistët zhvillojnë përpara se të fillojnë takimin.



Vinales: Në Motegi për fitore

Pas një pushimi të gjatë rikthehet këtë fundjavë Botërori i Moto GP, me pilotin spanjoll Maverik Vinales që shpreson të hyjë në garë për titullin kampion. Piloti i Jamaha ka 28 pikë disavantazh karshi patriotit të tij me Honda, Mark Marquez, ndaj për Vinales fitorja mbetet alternativa e vetme për të ngushtuar diferencën. "Nis një tur i vështirë, me tri gara radhazi. Nuk ka për të qenë e lehtë për askënd, ndaj duhet kujdes në këto tri gara, për të grumbulluar sa më shumë pikë dhe për të qenë gjithnjë mes më të mirëve", u shpreh Maverik Vinales. Spanjoli zhvillon sezonin e tij të parë me Jamaha dhe kërkon të befasojë, duke fituar titullin kampion. "Jam ende në garë për titull dhe nëse kam pak fat mund t'ia dal mbanë. Çdo gjë është e hapur deri në fund, duhet të besojmë dhe të japim maksimumin në pistë në çdo garë. Por do t'i marrim garat një e nga një, duke nisur nga ajo e Motegi, që duam ta fitojmë edhe pse rivaliteti do të jetë i madh. Besoj se Jamaha do të më servirë një motor të mirë, që të dueloj për fitoren", deklaroi sot nga Japonia piloti spanjoll Maverik Vinales, që ndodhet i treti në renditjen e Moto GP.

Publicitet

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor

MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Projekt A - leje të integruar ekologjike për Shoqatën për prodhimin e akumulatorëve TAB MAK DOO Probishtip

Në përputhje me nenin 95 pika 1 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor është dorëzuar kërkesë nr. UP1 - 11/3 578/2017 nga 21.04. 2017 për marrjen e A - lejes të integruar ekologjike.

Dorëzues i kërkesës: Shoqata për prodhimin e akumulatorëve TAB MAK DOO Probishtip rr."Revolucionerët e Maqedonisë" nr. 50, 2210 Probishtip, Republika e Maqedonisë

Koordinatat e lokacionit sipas sistemit nacional koordinativ:
464818 N 598463 E

Personi për kontakt: Jasmina Veličkova Boshevska, Menaxhues i njësishë për ekologji e-mail: jasmina.velichkovska@tab-mak.mk

Kategoria e instalacionit: aktivite nga Shtojca 1

Pika 2.5 (a) Instalacione për prodhimin e metaleve me ngjyrë nga xehet, koncentratet ose lëndët e para sekondare me procese metalurgjike kimike ose elektrolitike.

2.5 (b) Instalacione për shkrirjen e metaleve duke i përfshirë edhe legurimin e metaleve me ngjyrë, duke i përfshirë edhe prodhimet përsëri të fituara nga (rafinimi, derdhja e tj.) me kapacitet të shkrirjes të mbi 4 t/ ditë të plumbit dhe kadmiumit ose mbi 20 t/ ditë për të gjithë metalet e tjerë dhe e njëjta gjendet në Probishtip.

Lloji i aktivitetit:

Prodhimi i plumbit të rafinuar 24.000 (t / vit) dhe prodhimit të akumulatorëve për të gjitha llojet e automjeteve 2.250.000 copë dhe bateritë tërheqëse 1.460.000 copë në vit.

Projekt A- Leja do jetë e shpallur , në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moep.gov.mk

Informacione në lidhje me Projekt A-Lejen, të interesuarit do të mundet të marrin në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në tel: 078426016 (e-mail s.vaileski@moep.gov.mk)

Të interesuarit, në **afat prej 14 ditëve** nga dita e shpalljes në mjetet e informimit, do të mundet ti dërgojnë vërejtjet e tyre në lidhje me Projekt A-Lejen, në formë të shkruar, deri te Ministria e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në këtë adresë: Bulevardi "Goce Delçev" nr. 18 (ndërtesa e MTV kati 10), 1000 Shkup.

Serena rikthehet në "Australian Open"

Serena Uilliams do të rikthehet në fushë në grand slemn e 'Australian Open' (25-28 janar 2018), gati një vit nga sfida e saj e fundit, pikërisht në finalen e fituar në Melburn. Lajmin e ka konfirmuar sot për mediat kraid Tiley, drejtori i grand slemnit australian, që tha se ka marrë "OK" nga tenistja amerikane, që në gusht të këtij viti u bë nënë. "Serena do të rikthehet te ne në janar dhe do të luajë në Melburn për të fituar titullin e fituar këtë vit. Po stërvitet rregullisht edhe pse ka ende disa muaj deri sa të nisë turneu. Do të jetë vetë ajo që do të na thotë nëse do të jetë gati apo jo", tha Tiley. Tashmë në moshën 36-vjeçare, tenistja amerikane nuk luan që prej finales së "Australian Open"- 2017, kur mundi në finale motrën e saj Venus. Por prej disa javësh ajo ka nisur të stërvitet dhe ka konfirmuar se synon të mbrojë



titullin në Melburn. "Dua të luaj në Australi, në janar. E di që mund të duket pak e çuditshme dhe ndoshta e tepruar, por do të bëj maksimumin për t'ia dalë mbanë", pat thënë vetë Serena Uilliams pak kohë më parë. Nuk dihet nëse tenistja amerikane do të luajë direkt në turneun e 'Australian Open' apo do të marrë pjesë në ndonjë turne përgatitor.

Lojërat Olimpike "Tokio 2020"

Vetëvritet punëtori si pasojë e punës stresuese



Një punëtor në Japoni ka vrrarë veten si pasojë e punës stresuese dhe orëve të tepërta që kalonte duke punuar në stadiumin e ri olimpik, ku do të zhvillohen Lojërat Olimpike

"Tokio 2020". Bëhet fjalë për një 23-vjeçar, i cili është gjetur në një zonë në periferi të Tokios. Në letrën që kishte lënë ai rrëfente se "jam fizikisht dhe psikologjikisht i dërrmuar,

pasi jem detyruar të shkoj në limitet e humanizmit, ndaj dhe po vras veten". Një ngjarje që ka tronditur pa masë ambientin, pasi mësohet se personi në fjalë kishte akumuluar 190 orë ekstra punë mbi normën gjatë shtatorit, ndërsa një muaj më parë kishte 160 orë ekstra pune. Në stadiumin e ri olimpik aktualisht punojnë rreth 1000 punëtorë dhe organizatorët po përpiqen t'u krijojnë kushte sa më të mira pune. Tashmë pritet që firma për të cilën ai punonte të pagua një edhe një gjobë të majme në adresë të familjes së punëtorit.



Barcelona është ende në kontakt me Kutinjo dhe e di se lojtari nuk mund të luajë me ekip tjetër në Çampions, këtë sezon. Trajneri Ernesto Valverde dëshiron ta ketë atë për të forcuar ekipin në La Liga dhe "Copa del Rey"

Filippe Kutinjo (25 vjeç) ka një as nën mëngë për të kryer nënshkrimin e tij të hershëm me Barcelonën më shpejt se sa më vonë. Në fakt, futbollisti brazilian shpreson ta përdorë atë në merkaton e ardhshme të dimrit, domethënë nga 1 janari i vitit 2018. Ky angazhim ishte arsyeja pse Kutinjo e kundërshtoi Ligën e Kampionëve me Liverpool, në kthimin e grupit të kuq në garën maksimale evropiane. Lojtari ishte i gatshëm të deklaronte veten në rebelim pasi nuk fitoi nënshkrimin e tij me Barcelonën dhe nuk luajti më me "reds". Megjithatë, pas ditëve të dialogut mes vetes dhe agentëve të tij me udhëheqjen e Liverpool, të dyja palët ranë dakord për një zgjidhje afatshkurtër për lehtësi, që gjërat të mos shkojnë keq. Ky angazhim ishte që ndërkombejtari brazilian të mos refuzonte të luante

Kutinjo ka marrëveshje që të largohet në janar



me ekipin e udhëhequr nga Jurgen Klopp, aq më pak në Ligën e Kampionëve, vitrinë e madhe. Në këmbim, drejtuesit e Liverpool i premtuan Kutinjo s se në janar do të ishin në gjendje ta bënin dalje në klub. Natyrisht,

për sa kohë që oferta e klubit azulgrana ishte në kulmin e cilësisë për talentin brazilian. Barcelona është ende në kontakt me Kutinjo dhe e di se lojtari nuk mund të luajë me ekip tjetër në Çampions, këtë sezon.

Trajneri Ernesto Valverde dëshiron ta ketë atë për të forcuar ekipin në La Liga dhe "Copa del Rey". Synimi i Barcelonës për të shkuar te Kutinjo në merkaton e dimrit është i fortë dhe i përgjigjet një pozicionimi strategjik. Edhe pse lojtari nuk flet me PSZH, është e qartë se klubi francez mund të jetë një armik i katalanasve në merkaton e verës, në vitin 2018. Megjithatë, kur merkatoja e janarit të vitit të ardhshëm të hapet, PSG nuk mund të veprojë, sepse ekziston rreziku nga "fair-play financiar". Dhe francezët janë paralajmëruar nga UEFA. Por në verë do të ishte diçka tjetër. Kjo është arsyeja pse Barcelona dëshiron të sigurojë operacionin në janar, një merkato në të cilën klubet lëvizin më pak.

Shkurt

Uilsher mendon largimin nga Arsenali

Xhek Uilsher raportohet se është duke menduar largimin nga Arsenali gjatë afatit kalimtar të janarit. Mesfushori gjatë viteve të fundit është përballur me një seri lëndimesh derisa mungoi në parasezon shkaku i rikuperimit nga thyerja e këmbës. Uilsher sivejt ka bërë tre paraqitje për Arsenalin, por asnjëherë nuk e ka luajtur në Premier Ligë. Sipas "The Times", mesfushori është duke menduar seriozisht largimin nga Arsenali për të luftuar për një vend në përfaqësuesen e Anglisë në Botërorin "Rusia 2018".

Milani kërkon lojtarin me vlerë 500 mln euro

Milani kërkon Dani Keballos, talenti i ri spanjoll, i transferuar këtë verë të Real Madrid. Lojtari nuk o gjen shumë hapësira te skuadra e Zidan. Nuk ka asgjë për t'u çuditur, por 111 minutat e grumbulluara deri tani në gjashtë ndeshje nuk mund ta bëjnë të ndihet mirë 21-vjeçar. Kështu, sipas "Sport.es", kuqezinjët janë gati të hidhen në sulm për futbollistin, gjithmonë nëse do të krijoheshin kushtet e duhura. Gjithsesi, Real Madrid duket se nuk ka ndërmend të heqë dorë nga Keballos. Drejtuesit madrilen e konsiderojnë si të ardhmen e ekipit dhe kjo tregohet nga klauzola 500 milionë euro në kontratën e tij.

Ozil në udhëkryq

Mesut Ozil në fund të sezonit do të jetë lojtar i lirë, pasi i skadon kontrata me skuadrën e Arsenalit. Bisedimet mes Arsenalit dhe Ozilit ishin ndërpreur në muajin shkurt, por deri më tani ende nuk ka nisur negociatat për kontratën e re. Sipas tabloidit britanik, "The Sun", Ozil pëlqehet nga Barcelona, Interi, Mançester Junajted dhe Real Madrid. Por, asnjëra nga këto ekepe nuk është e gatshme t'ia paguaj pagën Ozilit, i cili te Arsenalit paguhet 330 mijë funte në javë (ose 368 mijë euro). Mbetet të shihet se cila do të jetë e ardhmja e Mesut Ozilit

Reali ofron tre yje për Kinin

Sipas "Diario Gol", Real Madridi e ka marrë seriozisht transferimin e sulmuesit anglez, Harry Kin nga Tottenhami. "Diario Gol" shkruan se Los Blancos janë të gatshëm t'i sakrifkohen tre yje për Kinin. Thuhet se Reali do t'i ofroj Tottenhamit yjet si: Geret Bejll, Luka Modriç dhe Karim Benzema për Kinin. Më herët është raportuar se kampioni i Spanjës dhe Evropës është i gatshëm t'i ofroj Tottenhamit 2000 milionë euro për sulmuesin anglez. Mbetet të shihet gjatë verës së ardhshme se çka do të ofroj Real Madridi për Kinin.

Barcelona cakton çmimin e Deulofeut

Gerard Deulofeut mund të largohet nga Barcelona në afatin kalimtar të janarit. Sipas të përditshmes sportive katalane, "Mundo Deportivo", Barcelona ka vendosur një çmim fillestar prej 20 milionë euro për Deulofeut. Barcelona gjatë kësaj vere kishte shfrytëzuar të drejtën për riblerjen e Deulofeut nga Evertoni për 12 milionë euro. Skuadra e Milanit është e interesuar që ta transferoj spanjollin, i cili në sezonin e kaluar luajti 6 muaj me sukses te Rossonerët.

Te Dortmundi pranojnë

Moukoko mund të mos jetë 12-vjeçar

Në performancën e tij ka vetëm një arsye për dyshime: sulmuesi i Dortmundit, Jousoufa Moukoko që po thuhet se është 12-vjeçar, po shënon gola ndaj 17-vjeçarëve pa fund, kështu që po dyshohet nëse moshja e tij e deklaruar, është e vërtetë. Me gola e tij, ai nuk po i bën vetes shumë nder. Moukoko 12-vjeçar në B-Junioren-Bundesliga, pra në ligën për 16-17 vjeçarë, po shënon

gola pa fund. Në shtatë ndeshje ka shënuar tashmë 17 gola. Që nga fillimi i serisë së tij të golave është spekuluar nëse Moukoko vërtet është 12-vjeçar. Një test të moshës duke matur ashtin e dorës, siç ka kërkuar FIFA për çdo lojtar në Botërorin U-17, Dortmundi e ka refuzuar, ndërsa ka refuzuar edhe babai i futbollistit, Josephi. Babai kishte insistuar se Jousoufa është 12-vjeçar...



Lamtumirë Çells

Vera e ardhshme do ta gjejë Antonio Konte në bankinën e ekipit kombëtar të Italisë. Sipas shtypit britanik, pritet një divorc mes teknikut italian te Çells me klubin në fund të sezonit. Sikurse shkruan "Sun", nuk kanë munguar ofertat për Konten, por një fakt tashme po qartësohet se ai pritet që të rikthehet te ekipi kombëtar, të cilin e ka stërvitur pas drejtimit të Juventusit. Kontrata e teknikut te seleksionit, Giampiero Ventura, skadon në 2020, por një paraqitje e dobët në Rusi do ta çonte Federatën italiane të Futbollit më ndërprerjen e marrëdhënieve mes tyre, shkruante gazeta britanike lidhur me të ardhmen e Kontes.

Hames mendon kthimin në Real Madrid

Një prej blerjeve më të reja të skuadrës bavareze, kolumbiani Hames Rodriges duket se e ka mjaft të vështirë përshtatjen me futbollin gjerman. Pas largimit të Carlo Ançelotit, lojtari mund të mos ketë më hapësira. Sipas mediave spanjolle, Hames është duke konsideruar një rikthim në ish-skuadrën e tij, Realin duke i dhënë fund huazimit dyvjeçar. Sipas këtyre burimeve, Rodriges do të qëndrojë në skuadrën e kampionëve gjermanë deri në verën e ardhshme, ku më pas do të diskutohet lidhur me të ardhmen e tij. Rodriges është larguar nga skuadra e Real Madridit pasi vetë trajneri Zidan nuk e kishte në plan. Pas rikthimit të legjendës Jupp Hejnkes në drejtimin e skuadrës bavareze, Hames pritet ta ketë



më të vështirë për t'u kuptuar me trajnerin, kjo edhe për shkak

të njohurive jo të mira të gjuhës gjermane dhe ndryshimeve kulturore që ai po përjeton në Gjermani. Në këtë mënyrë, shefat e klubit bavarez mund t'i kursejnë rreth 50 milionë euro shpenzime. Trajneri i ri i ka dhënë mbështetje të plotë lojtarit me të ardhur në klub. "Hames nuk e flet gjuhën gjermane dhe futbollit këtu ka shumë ndryshim nga ai që luhet në Amerikën e Jugut, çka krijon shumë vështirësi për një lojtar si ai". "Megjithatë, ai do të ketë mbështetjen time maksimale, pasi më pëlqejnë shumë lojtarët e talentuar si ai. I kam parë ndeshjet që ka luajtur te Real Madridi, por nuk e njoh personalisht. Kur ai të rikthehet sërish, do t'i jap disa këshilla", ka thënë Jupp Hejnkes.


Mançester Siti i vendosur

Gati 400 mln euro për Mesin që në janar

Kur dukej se Leo Mesi do të ndiqte shembullin e Andres Iniestës dhe do të nënshkruante "përfjetë" me Barcelonën, mediata spanjolle japin lajmin bombastik. Sipas së përditshmes iberike "As", argjentinasi është shndërruar në një objekt konkret për Mançester Siten. Klubi anglez, duke parë vonesat në rinovimin e "Pleshtit", po mendon të shfrytëzojë momentin për të tentuar një akord,

që në rast realizimi do të ishte spektakolar në nivel mediatik dhe financiar. Në fakt, "Qytetarët" duken gati të shpenzojnë plot 400 milionë euro vetëm për të sjellë në "Etihad Stadium" yllin e Barcelonës dhe fakti më interesant i këtij lajmi është se projektin e tyre po planifikojnë ta zbatojnë në merkaton e janarit. Në Angli, sulmuesi do të përfaqëonte rishtazi Pep Guardiolen, me të cilin realizoi një

cikël të jashtëzakonshëm trofesh falë "tiki taka"-s së famshme. Lajmi i rinovimit të Mesit me katalanasit daton 5 korrik 2017 e megjithatë argjentinasi duket se nuk e ka nënshkruar ende marrëveshjen e re me klubin ku luan prej vitesh. Krerët e Barçës vazhdojnë të trumbetojnë faktin se sulmuesi luan me kontratën e re, por vonesa e firmës, për shkak edhe të bisedimeve me Iniestën,



duket se lë të hapur një spirale për Siten, të cilët, nga përtej La Manshit, kanë nisur të valëvisin një çek 400 milionë euro.



Kur përfaqësoni Italinë dhe jeni pjesëmarrës në një garë, s'mund të mos ëndërrosh që mos ta fitosh atë. Asnjëherë nuk kam nisur një turne duke menduar që të mos e fitoj, është njerëzore ta besosh atë

Botërori 2018 fiton Lionel Messi por humbet Alexis Sanchez dhe Arturo Vidal. Kapiteni, numri 10 dhe frymëzimi i Argjentinës vendosi diktatin në një nga ndeshjet më të rëndësishme të karrierës së tij duke marrë për dore skuadrën Albiceleste në një 90 minutësh që mund të kishte rezultuar dramatik në rreth 3 mijë metra mbi nivelin e detit në Quito të Ekuadorit. 3-1 e mbylli ndeshjen e jetës Argjentina me tregolëshin e 5 herë fituesit të Topit të Artë që në momentin më të vështirë. Leo Messi foli për mediat argjentinase, pothuajse një vit pasi asnjë anëtar i Albiceleste nuk pranoi asnjë nga ato. Ai e bëri këtë pas "ekspozitës" së tij mbresëlënëse në Ekuador, me tre gola të shënuar, çka i dha Argjentinës kualifikimin e drejtpërdrejtë për në Botërorin e Rusisë. "Gjithçka doli e përsosur, - tha ai. - Ne e kemi merituar të jemi atje, në Rusi, për gjithçka kemi kaluar në këto kualifikime". Përveç kësaj, Leo Messi shfaqti pendesë që e kanë filluar lojën kaq keq. "Ishte e vështirë për ne, sepse duhej ta fillonim me disavantazh. Nuk është e lehtë të shkosh dhe të luash me situatat që kishim kaluar, por për fat të mirë gjithçka shkoi mirë", - përfundoi ai. Derisa, Paulo Dybala ka mbetur i mahnitur nga

Përfunduan ndeshjet kualifikuese për KB 2018

Messi kualifikon Argjentinën, Kili dhe Holanda mbeten jashtë



SHBA PAS 32 VITEVE MBETET JASHTË BOTËRORIT, PANAMAJA NË HISTORI

Nuk thonë kot, "i mbytur i mbytur". Kjo ka ndodhur me përfaqësuesen e Amerikës e cila është mundur nga vendi i fundit i grupit CONCACAF për kualifikueset e Kupës së Botës. Natë e errët për skuadrën e Brus Arena pas humbjes në transfertë 2-1 ndaj Trinidad dhe Tobago. Kjo është hera e parë që nga viti 1986 për SHBA-në e cila do ta ndjekë kompeticionin numër 1 të futbollit në botë nga shtëpia. Festë e madhe ndërkohë për Panamanë që për herë të parë në histori merr pjesë në finalen e Botërorit. Skuadra e drejtuar nga Hernan Gomez ka mundur 2-1 Kosta Rikan falë Roman Torres (88') i cili tashmë është heroi i vendit të tij. Pas fitores 3-2 në shtëpi me kryesuesen e CONCACAF Meksikën, Hondurasi do të diskutojë plej-of me Australinë.

TËRHIQET ROBBEN

Arjen Robben ka njoftuar daljen e tij në pension nga futbollit ndërkombëtar, pas dështimit të Holandës për të qenë finaliste e Kupës së Botës 2018. Sulmuesi i Bayern Mynih shënoi dy gola për portokallinjët. Me këtë rast, Robben ka vendosur ta mbyllë këtu karrierën e tij ndërkombëtare, me 37 gola të shënuar në 96 ndeshje. 33-vjeçari e bëri debutimin e tij me ekipin kombëtar holandez në vitin 2003 dhe ishte një figurë kyçe në sukseset e shumta të "tulipanëve" në skenën ndërkombëtare, duke përfshirë edhe finalen e Kupës së Botës 2010, kur humbi në kohën shtesë përballë Spanjës. Ai, gjithashtu, shënoi tre gola në gjysmëfinale të Botërorit të vitit 2014 në Brazil. Ndërsa Robben vazhdoi të kishte sukses për "portokallinjët" pas Kupës së Botës 2014, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për skuadrën e tij, pasi ajo nuk arriti të kualifikohej për "Euro 2016", duke e zgjeruar zhgënjimin edhe me humbjen e Kupës së Botës 2018, në Rusi.

magjia e Lionel Messit. "Twitter" ylli i Juventusit. "Jam me fat ta shihja në fushë dhe që e kam kaq afër", ka shkruar në

herë Paulinjo nuk bënë skonto për kampionët e Kupës së Amerikës, duke i lënë ata jashtë Kupës së Botës. Buzëqeshje edhe për Uruguain që kaloi 4-2 Bolivinë për të betonuar pozitën në vendin e dytë me një biletë në dorë, ndërsa Kolumbia barazoi 1-1 në Peru dhe u kualifikua falë disfatës së papritur të Paraguait në shtëpi 1-0 nga Venezuela. Vendi i pestë që siguron përballjen e dyfishtë të plej-of me Zelandën e Re, shkon për surprizën e këtyre eliminatorëve, Pe-

runë. Në Amsterdam, Holanda arriti një fitore të hidhur 2-0 ndaj Suedisë duke u eliminuar zyrtarisht nga gara për një vend në plej-of, çka do të thotë se "Tulipanët" nuk do të marrin pjesë në Botërorin 2018. Skuadra e Dik Advocat triumfoi 2-0 me gola të Arjen Robben, por diferenca prej 7 golash që duhej të rikuperonte ndaj Suedisë ishte e paarrtshme dhe në këtë mënyrë, një prej emrave më të mëdhenj të futbollit botëror nuk do të jetë mes 32 më të mirëve verën e ardhshme në Rusi. Portugalia në Botërorin Rusi 2018 me avionin e parë bashkë me Francën, ndërsa Zvicra duhet të presë në tranzit për të marrë një përgjigje nga plej-of i muajit Nëntor. Skuadra e Cristiano Ronaldos dhe trajnerit Fernando Santos nuk zhgënjyjen në sfidën vendimtare të grupit B, ndërsa Franca bëri de-tyrën ndaj Bjellorusisë për të siguruar botërorin por duke dërguar në Plej-of Suedinë.

Publicitet

12-18.10.2017
MKЦ/QKR/YCC

за здрав дух
për shpirt të shëndoshë
for healthy spirit

11th INTERNATIONAL THEATRE FESTIVAL 2017

kupifestival

- 12 TETOR** 20h SULJAN ÇARSHI "SHTËPIA E BERNARDA ALBËS" / TEATRI "ANDON ZAKO ÇAJUPI" - KORÇË/ Shqipëri
- 13 TETOR** 20h QKR "BISHA" / TEATRI "U MOSTA" - PERM/ Rusi
- 14 TETOR** 20h QKR "MARTIR" / TEATRI I QYTETIT TË GJAKOVËS- GJAKOVË/ Kosovë
- 15 TETOR** 20h QKR "TYMOS SI NJË BURRË" / ARTIST SOLO- TEL AVIV/ Izrael
- 16 TETOR** 20h QKR "VIZIONE NGA SHERKULLI I ARGJENDTË" / QENDRA PËR DEKONTIMINIMIN KULTUROR- BEOGRAD/Serbi
- 17 TETOR** 20h QKR "FOL MEDEA" / KOMPANIA TEATRORE JIRIIRAK- TEHERAN/ Iran
- 18 TETOR** 20h QKR "SHËRBËTORET" / TEATRI KOMBËTAR "VAN VAZOV" - SOFIE/ Bullgari

Flet mjeku që e operoi futbollistin e Barcelonës

Gjithçka po shkon mirë me Dembelen

Ndërmjet vizitës dhe vizitës, Dr.Sakari Orava gjeti një vend për t'iu përgjigjur thirrjes telefonike të "MD" nga zyra e tij në Spitalin "Neo" të Turku, Helsinki. Mjeku finlandez, përgjegjës për funksionimin e Ousmane Dembele, pas operacionit që i kreu, ka konfirmuar se për momentin, shërimi i talentit francez po shkon mirë. "Unë jam në kontakt të përhershëm me Dr.Prunën, i cili është përgjegjës për dërgimin e raporteve të kontrolleve që po i bëjnë Dembelës dhe tani për tani gjithçka është e saktë", - konfirmoi Orava në këtë gazetë spanjolle. Megjithëse Dembele dërgoi një mesazh shumë optimist përmes rrjeteve të tij so-



ciale, duke pohuar se në dy muaj mund të kthehej tashmë, mjeku Orava preferonte të ishte më i kujdesshëm. I mësuar të trajtonte këtë lloj dëmtimesh, mjeku finlandez pranoi se një nga arsytet për lëndimin e Dembelë mund të lidhet me rininë e tij. "Ndoshta ishte një mëkat i të rinjve, për të mos thënë se më parë ndihesha siklet në atë zonë. Presioni që është ekspozuar pas transferimit

të tij nga klubi mund të ndikojë", - arsyetoi mjeku finlandez. Megjithatë, Orava është i bindur se sulmuesi i Barçës do të mësojë nga ky pësim për të ardhmen. Karriera e tij sportive sapo ka filluar dhe sulmuesi do të marrë parasysh këtë lëndim. Pavarësisht se është në kontakt të përhershëm me Dr.Riçard Prunën, Dr.Orava nuk përjashton lëvizjen drejt Barcelonës për të vlerësuar afërsisht rikuperimin e Dembele. "Kjo do të varet nga mënyra se si vazhdon rikuperimi. Nëse gjithçka vazhdon siç ka qenë deri më tani, mund të mos jetë e nevojshme shkuarja ime në Barcelonë, sepse evolucioni është i mirë", - deklaroi Dr.Orava.

Murinjo: Ndeshja kundër Liverpoolit si krejt ndeshjet tjera

Hoze Murinjo ka tentuar të ulë rëndësinë e vizitës së Mançester Junajtedit të Liverpoolit të shtunën, duke thënë se ndeshja ka vlerën e tri pikëve, si të gjitha ndeshjet tjera. Junajtedi dhe Mançester Siti prijnë në Premier Ligë vetëm me një gol dallim dhe mbesin të pamposhtura në shtatë ndeshjet e para të këtij sezoni, por vizita në "An-

field" - stadium në të cilin Murinjo është përfshirë në disa zënka gjatë viteve të fundit - është testi më i vështirë sivjet. "Është ndeshje për tre pikë, jo për katër. Sikur të ishim në një moment kur dueli do të ishte mes dy ekipeve të barabarta, atëherë do të kishte rëndësi më të madhe, por në këtë rast jo", ka thënë Murinjo për "Sky Sports". "Në të njëjtën



kohë, këto lloje të ndeshjeve, çdo moment i tyre luan rol të madh. Do të luajmë kundër një ekipi të mirë me lojtarë shumë të mirë", ka shtuar ai.

DASHI (20/III-20/IV)



Humorizmi i një miku do të jetë i nevojshëm për të kaluar disa keqkuptime që mund të keni në familje. Në vend që të sforcoheni për të mbajtur një marrëdhënie që tenton të humbë rrugë, bëni miri ta mbyllni një herë e mirë, përpara se të bëhet më shumë serioze sec duhet.

DEMI (21/IV-20/V)



Hëna hedh hije mbi programet për fund javën. Zhgënjimi për një projekt që ju është prishur ju sjell në humor të keq. Nëse humori është në zbritje edhe toni juaj vital e ndjen këtë. Bëni mirë të buzëqeshni.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Kuadrati i Merkurit vë në krizë takimet, spostimet dhe kontaktet me internet. Do ju ofrohet rasti për të shtuar kopetencat tuaja profesionale, falë një bashkpunimi me një ekspert. Nëse keni ndër mend të parashikoni pushime me partnerin, sensi praktik i Hënës tek Virgjërsha do të jetë një ndihmë e madhe për ju.

GAFORRIA (21/VI-22/VII)



Aktiviteti mendor nuk premtion shumë, përkundrazi duhet të lodheni për të rregulluar corintimin, harresat gabimet dhe vlerësimet. Do të ndjeheni të pakënaqur dhe me humor jo të mirë në dashuri. Bëni mirë të jeni të hapur në gjykimet tuaja, sepse nuk jeni objektiv.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Rikuperoni ekuilibrin. Sot në qëndër të cdo gjëje do të jenë çështje financiare për tu rregulluar. Në momentin që ju duhet të bëni shumë gjëra, përfitoni nga heshtja e yjeve për të reflektuar. Falë takimeve të reja për ata që kanë zemrën e lirë ka premtime të shkëlqyera.

VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Kanalizoni energjitë tuaja drejt një objektivi dhe procedoni me qetësi. Nuk është momenti të rrezikoni në asgjë sot. Mos vazhdoni të shikoni mbrapa, duke idealizuar kujtimet e një raporti që ka kaluar tashmë.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Të realizoni dëshirat tuaja do të jetë e lehtë, sot që Hëna dhe Merkuri bashkohen për të ju mbështetur dhe për të ju dhuruar një ditë vërtetë të paharrueshme. Sot do jeni të corientuar dhe kjo mund të rrezikojë të ju vërë në provë të vështirë. Evitoni sot situatat e vështira.

AKREPI (22/X-21/XII)



Ekulibri dhe dëshira për mirëqenie, mbi të gjitha të brendshme, do të karakterizojnë këtë ditë. Edhe nëse partneri bën ndonjë kaprico më shumë gadishmëria juaj për dialog do ju ndihmojë të zgjidhni çfarë do lloj problemi.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



I keni letrat e duhura për të qënë fitues dhe duhet të luani mirë. Përpara jush po hapen perspektiva interesante dhe ju jeni gati për të shijuar të mirat që qelli favorizues premtion të ju dhurojë. Ekuilibrin që keni arritur jo pa lodhje është kaq i dukshëm sa mund të ndikojë edhe tek ata që janë pranë jush.

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Me Hënën që ju mbështet, mund të vendosni të ftoni për darkë familjarët dhe miqtë tuaj, ose të dilni të gjithë së bashku. Yjet sot tregojnë anën e tyre më të mirë, duke ju sjellë një ndjenjë të mirë rigjeneruese. Organizmi juaj mund të fitojë shumë nga stili juaj i rregullt dhe i shëndetshëm.

UJORI (20/I-19/II)



Dispononi vendosmërinë e nevojshme për të përballuar dhe zgjidhur keqkuptimet që Hëna në opozitë ju sjell. Nëse partneri juaj duket pak në hije, nuk është sigurisht për fajin tuaj, bëni gjithçka për ta sjellë në humor të mirë duke orgaznizuar një darkë surprizë.

PESHQIT (20/II-19/III)



Do arrini më në fund të ndjeheni të lirë të bëni zgjedhjet tuaja, pa u mbështetur aspak tek të arëmit ose miqtë tuaj. Nuk është momenti i duhur për të bërë ndryshime, por as edhe për të marrë vendime të rëndësishme për jetën në çift.



Mensur Mamuti	PIKTORI DHE REGJISORI NË FOTO	AEROPLANI	LART (VJET)	EMRI I LUFTËTARIT TË MADH SHQIPTAR, KOMENIT
SHTET NË AFRIKË				
KALLI MISRI I ZGJEDHUR PËR FARE				
SMIRË, RESE				
FUTBOLLISTI BRAZILIAN, TIAGO				
AKTORJA AMERIKANE, MARGARET			AZOTI	NJË NGA PROFESIONET E PERSONIT NË FOTO
DJALI I DJALIT				
GJERMANIA PJESE (SHKURT.)		ITRIUMI	ANGSTREMI	

KOHA	IRONI E HIDHUR (SH.) JO MIRË	S	KAFSHË GJITARE FRIKACAKE (SH.)	ME TRUP TË IMET	I MOSHUAR QYTETI I LINDJES SË PIKTORIT NË FOTO	KOTEM	
ÇELIKOSJE						TEKI DËRVISHI REVOLUCIONARI RUS, VLADIMIR ILIÇ	
KËNGËTARI SKIFTER KINOSTUDIOJA E REGJISORIT NË FOTO					ELEMENT KIMIK (CL) LUMË NË FRANCË		
SH							
KOHA	RRUGËT E MARSHIMIT RADIUMI					NORVEGJIA NDUE UKAJ	1000 ROMAK LESOTO
AKTOR AMERIKAN (LOVE STORY) (SHQ.)							
KALË SHALE			TËRËSIA E NORMAVE TË SË DREJTËS ZAKONORE (SH.)				

ZGJIDHJET: GANA, AVAR, ZILI, MOTA, EN, N, NIPI, D, IT, S, PLAK, KALITJE, TD, ETEMI, KJOR, SHQIPËRIA E RE, RUTAT, N, M, RAJAN O NILI, AT, KANUNET.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

	7		6	5																
9					3			5	6		6		5		7		2			
2					7															
	6	7	1						8		5	2							8	3
8									5		9			1		5				6
5					9	3	4				6	3							9	1
			5						1											
7	8		4						2		5		7		9				4	
				2	8			3					4	2	5	1	6			

Shumë i lehtë: 173654289, 948213756, 256987413, 367145928, 894372165, 521869347, 432596871, 785431692, 619728534. Mesatar: 215348769, 869517324, 473692815, 521976483, 948135276, 637824591, 182463957, 356789142, 794251638.



Vjen BlackBerry Motion pa tastierë

Ndonjëherë kthehen. Dhe tashmë ka dalë dhe BlackBerry Motion, smartphone i dytë me firmën kanadeze por produktin kinez të Tçl, që ka blerë të drejtat e emrit. Ndryshe nga modeli i parë, KeyOne, pajisja e re heq dorë nga karakteristika e përhershme e BlackBerry, tastiera fizike. I prezantuar në Dubai gjatë eventit GiteX 2017, Motion është një smartphone Android i fashës së mesme me ekran



5.5 polsh, procesor Snapdragon 625 Qualcomm, 4GB Ram dhe 32 GB memorie e brendshme. Pika e

saj e fortë është bateria prej 4.000 mAh, me suport QuickCharge 3.0 për karrim të shpejtë, që sipas prodhuesve mban deri në 32 orë bateri. Mes karakteristikave të tjera është fotokamera e pasme prej 12 megapiksel dhe ajo e përparme prej 8 megapiksel, lexuesi i gjurmëve dixhitale dhe rezistent ndaj ujit dhe pluhurave. Fillimisht do të shitet në Lindjen e Mesme me një çmim prej 460 dollarë.

Lamtumirë Big Ben



Ora e famshme e londineze, Big Ben, do t'i nënshtrohet një rikonstruksioni të plotë. E për këtë arsye "Kulla Elizabet" është rrethuar nga skelat, të cilat do t'u pengojnë pamjen, jo vetëm londinezëve, por edhe turistëve të shumtë në kryqytetin anglez. Katër vite janë parashikuar të zgjasin punimet në një prej ndërtesave më të famshme në botë dhe kostoja totale do të kapë shifrën e 68 milionë eurove. E ndërtuar në vitin 1859, Big Ben, njëhej zyrtarisht me emrin "Kulla e Orës", emër të cilin e ka mbajtur deri më vitin 2002, kur iu ndërrua në "Kulla Elizabet" në nder të mbretëreshës aktuale të Britanisë, Elizabeta I.

Protestë me dele kundër ujqqve nëpër rrugët e Lionit

Fermerët lëshuan në rrugë me qindra dele në një shesh qendror të qytetit francez, Lion, të hënën për të protestuar kundër vendimit qeveritar për mbrojtjen e ujqqve, të cilët i fajësojnë për ngordhjen e bagëtive dhe për humbje të mëdha financiare.



tërë vendin, thonë grupet për jetën shtazore, raporton Reuters. Me rritjen e popullatës së tyre, ata

kanë mësyre në masë të madhe tokën bujqësore. "10.000 kafshë vriten çdo vit nga ujqqit", shkruan një

prej banerëve. Michele Boudoin, president i Federatës Kombëtare të Deleve, ka thënë se ujqqit po u shkaktojnë fermerëve dhe prodhuesve të produkteve nga kafshët 26 milionë euro humbje në vit në krahasim me 1.5 milion euro sa ishin më 2004.

"Mjaft më me ujqqit", thotë Boudoin. "Dikur vjen koha kur duhet të zgjidhni mes fermerëve dhe ujqqit". Fermerët po kërkojnë që t'u lejohet vrasja e ujqqve që sulmojnë kopetë e tyre.

KALENDARI HISTORIK 12 TETOR

- 539 BC - Armata e Sirusit të Madh nga Persia merr Babilonin.
- 1165 - Rambam arrin në Jerusalem.
- 1285 - 180 hebrenj refuzojnë të pagëzohen në Munih të Gjermanisë ku pastaj ndizen në zjarr.
- 1366 - Mbreti Frederick III i Sicilisë ndalon dekorimin e sinagogave.
- 1492 - Kolombo arrin në Bahame.
- 1509 - Perandori Maximilian largohet nga Italia.
- 1815 - Ish-Mbreti Joachim Murat van Naples dënohet me vdekje.
- 1860 - Trupat britanike dhe franceze okupojnë Pekinin.
- 1879 - Trupat britanike okupojnë Kabul në Afganistan.
- 1891 - Inaugurohet Shoqata e Astronomëve të Francës.
- 1925 - Nënshkruhet marrëveshja tregtare mes Gjermanisë dhe Rusisë.
- 1933 - Alkatrazi shpallet burg federal.
- 1944 - Ushtria gjermane tërhiqet nga Athina.
- 1973 - Huan Peron zgjidhet president i Argjentinës.
- 1978 - Përfaqësuesit e Izraelit dhe Egjiptit fillojnë bisedimet në Uashington.
- 1988 - Izraeli dhe Kina nënshkruajnë marrëveshje tregtare dhe planifikojnë marrëdhënie diplomatike.

A E DINI SE...



Mjalti përdoret për shërimin e sëmundjes "stalni aigan" plagës së qelbosur. Plagën e atillë duhet menjëherë të lyer me mjaltë, ndërsa të sëmurit duhet dhënë që të hajë 10-15 herë.

Uji e përcjell elektricitetin vetëm për shkak të papastërtive të tij. Uji përsosmërisht i pastër nuk do ta përcillte energjinë elektrike.



BARSOLETA



POLICIA NË VENDIN E KRIMIT

Një grua vret burrin dhe policia mbërrin në vendin e krimit. Polici merr shefin në radio për ti raportuar ngjarjen:

- Shef, gruaja e ka goditur trupin rreth 6 herë me thikë dhe rreth 12 herë me pistoletë dhe e ka hedhur nga kati i 7.

- Po a arritët të zbulonit se cili ka qenë shkak i kësaj vrasje?

- Po shef, gruaja i kishte thënë burrit që të mos kaloj mbi dysheme deri sa ajo të thahet!

- Po mirë, po gruan e keni kapur?

- Jo shef akoma, po presim të thahet dyshemeja!

THËNIA E DITËS

Më vret fakti që nuk arrij kurrë të kërkoj asgjë. Por edhe më shumë fakti që të tjerët mendojnë se unë nuk kam nevojë për asgjë. (Antonio Curnettal)

